

# DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE I FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 385 • DHJETOR 2022



KUSH MUND TE FLASË  
NË EMËR TË ISLAMIT?

KULTIVIMI I DASHURISË PRINDËRORE

“IU LUTA ZOTIT PËR MËSHIRË NË  
VENDIN KU U LUTËN PROFETËT”



# 30-VJETORI I THEMELIMIT TË FAKULTETIT TË STUDIMEVE ISLAME

E MARTË, 27.12.2022 | SALLA E KONFERENCAVE NË FSI - PRISHTINË



Themelimi i Fakultetit të Studimeve Islame erdhi si nevojë e plotësimit të kërkesave për arsimim të lartë islam në vendin tonë por edhe më gjerë; themelimi i Fakultetit të Studimeve Islame ishte nevojë e kohës në mënyrë që të rinjtë tanë të vazhdojnë studimet e tyre në fushën e shkencave islame edhe në Kosovë.

(Myftiu: Naim ef. Tërnavë)

Qysh prej themelimit të Fakultetit të Studimeve Islame në vitin 1992 nga Bashkësia Islame e Kosovës, kjo qendër ka dhënë kontribut të rëndësishëm, jo vetëm në aspektin e arsimit publik, por edhe në aspektin kombëtar e atdhetar. Për shumë vite në hapësirat e Fakultetit të Studimeve Islame kanë vepruar: Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Fakulteti i Mjekësisë dhe fakultete të tjera që UP-së, Bashkësia Islame e Kosovës.

(Ministrja: Arbërie Nagavci)



Sot, Fakulteti i Studimeve Islame është institucion i konsoliduar, të diplomuarit në FSI tash më janë bartës e udhëheqës në institucionet e BIK duke filluar nga misioni i nderuar i imamit, udhëheqës e drejtues të këshillave të BI, bartës e drejtues të forumeve e instituconeve tjera të BI dhe jo vetëm kaq, kuadrot e dala nga FSI i gjejmë edhe në institucionet shkencore, kulturore e publike në Kosovë dhe vise tjera shqiptare.

(Dekani: prof. asoc. dr. Islam Hasani)

## EDITORIAL

- 4 Turpi, si deficit i brezit bashkëkohor

## FE & SHKENCË

- 5 Themelimi i Fakultetit të Studimeve Islame ishte nevojë e kohës
- 7 Komentimi i kaptinës Muhamed – (9)  
Sabri Bajgora
- 11 Kaptina Kehf dhe metodat e edukimit që burojnë prej saj (2)  
Dr. Valmire Batatina – Krasniqi
- 14 Ëmbëlsia e Kuranit fisnik i përvetëson zemrat  
Dr. Ajni Sinani
- 17 Njeriu për nga udhëzimi – dija u përngjan llojeve të tokës  
Prof.ass.dr. Musa Vila
- 20 Rëndësia e konsultimit dhe komunikimit në formimin e shkollës hanefite  
Dr. Ejup Haziri
- 24 Kush mund të flasë në emër të Islamit?  
Dr. Muhamed Stublla
- 27 Kafshët e therura nga jomuslimanët  
Mr. Besim Krasniqi
- 30 "Iu luta Zotit për mëshirë në vendin ku u lutën profetët"  
Shpresa Hetemi
- 32 Fara e lirit – lubrifikanti më i mirë për organizmin e njeriut  
Mr. Njomza Sadriu



## FAMILJE & EDUKIM

- 34 Kultivimi i dashurisë prindërore  
Mihana Goga-Bekteshi
- 36 Mjedisi dhe rrethi shoqëror si faktorë ndikues në formësimin e personalitetit të fëmijës  
Phd. Melihate Zeqiri



## KULTURË

- 39 Lindja dhe Perëndimi për bashkëjetesën njerëzore  
Mr. Besim Mehmeti
- 43 Vepër me shumë interes për historinë islame në gjuhën shqipe  
Ramdan Shkodra
- 46 Dita Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut  
Mr. Muzaqete Kosumi




## HISTORI & CIVILIZIM

- 48 E vërteta e mitit të dekretit të sulltan Abdul Hamidit  
Arben Lalla
- 51 Kontribute albanologjike në faqet e revistës "Toska" të Egjiptit në fillim të shek. XX  
Nuridin Ahmeti



## PERSONALITETE

- 54 Salih Maksutaj  
Mr. Vehbi Shatri
- 56 Në Medresenë e Gjakovës ligjëratat zhvilloheshin në gjuhën shqipe  
Mulaim Shehu



## AKTIVITETE

- 64 Fakulteti i Studimeve Islame shënoi 30-vjetorin e themelimit



### DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore  
Nr. 385 • viti 36 • dhjetor 2022  
• Xhumadel Uhra 1444  
• çmimi 1 €

Boton:  
Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës,  
Prishtinë

### Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi  
Anëtarë:  
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,  
mr. Muharrem Tërnavë,  
mr. Vedat Shabani.  
Sekretar redaksie: Dr. Rexhep Suma  
Lektor & korrektor: Bajram Zeqiri  
Redaktor artistik & teknik:  
Bashkim Mehani

### Adresa

"Dituria Islame",  
rr. "Bajram Kelmendi" nr. 182,  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +384 38 224 024  
E-mail: dituriaislame@hotmail.com  
dituriaislame@yahoo.com  
www.bislame.net  
Shtypi:  
Shtypshkronja "Printing press", Prishtinë



*“Secila fe e ka moralin e vet, e morali i Islamit është turpi”.*

(Muhamedi, a.s.)

## Turpi, si deficit i brezit bashkëkohor

Njeriut, si krijesë e privilegjuar, Zoti i krijoi tipare e virtyte, mungesa apo varfërimi i të cilave e degradon pamëshirshëm njerëzoren e tij. Vetëm i stolitur me ato virtyte, ai qëndron në pedestalin për të cilën ai është i predestinuar nga Krijuesi i Urtë. Me po të njëjtat cilësi, krijesa që mendon, arrin të krijojë diferencën nga krijesat e tjera.

Edhe turpi, si virtyt, ndërgegjeje e emocion i çiltër te njeriu, në një formë e përkryen mozaikun e bukur të tipareve fisnike të krijuara tek ai. Për më tepër, ai manifestohet në formë të një keqardhjeje të brendshme që lind nga veprimi i çdo gjëje çnderuese, qesharake ose të pahijshme, e cila në ndonjë formë e gërvisht pamëshirshëm virtytin e modestisë, moralit, e të mirësjelljes së njeriut. Ai gjithnjë na paralajmëron për sjellje të gabuar dhe si i tillë e motivon vetëkorrigjimin e nevojshëm. I Dërguari ynë, Muhamedi a.s., duke e përshkruar atë si detektues të së keqes, e si një mekanizëm preventiv që parandalon nga e liga, na tha: “Nëse nuk ke turp, bëj çfarë të duash.” Sipas këtij postulati profetik, ai tipari i virtytshëm i injektuar në karakterin e secilit, e që njeriun e pengon nga keqbërja e vulgariteti, është pikërisht turpi. Po i njëjti, të imunizon e të bën që për veprimet e liga, nëse veç aksidentalisht i ke bërë, së paku të mos kesh kurrë guxim as gatishmëri që të krenohesh. Sëstë pak kjo!

Megjithatë, nëse dikur në shoqërinë tonë ka qenë vlerë po të ishe i turpshëm, sot ka ngelur e “turpshme” nëse ende ke turp. Ndërrim standardesh dhe ngatërrim konceptesh të etabluara në vetëdijen tonë, kanë ndodhur në periudhat e zhvillimit material, i cili si kosto, fatkeqësisht, pati një dekadencë morale e shpirtërore.

Natyrisht, të gjithë ata që duan terren të lirë për mbjelljen e veseve të shturura e dukurive të mbrapshta në shoqëri, turpin e mendojnë si atë digën e patejkalueshme që duhet të investojnë pakursyeshëm për rrënimin e saj. Ridisenjimi i moralit shoqëror dhe zvetërimi i njeriut të virtytshëm po bëhet duke plasuar në formën joshëse para tij, programe e emisione vulgare televizive, që zhveshjen e proklamojnë si art, e shturjen si emancipim, ndërsa fisnikërinë e nderin e shohin si stigmë, madje edhe qyqari e vetizolim. Këto aktivitete e programe, na duken të çakorduara, por në thelb lëvizin në të njëjtën linjë, dhe pa përjashtim atakojnë garantin më të sigurt të moralit të njeriut – turpin e tij. Për ta, një njeri i paturpshëm dhe një brez që është zhveshur nga ky virtyt është i vetmi që premtun “reformën e thellë” dhe i vetmi që mund të bartë mbi supet e veta “emancipimin” e shoqërisë. Kjo shoqëri e tillë që po i nënshtrohet një kampanje të “mirëmenduar”, pavetëdijshëm do të pajtohet me një anarki morale, dhe do jetë e gatshme të nihilizojë çdo vlerë e virtyt. Atëherë, kokëulja pas fajit, dhe keqardhja për të ligat do të shndërrohet në një monedhë të pavlerësuar dhe nuk do të ngelet ndonjë aset human për të cilin do të mund të flitet me krenari.

E tërë kjo kampanjë, synon pos tjerash që turpi nëse veç mbijeton, të mbetet deficit i kësaj shoqërie, e cila predispozohet të jetë e ngatërruar me vetveten dhe të modelohet që të mos arrijë të dallojë fare fajësinë prej pafajësisë, e virtytin prej marrëzisë. Me varfërimin e virtytit të turpfit, te brezi modern, vërejmë se fëmija po e humb ndjesinë e konsideratës ndaj prezencës së prindit, nxënësi krekoset dhe ngre zërin në prani të mësimitdhënësit të tij, vajza tejkalon pavrejtshëm virtytin e komunikimit të çiltër me një djalë të huaj, ndërsa bashkëshortët, atë diskutimin e natyrshëm e të shëndoshë që do të duhej ta kishin, e zëvendësojnë me grindje të pakuptimtë për mospajtimet më të thjeshta të tyre. Të gjitha këto janë konsekuenca të pritshme të zhveshjes së një shoqërie nga turpi dhe lëndojnë deri në palcë moralin e të rinjve.

Pavarësisht kësaj, ta rikujtojmë që turpi në Islam mbetet një virtyt i dëlirë dhe margaritar me vlerë, për ruajtjen e të cilit mbahemi përgjegjës që të gjithë, ani pse dallojmë në shkallën e përgjegjësisë. Ai nuk mund të konsiderohet në asnjë rast, si një lloj monedhe, vlera e së cilës mund të devalvohet në ndonjë kohë. Ai, siç ishte edhe në të kaluarën, edhe sot është artikulesi më besnik i moralit të mirë të një besimtari të mirësjellshëm.

“Secila fe e ka moralin e vet, e morali i Islamit është turpi”, na tha Muhamedi a.s..

Mr. Driton Arifi



*Fjala e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, në ceremoninë e 30-të vjetorit të themelimit të Fakultetit të Studimeve Islame*

# «Themelimi i Fakultetit të Studimeve Islame ishte nevojë e kohës»

*E nderuara ministre për Arsim, Shkencë, Teknologji e Inovacion, zonja Arbërie Nagavci,*

*I nderuari dekan i Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë, dr. Islam Hasani,*

*I nderuari dekan i Fakultetit të Shkencave Islame në Shkup, dr. Shaban Sylejmani me bashkëpunëtorë,*

*Të nderuar ju veteranë të arsimit tonë, profesor Qazim Qazimi, profesor Resul Rexhepi, profesor Ismail Ahmedi,*

*Të nderuar udhëheqës të institucioneve të Bashkësisë Islame të Kosovës,*

*Të nderuar pedagogë të Fakultetit të Studimeve Islame dhe ju të dashur studentë,*

*Motra e vëllezër,*

*Të nderuar të pranishëm!*

“Thuaj: Si mund të jenë të barabartë ata që dinë me ata që nuk dinë- të paditurit.” (Zumer, 9)

Ndihem për së tepërmi i nderuar që sot jam këtu para jush për të shënuar përvjetorin e 30-të të Fakultetit të Studimeve Islame të Prishtinës, këtij institucioni të lartë për arsimimin dhe edukimin profesional e shkencor islam në vendin tonë, i cili ndonëse nisi rrugëtimin e tij në kohë e rrethana mjaft të vështira, arritjet dhe puna e tij rezultojnë të bereqetshme, të hairit e të suksesshme. Prandaj, më lejoni që në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, institucioneve të saj dhe në emrin tim personal, t’ju përshëndes e t’ju falënderoj që keni ndarë nga koha juaj e shtrenjtë dhe jeni sot me ne, për të shënuar këtë përvjetor kaq të rëndësishëm e domethënës për arsimin e lartë islam në Kosovës dhe jo vetëm.

*Të nderuar pjesëmarrës!*

Viti 1992 shënon një ndër vitet me të rëndësishme në historinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, sepse në këtë vit zuri fill një ndër institucionet më të rëndësishme të saj dhe me të nisi të shkruhet një faqe e re e arsimit dhe e kulturës sonë islame.

Tri dekada më parë, Bashkësia Islame e Kosovës, me themelimin e Fakultetit të Studimeve Islame, në të vërtetë kurorëzoi përpjekjen e sakrificën e shumë brezave për të pasur një institucion të arsimit të lartë, ku do të studioheshin e mësoheshin shkencat islame në gjuhën shqipe, gjithnjë si përmbushje e mësimave të Kuranit fisnik për dijen e për arsimin, si një zbatim i urdhrit kuranor, ngase vetë fjala Kuran do të thotë “Lexim”, por edhe ajeti - urdhri i parë që Zoti zgjodhi për t’iu drejtuar njerëzimit mbarë është: “Ikre-Lexo”, ndaj falënderojmë Allahun, i Cili na e mundësoi që të mësojmë, të lexojmë, e përmes leximit e studimit ta njohim Allahun Krijues, ta besojmë Atë dhe tërë atë që ka zbritur në Kuran! Ta njohim veten tonë, ta lexojmë historinë tonë e të punojmë për një të ardhme sa më të mirë të vendit tonë, por edhe të botës mbarë.

*Të nderuar të pranishëm!*

Më lejoni të theksoj faktin se themelimi i Fakultetit të Studimeve Islame erdhi si nevojë e plotësimit të kërkesave për arsimim të lartë islam në vendin tonë, por edhe më gjerë; themelimi i Fakultetit të Studimeve Islame ishte nevojë e kohës në mënyrë që të rinjtë tanë të vazhdojnë studimet e tyre në fushën e shkencave islame edhe në Kosovë.

Prandaj, në këtë përvjetor që po shënojmë sot, e gjej të udhës që në emër të institucioneve të BIK-ut, t’u shpreh mirënjohje të pafund gjithë atyre brezave para nesh që dhanë kontributin e tyre në fushën e gjatë të arsimit tonë islam e kombëtar dhe atyre që e bënë të mundur që të kemi Fakultetin e Studimeve Islame.

Natyrisht bukuria e një fakulteti janë studentët e tij, ata janë që i japin vlerë e kuptim atij, prandaj një mirënjohje edhe gjithë atyre studentëve të dashur që kanë bërë një zgjedhje të mirë e të qëlluar kur kanë vendosur për të studiuar në Fakultetin e Studimeve Islame, me qëllimin e vetëm për t’u pajisur me dije e arsim të lartë islam për t’i shërbyer fesë, popullit dhe atdheut. Fakulteti i Studimeve Islame ka mision



të qartë, vizion e strategji, të cilat bazohen në vlerat e larta të arsimit islam, në Kuran e Hadith, duke inkorporuar në programet e veta edhe vlerat kombëtare e botërore që kanë të bëjnë me avancimin e vlerave arsimore, bazuar në programet gjithëpërfshirëse të teknologjisë moderne. Misioni i Fakultetit të Studimeve Islame është të ofrojë studime të cilësisë së lartë, të përgatisë teologë të aftë për t'u ballafaquar me probleme dhe sfida të përditshme me të cilat ballafaqohet populli ynë.

Fakulteti i Studimeve Islame është qendra kryesore e arsimit islam në Kosovë, ndaj në këtë përvjetor të 30-të të themelimit, një mirënjohje të madhe e meritojnë edhe të gjithë ish-profesorët, të cilët punuan me përkushtim për përgatitjen e kuadrit islam në Kosovë dhe Fakultetin e lanë në duar të sigurta e te njerëzit kompetentë, e sidomos iniciatorin e themelimit dhe dekanin e parë, Myftiun tonë të nderuar Dr. Rexhep Boja me të cilin pata fatin të bashkëpunoj dhe bashkëveproj një kohë të gjatë. Zoti e past mëshiruar!

*Të nderuar të pranishëm!*

Fakulteti i Studimeve Islame ka dhënë një kontribut të pazëvendësueshëm në përhapjen e mësimave islame në Kosovë e më gjerë. Të diplomuarit e FSI-së po dëshmojnë për profesionalizmin dhe përkushtimin e tyre kudo që ata gjenden dhe ngado që po shkojnë. Në Fakultetin e Studimeve Islame kanë ndjekur studimet dhe vazhdojnë t'i ndjekin edhe shumë studentë nga të gjitha trojet tona etnike, dhe kjo padyshim ka edhe domethënie të vetë dhe këtij institucioni ia shton vlerën.

Sot kur shënojmë 30-vjetorin e FSI-së, që dikur nisi dhe ishte si ide e mendim, tashmë FSI është realitet dhe ka nisur

rrugëtimin e tij historik. Dhe jo vetëm kaq, por FSI, përveç studimeve themelore, tashmë organizon edhe studimet në nivelin master, gjë që flet më së miri për arritjet dhe sukseset e FSI-së dhe stafit të tij akademik, si dhe përmbush synimet dhe qëllimet e themeluesit të tij - të Bashkësisë Islame të Kosovës.

FSI, krahas sukseseve, gjatë këtyre 30 vjetëve ka kaluar edhe nëpër shumë sfida. Shpeshherë kemi përshtypjen se nuk kemi bërë mjaftueshëm në këtë drejtim, por se rezultatet e arritura na dëshmojnë të kundërtën e kësaj.

Prandaj kjo edhe na obligon edhe më shumë që ne si Kryesi e Bashkësisë Islame të Kosovës që të jemi edhe më të përkushtuar në ndihmën dhe përkrahjen tonë për Fakultetin e Studimeve Islame, në mënyrë që ai t'i ngrejë kapacitete e veta dhe të përmbush misionin e tij drejt mësimdhënies e mësimnxënies, të përmirësojë edhe më shumë cilësinë e studimeve dhe të kultivojë kreativitetin dhe vlerat e larta etike - morale.

*Të dashur studentë!*

Sot në këtë ditë të shënuar, një numër nga ju do të pajisen me diplomën e këtij Fakulteti. Dita e diplomimit është ditë e paharruar në jetën dhe karrierën e çdo individi që ka përfunduar arsimin e lartë. Mirëpo, për ju që sot do të merrni diplomën është ditë edhe më e veçantë, dhe s'ka se si të jetë më mirë, sepse kjo ceremoni e ndarjes së diplomave përkon me ditën e jubileut të 30-vjetorit të FSI-së. Uroj që këto diploma t'ju bëjnë krenarë juve ashtu siç ju e bëtë krenarë fakultetin ku studiuat, kurse dijet e fituara këtu t'i vëni në shërbim të vendit dhe popullit tuaj.

*Të nderuar të pranishëm!*

Pa dashur që të zgjatëm më shumë në këtë fjalë timen, duke falënderuar të gjithë ata që në çfarëdo mënyre kanë kontribuar në themelimin, rritjen dhe zhvillimin e FSI-së, më lejoni që edhe njëherë të shpreh mbështetjen e pa rezervë të Kryesisë së BIK-ut dhe të të gjitha institucioneve të saj për Fakultetin, për stafin akademik, për studentët e FSI-së. Ne nuk do kursejmë asgjë, që të krijojmë kushte sa më të mira për fakultetin tonë. Fakultetin e themeluam në ditë e kohë të vështira, por sot kemi të gjitha kushtet e mundësitë që të ecim me hap të mëdhenj drejt së ardhmes.

Duke ju përshëndetur edhe një herë, ju uroj të gjitha të mirat, me shpresë e bindje që përvjetorët e tjerë të Fakultetit të na arrijnë me suksese edhe më të mëdha.

Edhe një herë urimet e përgëzimet më të mira, mbarësi e suksese!

Wes-selamu aljekum!

Prishtinë, më 27 dhjetor 2022

Myftiu i Kosovës,

Naim ef. Tërnavë

# Komentimi i kaptinës Muhamed – (9)

Lartësimi i Fjalës së Allahut është rruga e shpëtimit

Sabri Bajgora

فَلَا تَهِنُوا وَتَدْعُوا إِلَى السَّلَامِ وَأَنْتُمْ الْأَعْلَوْنَ وَاللَّهُ مَعَكُمْ وَلَنْ يَبْرِكَنَّ  
أَعْمَالَكُمْ ﴿35﴾ إِنَّمَا الْحَيَاةُ الدُّنْيَا لَعِبٌ وَلَهُوَ ۖ وَإِنْ تُؤْمِنُوا وَتَتَّقُوا يُؤْتِكُمْ  
أُجُورَكُمْ وَلَا يَسْأَلْكُمْ أَمْوَالَكُمْ ﴿36﴾ إِنْ يَسْأَلْكُمْوهَا فَيُخْفِكُمْ تَبَخَّلُوا  
وَيُخْرِجْ أَضْغَانَكُمْ ﴿37﴾ هَا أَنْتُمْ هَؤُلَاءِ تُدْعُونَ لِنَفْسِكُمْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ  
فَمِنْكُمْ مَن يَبْخُلُ ۖ وَمَنْ يَبْخُلْ فَإِنَّمَا يَبْخُلْ عَنِ نَفْسِهِ ۗ وَاللَّهُ الْغَنِيُّ وَأَنْتُمْ  
الْفُقَرَاءُ ۗ وَإِنْ تَتَوَلَّوْا يَسْتَبَدِلْ قَوْمًا غَيْرَكُمْ ثُمَّ لَا يَكُونُوا أَمْثَالَكُمْ ﴿38﴾

35. Mos u ligështoni e të kërkoni armëpushim, kur ju jeni më të fortët dhe Allahu është me ju! Ai nuk do t'ju pakësojë kurrë (shpërblimin për) veprat tuaja. 36. Vërtet, jeta e kësaj bote është veç lojë e dëfrim. Nëse besoni dhe druheni, Ai (Allahu) do t'ju shpërblejë dhe nuk do të kërkojë prej jush (krejt) pasurinë tuaj. 37. Se sikur t'ua kishte kërkuar (të tërën) e t'ju shtrëngonte, ju do të tregoheshit koprracë dhe, Ai do t'ua nxirrte në shesh urrejtjen tuaj. 38. Ja, ju jeni ata që thirreni të shpenzoni në rrugën e Allahut, por disa prej jush tregohen koprracë. Kush tregohet koprrac, ia bën vetes, sepse Allahu është i Pasuri, ndërsa ju jeni të varfrit. E, nëse ia ktheni shpinën, Ai do t'ju zëvendësojë me një popull tjetër, që nuk do të jetë si ju.” – (Muhamed, 35-38).

## LIDHJA E KËTYRE AJETEVE ME ATA PARAPRAKË

Në ajetet paraprake, sërish ishim dëshmitarët të përshkrimt të të dyja grupeve, besimtarëve dhe mohuesve. Ashtu siç është thënë edhe në fillim të komentimit, në këtë sure do të hasim shumë herë tek përmenden jobsimtarët, sepse edhe vetë koha e zbritjes së kësaj sureje, ka ndodhur pikërisht në kohën kur lufta mes besimit dhe kufrit, ishte ashpërsuar deri në maksimum. Dhe nuk është e rastësishme, që edhe pjesa e fundit që e përmbyll këtë sure të bekuar, të flasë sërish për këtë betejë në mes “dritës” dhe “errësirës” e cila betejë do të vazhdojë gjithmonë, mbase deri në Ditën e Gjykimit. Në këto ajete të fundit të kësaj sureje,

besimtarët porositen që të jenë të qëndrueshëm në rrugën e Allahut e të mos ligështohen. Porositen të shpenzojnë e të japin në rrugën e Allahut, e nga pasuria e tyre ta ndajnë edhe zekatin, për të varfrit. Nëse nuk e bëjnë këtë, Allahu do t'i zëvendësojë ata me një popull tjetër që do të luftojnë e do të qëndrojnë të patrembur në rrugën e Tij.

### KOMENT:

35. Mos u ligështoni e të kërkoni armëpushim, kur ju jeni më të fortët dhe Allahu është me ju! Ai nuk do t'ju pakësojë kurrë (shpërblimin për) veprat tuaja.

Ata që ngritën lart flamurin e Njëshmërisë, duke çarë pengesat e shumta në lartësimin e Fjalës së Zotit, vijnë sërish



në fokusin e këtyre ajeteve fisnike. Njëpërmyjet këtij ajeti, Allahu i Madhërishëm i këshillon besimtarët, që frytin e besimit të tyre të pastër, ta ruajnë me kujdes dhe atë farë të besimit ta mbjellin te çdo gjeneratë pasuese, duke qenë shembuj të sakrificës dhe qëndrueshmërisë në rrugën e vërtetë. Besimtarët porositen që kur të jenë në luftë me mohuesit dhe armiqët e tyre, të mos ligështohen, dhe në asnjë mënyrë të mos kërkojnë armëpushim, kur ata janë në epërsi dhe më të fortë në luftë. Vetëm në rast se armiku kërkon armëpushim, pa ndonjë hile a dinakëri, atëherë myslimanët mund ta pranojnë atë ofertë të tyre, gjithnjë duke ruajtur interesat e tyre strategjike, sepse një gjë të tillë nuk e ka ndaluar as Allahu xh.sh., kur në Kuran thotë: “Nëse ata shfaqin prirje për paqe, atëherë edhe ti ano nga ajo dhe mbështetu tek Allahu, sepse, vërtet, Ai dëgjon dhe di gjithçka” – (El-Enfal, 61). Një rast të tillë e kemi, kur kurejshët i patën ofruar paqe dhe armëpushim dhjetëvjeçar Pejgamberit a.s., në atë që njihet si Marrëveshja apo Paqja e Hudejbijes.<sup>1</sup>

Në kohën e zbritjes së kësaj sureje<sup>2</sup>, myslimanët ende nuk ishin të konsoliduar as si shtet e as si ushtri, por mesazhi i këtij ajeti është tejet largpamës, dhe i drejtohet çdo gjeneratë të myslimanëve nëpër shekuj. Kjo është madhështia e shpirti të atyre që janë brumosur me dashurinë e pafund ndaj Krijuesit të tyre. Kjo është ajo ndjenja e zjarrtë për fitimin e kënaqësisë së Allahut që i ka shtyrë përpara gjeneratat e myslimanëve që ta shpërndajnë fenë e Allahut në të katër anët e botës, pavarësisht rrethanave në të cilat janë gjendur. Islami, pati sukses pikërisht aty ku dështuan të tjerët, sepse është fe që nuk thërret në supremacion të një kaste të caktuar ndaj të tjerëve, por të gjithë pjesëtarët e vet i konsideron të barabartë para Zotit, pavarësisht pozitës që mbajnë në shoqëri.<sup>3</sup> Për këtë arsye, ky shkëlqim i Islamit do të vazhdojë, sepse ky është edhe premtim nga ana e Zotit Fuqiptotë, kur thotë: “Allahu, atyre prej jush që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, u ka premtuar se do t'i bëjë mëkëmbës (sundues) në Tokë, ashtu siç i pati bërë mëkëmbës (sundues) ata (besimtarë) që ishin para tyre. Ai do t'ua forcojë fenë e tyre, me të cilën është i kënaqur dhe frikën do t'ua shndërron në siguri...” – (En-Nur, 55).

Megjithatë, po kthehemi edhe njëherë te pjesa e ajetit “mos u ligështoni...” , sepse kuptimi i tij është madhështor, për shkak të porosisë që bart në vete. Fjala “la tehinu - mos u ligështoni” e ka burimin prej fjalës “el-vehn” që nënkupton

Allahu i Madhërishëm i këshillon besimtarët, që frytin e besimit të tyre të pastër, ta ruajnë me kujdes dhe atë farë të besimit ta mbjellin te çdo gjeneratë pasuese, duke qenë shembuj të sakrificës dhe qëndrueshmërisë në rrugën e vërtetë.

dobësinë, pamundësinë apo pa aftësinë për të bërë diçka, e në kontekst të këtij ajeti vjen me kuptimin që njeriu nuk bën t'i dorëzohet ndjenjës së frikës, sepse ajo dalëngadalë arrin të ndikojë në receptorët e ndjenjave tona, dhe na pamundëson të arrijmë qëllimet e larta.<sup>4</sup> Ndërkohë, Allahu na urdhëron që para se të përballemi me armikun, të përgatitemi mirë për luftë, e kur të fillojë lufta, atëherë mos të ligështohemi, por të qëndrojmë të fortë, stoik e të pathyeshëm, sepse lufta bart me vete dy fitore: ose ngadhënjim në fushëbetejë ose ngadhënjim me rënien shehid-dëshmor në rrugën e Allahut. Në lidhje me këtë parapërgatitje luftarake, i Madhërishmi po ashtu na thotë: “Përgatituni kundër tyre me sa fuqi që keni, përfshirë edhe kuajt e luftës, që të tmerroni armikun e Allahut dhe armikun tuaj, si dhe të tjerët përveç tyre, të cilët ju nuk i njihni, por që Allahu i njeh...” - (El-Enfal, 60).

Kurse pjesa tjetër e ajetit: “kur ju jeni më të fortët dhe Allahu është me ju!”, bart me vete dy kuptime. I pari, që kuptohet nga kuptimi i jashtëm i ajetit, nënkupton që gjatë betejave, kur ju jeni duke fituar dhe jeni më të fortë se armiku, mos u tregoni të ndjeshëm ndaj tyre e të kërkonin paqe dhe armëpushim, që pastaj mund t'ua dobësojë moralin, vrullin dhe elanin luftarak, por vazhdoni përpara deri në ngadhënjim përfundimtar, sepse Allahu është gjithmonë në krah të besimtarëve, duke iu ndihmuar atyre, sa kohë që ata janë në rrugën e drejtë.<sup>5</sup>

Kuptimi tjetër i ajetit në mënyrë të tërthortë nënkupton se ju o besimtarë të singertë që jeni të nënshtruar ndaj Krijuesit me devotshmëri, do të jeni gjithmonë më të fortët dhe më të lartët. Kjo ngase ju jeni të lidhur me besim të paluhatshtëm në Zotin e gjithësisë, ju keni synime të larta e madhore dhe mbi të gjitha, epiteti “besimtarë” që e bartni në zemra, tregon për epërsinë dhe supremacionin që keni në raport me mohuesit e Njësshmërisë. Ju shpresoni nga Allahu ngadhënjim dhe shpërblim, të cilën gjithë mohuesit as e shpresojnë e as e kërkojnë.<sup>6</sup>

Kurse pjesa vijuese e këtij ajeti “dhe Allahu është me ju!”, bart me vete përgëzimin dhe premtimin e madh nga ana e Allahut të Madhërishëm për besimtarët, sepse Ai ka thënë: “Është detyra Jonë t'i ndihmojmë besimtarët.” - (Er-Rrum, 47).

Kjo do të thotë se kur Allahu është i kënaqur ndaj jush, Ai do të jetë gjithmonë në përkrahjen tuaj, dhe nuk do të jeni kurrë të vetmuar, por vazhdimisht do ta ndjeni një forcë të





padukshme që iu rri pas e ju fuqizon, sa herë që luftoni në rrugën e Allahut dhe e lartësoni Fjalën e Tij.<sup>7</sup>

Ajeti përfundon me fjalët: “Ai nuk do t’jua pakësojë kurrë (shpërblimin për) veprat tuaja.”, që nënkupton se i Lartmadhërishmi nuk do t’ua pakësojë shpërblimin për veprat tuaja të mira, sepse Ai nuk i bën padrejtësi askujt. Drejtësia e Tij është unike, e paparë dhe e papërsëritshme. Ai është i Drejti dhe i Mëshirshmi ndaj robërve të Vet, madje në Ahiret, mëshira e Tij, do të jetë e pakufishme për besimtarët e Njëshmërisë.

36. *Vërtet, jeta e kësaj bote është veç lojë e dëfrim. Nëse besoni dhe druheni, Ai (Allahu) do t’ju shpërblejë dhe nuk do të kërkojë prej jush (krejt) pasurinë tuaj.*

Në raport me jetën e përhershme të Ahiretit, jeta e kësaj bote vërtet është lojë, sepse është e shkurtër dhe nuk ia vlen ta sakrifikojmë Ahiretin, për hir të kënaqësive të përkohshme të kësaj bote.<sup>8</sup> Mbase për këtë arsye, Allahu xh.sh. sikur dëshiron të na e tërheq vëmendjen që të mos mashtrohemi nga joshja e kësaj bote kalimtare, e cila përveç që është një lojë e dëfrim, është po ashtu edhe garë e mburrje me pasuri e fëmijë ashtu siç ka ardhur në një vend tjetër në Kuran: “Dijeni se jeta e kësaj bote, nuk është tjetër veçse lojë, dëfrim e zbukurim, mburrje mes jush dhe përpjekje për shtim të pasurisë e të fëmijëve!” – (El-Hadid, 20)

Në lidhje me kënaqësitë e përkohshme të kësaj bote, i Madhërishmi po ashtu thotë: “Çdo gjë që ju është dhënë, është veçse kënaqësi e jetës së kësaj bote dhe stoli e saj, kurse ajo që është tek Allahu, është më e mirë dhe e përhershme. Vallë, a nuk mendoni?! A mund të jenë njëllor ai, të cilit i kemi premtuar shpërblim të mirë dhe që do ta marrë, dhe ai, të cilit i kemi dhënë kënaqësi në jetën e kësaj bote, por që në Ditën e Kiametit, do të jetë prej atyre që do të hidhen në zjarr?!” – (El-Kasas, 60-61).

Pra, çdo veprim në këtë botë që del nga sfera e seriozitetit dhe e përpjekjeve për ta arritur kënaqësinë e të Madhit Zot, vërtet i ngjan një loje dhe një papjekurie, prandaj të tillët që mashtrohen nga lakmitë e përkohshme të kësaj bote, nuk do të kenë hise në shpërblimet e amshueshme të Ahiretit.

Nëpërmjet këtij pasusi të parë të ajetit, Allahu xh.sh. dëshiron t’i nxisë besimtarët që të vazhdojnë përpjekjet e tyre në rrugën e Allahut, dhe lartësimin e Fjalës së Tij, e të mos joshen a mashtrohen nga ndonjë e mirë e kësaj bote siç janë pasuria, fëmijët etj. Vetëm ata që e ruajnë dëlirësinë e tyre shpirtërore, do të jenë fitimtarët e vërtetë, sepse edhe pjesa e dytë e ajetit e konfirmon pikërisht një gjë të tillë: “Nëse besoni dhe druheni, Ai (Allahu) do t’ju shpërblejë dhe nuk do të kërkojë prej jush (krejt) pasurinë tuaj.”

Pra, devotshmëria dhe ndrojtja ndaj Allahut, janë rruga e shpëtimit, sepse Allahu do t’i shpërblejë vepërmirët nga besimtarët e Njëshmërisë, duke mos ua humbur shpërblimin për veprat e bëra.

Në lidhje me këtë, Ai në Kuran thotë: “O ju që keni besuar! Kijeni frikë Allahun dhe besoni të Dërguarin e Tij, se Ai do t’ju japë dyfish nga mëshira e Tij, ju dhuron dritë që të ecni me të, dhe ju fal gjynahet. Allahu është Falës e Mëshirëplotë.” – (El-Hadid, 28).

Përveç kësaj, Ai nga ta kërkon që të japin një pjesë të caktuar të pasurisë, e cila është pothuajse simbolike, në mënyrë që vëllezërit e tyre të varfër nga besimtarët, të kenë mundësinë e një jetese më të dinjitetshme. Në pyetje është zekati në pasuri, i cili është bërë obligim nga i Madhi Zot, për të gjithë ata besimtarë, pasuria e të cilëve e arrin nisabinsasinë e kërkuar që obligon dhënien e tij.

37. *Se sikur t’ua kishte kërkuar (të tërën) e t’ju shtrëngonte, ju do të tregoheshit koprracë dhe, Ai do t’ua nxirrte në shesh urrejtjen tuaj.*

Nëpërmjet këtij ajeti, vërehet qartë tendenca e njeriut për lakmi ndaj të mirave të kësaj bote duke grumbulluar pasuri. Allahu xh.sh. duke e njohur mirë shpirtin lakmitar të njeriut, thotë se sikur t’ua kishte kërkuar krejt pasurinë, duke insistuar dhe duke ju shtrënguar që detyrimisht ta jepnit atë, gjithsesi kjo do ta shpërfaqte anën tjetër të shpirtit të njeriut, lakminë dhe dashurinë ndaj kësaj bote. Madje, një gjë e tillë, atyre që janë të dobët në besim, do t’ua shpërfaqte ligësitë dhe urrejtjet e tyre që i mbajnë të fshehura në zemra.<sup>9</sup> Kjo është mbase edhe arsyeja, që Allahu, dëshiron t’i sprovtojë zemrat e robërve të Tij të sinqertë, e në këtë sprovë vihen nësoj si të varfrit ashtu edhe të pasurit. Nëse të varfrit, janë të durueshëm dhe i mbështeten Zotit, do të jenë fitimtarët më të mëdhenj, e nëse të pasurit, nuk japin zekatin në dobi të vëllezërve të tyre të varfër myslimanë, atëherë konsiderohen mëkatarë dhe pa dyshim do të sprovohen me gjëra të cilat ua dobësojnë edhe më imanin. Dihet se dashuria ndaj pasurisë e vdes zemrën,

por prej kësaj sprove, ata mund të shpëtojnë vetëm nëse e konsiderojnë pasurinë e tyre si një dhuratë nga Zoti, dhe ia dinë vlerën, duke e shpenzuar atë në rrugën e Allahut, e cila është një fushë e pakufishme për mirësi.

38. *Ja, ju jeni ata që thirreni të jepni (shpenzoni) në rrugën e Allahut, por disa prej jush tregohen koprracë. Kush tregohet koprrac, ia bën vetes, sepse Allahu është i Pasuri, ndërsa ju jeni të varfrit. E, nëse ia ktheni shpinën, Ai do t'ju zëvendësojë me një popull tjetër, që nuk do të jetë si ju.*"

Kjo sure e bekuar, përfundon me këtë këshillë madhore nga i Lartmadhërishti, drejtuar besimtarëve të sinqertë. Ajeti në fjalë u flet në mënyrë shumë të drejtpërdrejtë atyre që e stolisën veten me kurorën e besimit, që të jenë të kujdesshëm, që kur ftohen nga Allahu të japin e të shpenzojnë në rrugën e Allahut, të mos tregohen koprracë e dorështrënguar, sepse kjo veti është veti e shëmtuar dhe mbi të gjitha djallëzore. Fundja, nëse ne tregohemi koprracë, nuk i bëjmë dëm Allahut aspak, por e dëmtojmë vetveten, sepse Allahu është i Pasuri dhe nuk ka nevojë për asgjë nga krijesat, kurse ne jemi të varfrit dhe nevojtarët për mëshirën dhe bekimet e Tij.

Besimtari duhet ta kuptojë, se kjo pasuri që i është dhënë në këtë dynja, është amanet dhe si të tillë duhet të trajtojmë me shumë kujdes. Sa e sa të pasur nëpër shekuj kanë rënë pre e lakmive dhe tundimeve të kësaj bote. Ta marrim si shembull vetëm Karunin, një pjesëtar i Beni Israilëve që jetoi në kohën e Musait a.s.. Meqë ai u mburr dhe u krenua se këtë pasuri e kishte fituar vetë duke u pozicionuar në krah të faraonit dhe kundër Musait a.s., atëherë si dënim për këtë mendjemadhësi të tij, Allahu i Madhërishtëm e fundosi në tokë me tërë pasurinë e tij që kishte në posedim: "Dhe Ne e fundosëm atë (Karunin) dhe pallatin e tij në tokë dhe askush nuk arriti që ta mbronte nga dënimi i Allahut, madje as ai vetë nuk mund ta mbronte veten" - (El-Kasas, 81).

Njerëzit e mençur nga kjo histori marrin mësim se pasuria e madhe e Karunit, nuk paraqet asgjë në peshojën e Allahut, sepse Allahu nuk e vlerëson arin, thesarin, margaritarët dhe bagëtinë, nëse shpirti i njeriut është i errët nga brenda.<sup>10</sup>

Çdo besimtar i pasur, nëse tregohet arrogant dhe dorështrënguar në ato detyrime që ia ka caktuar Allahu xh. sh., siç janë zekati, sadekatul fitri dhe bamirësia ndaj të varfërve, duhet të dijë se jeta jonë në këtë botë nuk është e përjetshme, por është kalimtare dhe shkon sa qel e mbyll sytë. Lakmia e pakufishme për pasuri, ruana Zot, edhe mund t'i largojë njerëzit krejtësisht nga besimi, dhe atëherë, të tillët vërtet do ta meritojnë hidhërimin e Allahut, dhe i Plotfuqishmi do t'i zëvendësojë këta me popuj të tjerë, të cilët nuk do të jenë koprracë, por do të flijohen në rrugën e Allahut me jetën dhe pasurinë e tyre. Mbase nëpërmjet këtij ajeti, jepet një shenjë, se Islami do të përhapet ndër popuj të ndryshëm të botës, që nuk janë arabë, ashtu siç edhe ka

ndodhur, e të cilët janë edhe numerikisht shumë më tepër se arabët. Ky është mendimi i Hasan el Basriut.<sup>11</sup>

Në anën tjetër, ky ajet njëkohësisht është kërcënimimi më i madh hyjnor, drejtuar një grupi të caktuar besimtarësh, të cilëve Allahu ua mundësoi të kenë pasuri në këtë botë, por nëse ata bëhen koprracë dhe nuk japin në rrugën e Zotit, atëherë Ai mund t'i zhdukë përnjëherë nga faqja e dheut dhe në vend të tyre të sjellë njerëz, zemrat e të cilëve pulsojnë me dashuri të papërshkrueshme ndaj të Gjithëmëshirshmit, dhe janë në gjendje të flijohen në tërësi, vetëm e vetëm që ta arrijnë kënaqësinë e Krijuesit të tyre dhe Xhenetin e amshueshëm.

### POROSIA E AJETEVE (35-38)

- Myslimanët në asnjë mënyrë nuk bën të ligështohen e të kërkojnë armëpushim, kur në fushëbetejë janë në epërsi dhe kur e dinë se Allahu është me ta dhe është i kënaqur ndaj tyre. Ai, asnjërit nuk ia pakëson shpërblimin për veprat e tyre të mira.

- Jeta e kësaj bote, krahasuar me jetën e Ahiretit, është shumë e shkurtër, dhe po të vështrohet me kujdes, vërtet i ngjan një loje apo dëfrimi të përkohshëm. Njeriu më i lumtur do të jetë ai që nuk tundohet nga të mirat e kësaj bote, por bën sabër ndaj sprovave që e godasin, dhe si shpërblim do t'i ketë kënaqësitë e përjetshme të Ahiretit.

- Allahu na këshillon të mos bëhemi koprracë e as dorështrënguar, kur është në pyetje dhënia e pasurisë në rrugën e Allahut. Ai na porositi që të ndajmë një pjesë të pasurisë sonë - zekatin, në dobi të të varfërve nga mesi i myslimanëve.

- Besimtarët duhet të kenë kujdes që të mos bien në grackat e shejtanit e të bëhen egoistë, duke u mbyllur në gëzhjojën e lakmisë për pasuri, sepse Allahu mund t'i zëvendësojë ata me të tjerë, të cilët janë të gatshëm të flijojnë jo vetëm pasurinë, por edhe jetën në kërkim të kënaqësisë së Allahut.

1 Shih më gjerësisht: Muhamed el Gazali, Fikhu-s-Sireti, Kajro, 1965, ff. 348-367; Dr. Ahmed es-Sejid el Kumi, Tefsir sureti-l Fet'h, Kajro 1976, f. 24.

2 Surja Muhamed. (Sqarim yni S.B.).

3 Te'emmulat fi sureti Muhamed, f. 275.

4 Et-Tahriru ve-t-tenviru, vëll. XXVI, f. 130.

5 Havatiri havle-l Kurani-l Kerim, Kajro, 1991, f. 14355.

6 Et-Tes'hil li te'vili-t-tenzil, Tefsir xhuz'u Ahkaf fi sualin ve xhevabin, f. 177.

7 Fi Dhilali-l Kuran, vëll. XXVI, f. 3302.

8 Fajza Muhamed Seid, Suretu Muhamed s.a.v.s. vel kadaja el-leti tualixhuha, Mekë, 1403, f. 80.

9 Ahmed ibn Muhamed ibn Axhibeh, El-Bahru-l medid fi tefsiri-l Kurani-l Mexhid, Kajro, 2000, vëll. V, f. 379.

10 Ahmed Behxhet, Të Dërguarit e Allahut, Prishtinë, 2009, f. 333.

11 Imam Eth-Tha'lebi, El-Keshfu ve-l Bejan, Bejrut, 2002, vëll. IX, f. 39.

# Kaptina Kehf dhe metodat e edukimit që burojnë prej saj (2)

Dr. Valmire Batatina – Krasniqi

## METODA E EDUKIMIT ME ANË TË TREGIMEVE

Një nga metodat e edukimit që ka përdorur Kurani për të edukuar njerëzit dhe për t'i udhëzuar ata, është metoda e edukimit me tregime. Meqenëse ekzistojnë ligje të pandryshueshme që dominojnë shoqëritë, ngjarjet e përjetuara nga shoqëritë e kaluara janë çështjet që duhet të zbatohen në edukimin e shoqërive të ardhshme. Me këtë mënyrë u drejtua edhe Kurani, në të cilin këto ngjarje kanë zënë vend të veçantë.<sup>1</sup>

Në këtë kaptinë përshkruhen tri tregime të bukura të Kuranit, përmes të cilave fitohet përshtypje e madhe në fuqinë e pakufishme të Zotit Krijues. Në tregimin e parë, flitet për “*As’habul Kehf*”, për banorët e shpellës, të cilët flijuan rininë, familjet dhe gjithçka që kishin për hir të besimit të drejtë. Ata ishin disa djelmosha të rinj besimtarë, të cilët u larguan prej vendlindjes së tyre, me qëllim që ta ruajnë besimin dhe u strehuan në një shpellë, ku ndenjën në gjumë treqind e nëntë vjet, e pastaj Allahu i zgjoi prej atij gjumi aq të gjatë.<sup>2</sup>

Tregimi i dytë përshkruan takimin e Musait me njeriun e dijshtëm, me Hidrin dhe ngjarjet që e habitën Musain, sepse nuk ishte në gjendje t'i kuptojë fshehtësitë e tyre, prandaj edhe kundërshtonte. Përmendet rasti i prishjes së një anijeje, i

Ata ishin disa djelmosha të rinj besimtarë, të cilët u larguan prej vendlindjes së tyre, me qëllim që ta ruajnë besimin dhe u strehuan në një shpellë, ku ndenjën në gjumë treqind e nëntë vjet, e pastaj Allahu i zgjoi prej atij gjumi aq të gjatë.

mbyttjes së një djali të ri dhe i ndreqjes së një muri të shtrembëruar. Ai njeri i dijshtëm, që ishte peygamber, i tregoi Musait për fshehtësinë e atyre ngjarjeve.<sup>3</sup> Edhe pse ky tregim është një histori më vete, ai ka një lidhje me tregimet e banorëve të shpellës dhe i mbështet ato. Në tregimin e tretë përshkruhet sundimi i Dhulkarnejnit, një sundimtar i drejtë dhe i devotshëm, të cilit Zoti i kishte dhënë pushtet të gjerë në Lindje e Perëndim dhe i cili kishte ndërtuar një pendë të madhe.<sup>4</sup> Nga këto tregime nënkuptohet që Kurani duke i përgjithësuar ngjarjet si një tabelë mësimi, nuk sjell detaje si, vendin dhe kohën, gjatë përshkrimit të tyre, ngase janë mesazhi dhe perceptimi i saktë i tyre ajo që duhet dhënë rëndësi, dhe jo hollësitë e tjera. Këto tregime të cilat janë përshkruar si ngjarje nga të cilat merret mësim, fillimisht përshkruhen në një formë të përmbledhjes, pastaj shtjellohen në skena, lihen boshllëqe mes skenave dhe nga ajetet vijuese kuptohet se si duhet të ndërliidhen këto zbrazëtira në mes tyre.<sup>5</sup>

Pra, qëllimi i tregimeve të Kuranit nuk është thjesht për të treguar disa ndodhi historike, por të japin mësim dhe mesazhe nga të cilat mund të përfitohet. Nga këto tregime nxirren disa parime morale të cilat paraqiten në një stil përfaqësues dhe konciz.

Zoti xh.sh. shpreh padrejtësinë e atyre të cilët i bënë shokë Atij duke shprehur faktin që veprat e mohueseve, si: zemra e ngurtë, psikologjia e mohimit, zbukurimi i djallit, parja e veprave të tyre të këqija si të mira dhe të shëmtuarave si të bukura, janë të kota dhe të padobishme në Ahiret.

### METODA E RIKUJTIMIT

Një metodë të rëndësishme të edukimit që hasim në kaptinën Kehf është metoda e rikujtimit. Këtë metodë të cilën mund ta përshkruajmë si evokimi i njohurisë paraekzistuese në mendje, dhe ndërtimi i informacioneve të reja mbi të, është një metodë trajnimit që haset shpesh në edukim, veçanërisht në edukimin kuranor. Në edukim, kjo metodë përdoret më së shumti në trajnimin e emocioneve, sepse kujtimi i një personi për një çështje që ai e njeh më parë ndikon thellë në shpirtin e tij. Në lidhje me këtë, në kaptinën Kehf thuhet: “*Ato qytete Ne i shkatërroam kur banorët e tyre bënë të këqija dhe, për shkatërrimin e tyre, Ne kishim caktuar një afat.*”<sup>6</sup> Në ajetet që u paraprinë këtyre, përmendet se gjëja që i pengon njerëzit nga besimi është se ata presin që t’u vijë fatkeqësitë që u kanë ndodhur popujve të kaluar ose t’u vijë dënimi. Në këtë mënyrë, Allahu i Plotfuqishëm u kujton njerëzve atë që ndodhi me kombet e kaluara dhe siguron që njerëzit të marrin një mësim dhe të mos bëjnë të njëjtin gabim.

### METODA E MËSIMDHËNIES ME PROVERBA (DARB-I METHEL)

Metodë kjo, që përdoret në edukim, veçanërisht në shpjegimin e çështjeve të paqarta ose në krahasimin e së mirës me të keqen. Kjo metodë ka shumë përfitime për sa i përket edukimit dhe trajnimit, e po ashtu edhe në sqarimin e ideve dhe mendimeve abstrakte apo konkrete, të cilat i sjell në një mënyrë që të mund të kuptohen lehtësisht nga të gjithë. Gjithashtu kjo metodë është një ndër metodat e rëndësishme që Kurani përdor në stërvitjen e mendjes njerëzore. Kurani ia paraqet gjendjet shpirtërore mendjes njerëzore duke i krahasuar ato me gjërat materiale. Teksa Kurani përdor këtë metodë, ai i kushton vëmendje ndjesive në mendjen e njeriut. Shembuj të kësaj metode hasim edhe në kaptinën Kehf, në

të cilën paraqiten tri figura. Së pari, shembulli i një pasaniku rebel, i cili është krenar dhe arrogant me pasurinë e tij, dhe një të varfëri të bindur që ndihej i nderuar me besimin tij.<sup>7</sup>

Së dyti, jeta e kësaj bote e përshkruar si e përkohshme dhe kalimtare, kurse në anën tjetër rëndësia e Ahiretit dhe skenat e tmerrshme nga dita e kiametit.<sup>8</sup> Sejid Kutbi, thotë që në këto histori përfaqësuese, tregohet shembulli i vlerave të përkohshme dhe vlerave të përhershme. Në tregimin e parë zbulohen dy lloje njerëzish, njëri prej të cilëve krenohet me të mirat që posedon nga kjo botë, kurse tjetri ndjehet i nderuar të jetë në rrugën e Zotit, e që të dy janë shembuj konkret për njerëzit.<sup>9</sup> Së treti, Iblisi, i cili është një shembull i “krenarisë dhe arrogancës” në kundërshtim të urdhrat të Zotit xh.sh. në mos bërjen sexhde ndaj Ademit, dhe si rrjedhojë dëbimi dhe privimi i tij nga mëshira e Zotit xh.sh..<sup>10</sup> Siç shihet, këtu është shpjeguar me shembuj konkret se jeta e kësaj bote dhe begatitë e saj janë kalimtare, prandaj njerëzit nuk duhet të mbështeten në to. Po ashtu përmendet edhe fakti që rebelimi ndaj Zotit nuk sjell asgjë tjetër përveç humbjes dhe dëshpërimit.

### METODA E MËSIMDHËNIES ME PYETJE-PËRGJIGJE

Metoda pyetje-përgjigje, e cila është më e përdorura pas metodës së leksionit në historinë e edukimit, përdoret për qëllime të tilla si aktivizimi i mendjes së dëgjuesit dhe tërheqja e vëmendjes së tij në një pikë të caktuar. Edhe në kaptinën Kehf, kjo metodë është përdorur në disa vende dhe në disa mënyra. Në ajetin: “Ky populli ynë ka zgjedhur në vend të Tij zota të tjerë, ndonëse ata nuk u sjellin dot asnjë provë të qartë. E kush është keqbërës më i madh, se ai që trillon gënjeshtër për Allahun?”<sup>11</sup>, sillet një pyetje mohuese me të cilën vëmendja e njerëzve tërhiqet në një pikë të caktuar. Stili i pyetjeve është ai që e mban gjithmonë të gjallë vëmendjen. Kështu, Kurani duke përdorur këtë metodë edukuese, bëri që mesazhet e tij të jenë më efektive dhe të



qëndrueshme. Po ashtu në ajetet: “Vallë, a mendojnë mohuesit, se do të mund t’i zgjedhin robërit e Mi si mbrojtës, në vendin Tim?!<sup>12</sup>”, hasim një stil pyetësor me të cilin Zoti xh.sh. shpreh padrejtësinë e atyre të cilët i bënë shokë Atij duke shprehur faktin që veprat e mohueseve, si: zemra e ngurtë, psikologjia e mohimit, zburimi i djallit, parja e veprave të tyre të këqija si të mira dhe të shëmtuarave si të bukura, janë të kota dhe të padobishme në Ahiret. Të gjitha këto fakte janë shprehur në stilin pyetje-përgjigje për të qenë më të përhershme në mendjet e njerëzve.

## PËRFUNDIMI

Edukimi ka ekzistuar gjithmonë gjatë historisë së njerëzimit. Njerëzit, për ta ruajtur ekzistencën e tyre si shoqëri dhe për të rritur breza të dobishëm, kanë qenë të lidhur me edukim në një mënyrë ose në një tjetër. Kurani, qëllimi kryesor i të cilit është udhëzimi i njerëzve, njëherësh është edhe baza e edukimit islam. Për të kuptuar se si realizohet ky efekt i pamohueshëm i Kuranit, është shumë e rëndësishme të kuptohet aspekti edukativ i tij. Prandaj, është e nevojshme të shqyrtohet Kurani për të kuptuar strukturën, metodat dhe qëllimet e edukimit islam.

Kaptina Kehf, e cila në thelb është një sure që u shpall për të mbjellë njëshmërinë e Zotit te njerëzit, për të

tërhequr vëmendjen ndaj natyrës së përkohshme të jetës së kësaj bote dhe për të vënë në dukje se jeta e vërtetë dhe e përjetshme është bota e pastajme, paralelisht përfshin aspektin edukativ të Kuranit në përgjithësi, i cili është i përshtatshëm me natyrshmërinë e njeriut në tërësi. Kriteri në metodën e edukimit i përfshirë në këtë kaptinë është në përputhshmëri me karakterin e qenies njerëzore. Ajo parashtron parimet e metodës së edukimit në kuadër të sjelljes së njerëzve. Për këtë arsye, kjo metodë e edukimit është e përshtatshme për natyrën e tij. Atij nuk i imponohet asgjë dhe çdo metodë edukative e shprehur në Kuran është e përshtatshme me natyrshmërinë e tij.

1 Sait Shimshek, “*Gunumuz Tefsir Problemleri*”, Stamboll, Shtëpia Botuese “Kitap Dünyası”, f. 367.

2 Kehf, 18/9-26.

3 Kehf, 18/60-82.

4 Kehf, 18/84-88.

5 Sejjid Kutub, “*Et-Tasviru'l-Fenni fi'l-Kur'an*”, Kajro, Daru'sh-Shuruk, f. 180-181

6 Kehf 18/59.

7 Kehf 18/32-44.

8 Kehf 18/45-49.

9 Sejjid Kutub, “*Fi Dhilali'l-Kur'an*”, v. VII, f. 409.

10 Kehf 18/50-53.

11 Kehf, 18/9, 15, shiko: 57.

12 Kehf, 18/102, po ashtu: “*Thuaj: “A doni t’ju lajmëroj për ata që më së shumti, humbasin nga punët e veta, për ata, përpjekja e të cilëve ka qenë e kotë në jetën e kësaj bote, ndërkohë që mendonin se po bënin vepra të mira?”* Kehf, 18/103-04.

# Ëmbëlsia e Kuranit fisnik i përvetëson zemrat

Dr. Ajni Sinani

*“Muzikaliteti dhe rima e Kuranit shkaktojnë ndikim magjik në shpirt, ku shndrisin mendimet me fuqinë e tyre dhe pamjet me shkëlqimin e vet. Askush, s’mund të mohojë se ritmi i tij mahnitës dhe spiritualiteti i tij i shkëlqyer, ndikojnë në ndijimin tonë, dhe në atë se Muhamedi a.s. është i frymëzuar nga madhëria dhe madhështia e Allahut.”<sup>1</sup> (J. S. Restler)*

Me elokuencën dhe retorikën e tij, Kurani ushtron ndikim të jashtëzakonshëm në zemrat e njerëzve. Përmes vargëzimit të fjalëve, tingujve, zanoreve dhe bashkëtingëlloreve të pazëshme, rrokjeve të gjata e të shkurta Kurani i ekzalton zemrat.

Disa idhujtarë u munduan ta paraqitnin Kuranin si poezi. Ata e dinin se çështja nuk është ashtu dhe se ajo që solli Muhamedi a.s. ishte diçka jo e zakonshme në gjuhën e tyre. Por kjo bëhej me qëllim që të luftonin fenë islame dhe nga fakti se bukuri e tekstit kuranor do të ndikonte në popull dhe prandaj përpiqeshin ta përshkruanin si poezi.<sup>2</sup>

Gjuha e Kuranit ka bukuri magjepsje, shprehi të pakufishme, rrjedhshmëri, ritëm, magjepsje dhe shkëlqim. Është një mrekulli tepër e thellë, e jashtëzakonshme, tejet delikate dhe shumë përtej arritjes njerëzore.<sup>3</sup>


Kurani sipas formës, shprehjeve, shkronjave, përmbajtjes, bukurisë së të shprehurit, saktësisë së gjuhës, paraqet diç të pamundur për mundësitë njerëzore.<sup>4</sup> Ai ka harmoni dhe muzikalitet të brendshëm. Sa herë që njeriu këndon Kuran, e ndjen gjer në thellësitë e shpirtit të tij efektin e kësaj melodie të brendshme.<sup>5</sup>

Ibn Haxheri, ka thënë se nuk ka mosmarrëveshje në mesin e të mençurve se Libri i Zotit të Madhëruar është mrekulli dhe askush nuk ka mundur ta kundërshtonte atë pasi i sfidoi ata.<sup>6</sup> Për një njeri objektiv, dëgjimi i Kuranit i mjafton që ta kuptojë se është fjalë e Zotit. Prandaj, Zoti i Plotfuqishëm e urdhëroi Pejgamberin a.s. t’ua këndonte vetë

Kuranin njerëzve që ta dëgjonin prej tij. Kështu, në ajetin kuranor thuhet: *“E nëse ndokush prej idhujtarëve të kërkon strehim, ti strehoje në mënyrë që t’i dëgjojë fjalët e Allahut (Kuranin), e mandej përcille deri në vendin e tij të sigurt. Këtë, sepse ata janë popull, që nuk e di (të vërtetën e fesë islame)”* (Et Tevbe, 6).

Me elokuencën dhe retorikën e tij, Kurani ushtron ndikim të jashtëzakonshëm në zemrat e njerëzve. Përmes vargëzimit të fjalëve, tingujve, zanoreve dhe bashkëtingëlloreve të pazëshme, rrokjeve të gjata e të shkurta Kurani i ekzalton zemrat.<sup>7</sup> Madje, përkthyesi i Kuranit në gjuhën angleze do të shprehet: *“Sa herë që dëgjoj leximin e Kuranit më duket sikur dëgjoj muzikë, melodia e së cilës përcillet me të rrahura të përhershme të lodrave, dhe kjo (më krijon emocione të fuqishme) sikur më pëlcet zemra ime.”<sup>8</sup>*

Mrekullia e ndikimit është një nga llojet e mrekullisë kuranore. Është një aspekt i cili përfaqësohet në ndikimin e dukshëm ose të brendshëm që lë Kurani te dëgjuesi ose lexuesi i tij. Ai nuk mund t’i rezistojë dhe ta injorojë atë. E fascinon edhe nëse ai është një jobesimtar. Zoti tregon se një grup nga xhinët u habitën kur dëgjuan Kuranin fisnik: *“Thuaj: “Mua më është shpallur, se një grup i vogël nga xhinët i vuri veshin dhe dëgjoji (Kuranin) dhe (kur u kthyen te të vetët) thanë: “Ne kemi dëgjuar një Kuran që mahnit, që*



udhëzon në të vërtetën, prandaj ne i besuam atij dhe Zotit tonë, kurrsesi nuk do t'ia shoqërojmë më askënd” (El Xhinn, 1-2). Këto vargje tregojnë një moment befasi për xhinët me këtë Kuran, që i tronditi ata dhe besuan Kuranin, andaj u nisën me besim drejt popullit të tyre.<sup>9</sup>

### **KURANI ME ËMBËLSINË E TIJ PËRFITOI ZEMRËN E THABIT IBËN KAJISIT**

Thabit ibën Kajsi ishte njëri nga zotërinjtë e fisit Hazrexh. Ai ishte orator i shkëlqyer dhe i famshëm. Kur fliste, ua tejkalonte oratorëve, e kur mbante fjalim, i bënte për vete të gjithë ata që e dëgjonin. Ai ishte ndër të parët në Medinë që e pranoi Islamin. Posa e dëgjoji një ajet kuranor, që ia lexoi Musab ibnu Umejri me zërin e tij të ëmbël dhe tingullin e tij jehues, ai u përvetësua nga ëmbëlsia e Kuranit.

Pasi Muhamedi a.s. arriti në Medinë, Thabit ibën Kajsi, e priti atë me nderimet më të larta, me një grup kalorësish nga fisi i tij. Ai mbajti para tij një fjalim me një retorikë të lartë, duke e filluar atë me lavdi ndaj Allahut të Lartmadhëruar dhe duke e falënderuar Allahun xh.sh., pastaj u lut për falje dhe shpëtim për të Dërguarin a.s. Që nga ajo ditë, Pejgamberi a.s. e emëroi Thabit ibën Kajsin për orator të vetin, ashtu siç ishte Hasan ibën Thabiti poet i tij.

### **MOTRA E IMRUL KAJISIT ZBRITI KASIDEN E TË VËLLAIT NGA MURET E QABESË**

Në fillim të shpalljes, motrës së poetit Imrul Kajs, poezitë e të cilit kishin fituar vendin e parë në konkurset poetike dhe ishin varur në muret e Qabesë (mualakat), i ishin kënduar disa ajete nga Kurani. Kur i dëgjoji ajetet e Kuranit, ajo tha: “Kjo nuk mund të jetë fjalë njeriu! Po qe se mbi tokë ekziston një fjalë e tillë, nuk është me vend që poezitë e tim vëllai të qëndrojnë varur në muret e Qabesë. Ato duhen zbritur dhe, në vend të tyre, duhen varur këto fjalë!” Pastaj, ajo me duart e veta, e zbriti kasiden e të vëllait nga muret e Qabesë. Pastaj u hoqën edhe poezitë e tjera të varura nën të si shprehje e nivelit të tyre më të ulët.<sup>10</sup>

### **VELID BIN EL-MUGIREH MBETI I HABITUR PARA KURANIT**

Velid ibn el-Mugireh nga Beni Mahzum, që shquhej në mesin e arabëve për aftësi letrare, ishte ftuar për ta sfiduar Kuranin. Siç përcjell Ibni Abasi, njëri nga paria e idhujtarëve, Velidi, ka shkruar një ditë te Pejgamberi a.s. dhe i ka kërkuar që të lexonte nga Kurani i shenjtë.

Dhe i Dërguari i Allahut i ka kënduar ajetin “*Allahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmve, e ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të merrni mësim.*” (En Nahl, 90). Velidi i ka thënë: “Në këtë

fjalë ka një ëmbëlsi të tillë, një bukuri dhe shkëlqim të tillë që kjo i përngjet një peme të blertë me rrënjë të ujitura dhe degët plot fruta. Është e pamundur që këtë ta thotë një njeri. Pa asnjë dyshim, kjo fjalë është eprore ndaj çdo gjëje. Kurse ndaj saj nuk mund të dalë eprore asgjë dhe ajo i mund patjetër kundërshtarët!” Kur dëgjoi për këtë Ebu Xhehli, shkoi tek ai, dhe i tha: “Gjersa të mos thuash diçka kundër tij, fisi yt nuk do të jetë i kënaqur me ty!” Velidi i tha: “Më lër të mendohem pak.” Pastaj tha: “Kjo është një magji e përcjellë!”<sup>11</sup>

Këtë qëndrim të tij, Zoti e përshkruan në Kuran: “Pse ai shumë mendonte, radhite e përgatiste (për Kurantin). Qoftë i shkatërruar, po si planifikonte. Prapë qoftë i shkatërruar, po si planifikonte. Ai sërish thellohej në mendime. Pastaj mrrolej dhe bëhej edhe i vrazhdë. Pastaj ktheu shpinën me mendjemadhësi. E tha: “Ky (Kurani) nuk është tjetër, vetëm se magji që përcillet prej të tjerëve. Ky nuk është tjetër, përveç fjalë njerëzish!” (El Muddethir, 18-25). Edhe pse e dinte se Kurani ishte fjalë e Zotit, ai për të mos e humbur pozitën e vet ndër idhujtarë e quajti magji.

### POETI TUFEJL BIN AMRI U DORËZUA PARA STILIT KURANOR

Tufejl bin Amri ishte poet. Kur ai shkoi në Mekë, disa vetë nga paria e idhujtarëve mekasë e takuan dhe i thanë: “O Tufejl, ti je poet dhe njeri që gëzon konsideratë mes fisit. Erdhe në vendin tonë, por duhet të kesh kujdes për këtë njeri të dalë nga mesi ynë! Gjendja e tij na ka shkaktuar shqetësime dhe na i shkatërroi shoqërinë dhe punët. Fjala e tij e efektshme si magji e ndan njeriun nga i ati, nga i vëllai e nga gruaja. Kemi frikë se mos kjo që na ka rënë në kokë neve, ju bie në kokë edhe juve dhe fisit tënd. Kurrresi mos fol me të dhe mos dëgjo asgjë prej tij!”

Më pas ai mendoi: “Unë jam poet dhe njeri i mençur. Unë i njoh edhe fjalët e bukura, edhe të shëmtuarat. Atëherë, ç’të keqe mund të ketë po t’i dëgjoj fjalët e këtij njeriu? Po të jenë të bukura, i pranoj, po të jenë të shëmtuara, i hedh poshtë!” Dhe priti në Qabe. Pastaj, kur i Dërguari i Allahut u nis të largohej për në shtëpi, ai e ndoqi pas dhe i tha: “O Muhamed! Fisi më tha kështu e ashtu për ty! A mund të ma tregosh këtë çështjen tënde?” Tufejli tregon: “I Dërguari i Allahut më foli për Islamin. Vallahi, unë kurrë s’pata dëgjuar fjalë më të bukur se Kurani dhe fe më të bukur se Islami! Menjëherë u bëra mysliman dhe dëshmovava se nuk ka zot tjetër përveç Allahut!” Pasi qëndroi disa ditë pranë Profetit, kërkoi leje dhe u kthye te fisi i vet për të bërë kumtimin e Kuranit. Personi që iu përgjigj i pari ftesës së Tufejlit r.a., ishte sahabiu i njohur Ebu Hurejre r.a., i cili është ai që ka përcjellë më shumë hadithe.<sup>13</sup>

### HZ. OMERI I NDIKUAR NGA KURANI PRANOI ISLAMIN

Shumë njerëz janë bërë myslimanë në saje të retorikës dhe të bukurisë së shprehjes së Kuranit fisnik. Hz. Omeri, një ditë kishte ngjeshur shpatën në brez dhe kishte dalë në rrugë për ta vvarë Pejgamberin a.s.. Dikush i kishte thënë se motra dhe dhëndri yt e kanë pranuar Islamin. Kështu Omeri do të nisej drejt tyre duke përfunduar para portës së dhëndrit. Ai dëgjoi leximin e Kuranit. Pasi hyri brenda i sullet dhëndrit dhe e qëllon motrën në fytyrë. Kur ata dy i treguan se e kishin pranuar Islamin dhe nuk do të tërhiqeshin, ai kërkoi prej motrës duke i thënë: “Ma jep mua fletën që dëgjova duke lexuar më parë, të shoh se çfarë ka sjellë Muhamedi!” Pasi mori fletën dhe lexoi suren Ta Ha, i prekur nga elokuenca e saj tha: “Sa të bukura këto fjalë! Sa të çmuara!” Më pas shkoi te Muhamedi a.s dhe e pranoi Islamin.<sup>14</sup>

### XHUBEJR BIN MUTIMIT SA NUK I FLAKËROI ZEMRA

Xhubejrit r.a., kur e dëgjoi suren Et Tur nga Pejgamberi a.s., i prekur prej saj, iu duk sikur do t’i flakëronte zemra. Ai tregon: “E pata dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke kënduar suren Et Tur në namazin e mbrëmjes, dhe kur arriti tek ajetet: “A mos u krijuan pa krijues, apo ata vetë janë krijues? A mos ata i krijuan qiejt e tokën, jo, por ata nuk janë të bindur. A mos tek ata janë depot e Zotit tënd, apo ata i mbizotërojnë?” (Et Tur, 35-37), nga emocioni, zemra mu duk se do të më çahaj!”<sup>15</sup>

- 1 J. S. Restler, studiues bashkëkohor francez, shih: Dr. Imadudin Halil, Kalu anil Islam, Rijad, 1412/1992, sipas Ajni Sinani, *Të tjerët për Islamin*, Prishtinë, 2015, f. 104.
- 2 Sejjid Kutub, “*Jasini përkthim me komentim*”, Logos, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2011, f. 69.
- 3 Bassam Saeh, “*Gjuha e mrekullueshme e Kuranit, dëshmi e origjinës hyjnore*”, Tiranë, 2020, f.19.
- 4 Mustafa Mahmud, “*Dialogu me mikun ateist*”, Bashkësia Islame & Zëri Islam, Prizren, 2000/1421, f. 86.
- 5 Osman Nuri Topbash, “*Vargu i profetëve nën dritën e Kuranit, Hazreti Muhamed Muštajfa (Sal-lah-llahu alejhi ve sel-lem)*”, Shkodër, 2012, f. 261.
- 6 Dr. Halid Muhamed el Kuda, “*El ixhaz et tethiri lil Kuramil kerim*”, shih: <https://quran-m.com>
- 7 Osman Nuri Topbash, op. cit., f. 266.
- 8 Arthur J. Arberry, përkthyes i Kuranit në gj. angleze, Ahmed Dedat, “*Kurani mrekullia më e përsosur*”, Prishtinë, 2001, f. 15.; Ajni Sinani, op. cit., f. 78.
- 9 Dr. Halid Muhamed el Kuda, “*El ixhaz et tethiri lil Kuramil kerim*”, shih: <https://quran-m.com>
- 10 Ahmet Xhevdet Pasha, I, 83, sipas: Osman Nuri Topbash, op. cit., f. 265.
- 11 Hakimi, II, 550/3872; Taberiu, Tefsir, XXIX, 195-196; Vahidi, f. 468, sipas Osman Nuri Topbash, op. cit., f. 63.
- 13 Ibni Hisham, I, 407-408; Ibni Sa’d, Iv, 237-238, sipas Osman Nuri Topbash, op. cit., f. 271-72.
- 14 Biografia e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem, Sira nga Ibn Hisham, Sira Prishtinë, 2021, f. 89.
- 15 Buhari, Tefsir, 52, sipas Osman Nuri Topbash, op. cit., f. 265.



# Njeriu për nga udhëzimi – dija u përngjan llojeve të tokës

Prof. ass. dr. Musa Vila

**T**ransmeton Ebu Musa r.a. se Pejgamberit a.s. thënë: “Shembulli i udhëzimit dhe dijes, me të cilin Allahu xh.sh. më ka dërguar mua, është sikurse shi i bollshëm që ka rënë në tokë, një pjesë e së cilës ishte tokë pjellore, e cila e thithi shiun dhe rriti bimë e bar me begati. Ndërsa një pjesë tjetër e saj ishte e fortë duke e mbajtur ujin sipër dhe Allahu u solli dobi njerëzve me të; ata e përdorën atë për të pirë, për t’u dhënë ujë bagëtive dhe për të ujitur tokën për rritjen e breqetit. Ndërsa një pjesë tjetër (e tokës) prej saj ishte djerrë, e cila as nuk e mbante ujin dhe as nuk jepte breqet (tokë e tillë pa asnjë përfitim). (E para) shembulli i atij njeriu i cili e kuptoi fenë e Allahut dhe përfitoi (nga dija) të cilën Allahu xh.sh. e ka shpallur nëpërmjet meje (Muhamedit a.s.) e mëson atë dhe pastaj ua mëson atë të tjerëve. Shembulli i dytë është sikur ai njeriu, i cili nuk qanë fare kokën për të (dërgimin e Muhamedit a.s.) dhe nuk e pranon udhëzimin e Allahut që është shpallur nëpërmjet meje. (Një i këfillë është sikur toka e shkretë apo e djerrë).”<sup>1</sup>

## SHPJEGIMI I HADITHIT

Ky hadith në konotacionin e tij përmban rëndësinë, vlerën e dijes dhe lidhshmërinë e saj me jetën e njeriut. Njohuritë e njeriut për jetën, dijen dhe shkencën fillojnë prej momentit kur njeriu del në këtë botë e vazhdojnë deri në vdekje. Sa më shumë që njeriu të rritet, së bashku me të rriten njohuritë dhe përgjegjësitë për dijen dhe

Në kategorinë e parë bën pjesë personi i cili është shpirtmirë, zemërgjerë, me natyrshmëri të pastër, i cili nuk bën mëkate, nuk bën çrregullime, që është i orientuar kah udhëzimi hyjnor, kah mësimet e tij, përfiton në çdo hap të jetës, nuk lodhet e as nuk bëhet monoton, mishërohet me mësimet islame

shkencën. Mendja e njeriut është në gjendje të perceptojë njohuri të shkencave të ndryshme. Disa mendje janë të përgatitura për shkencë natyrore, e disa për shkencë shoqërore. Nëse mendja e njeriut përshtatet me shkencën që përputhet me të, rezultatet e njeriut në këtë shkencë do të jenë shumë efektive dhe marramendëse. Njeriu me përpjekjet që i bën mund të korrë suksese në lëmi të ndryshme, por suksesi më i madh do të ishte nëse e gjen veten në atë shkencë që përputhet me mendjen, logjikën, pasionin dhe me dashurinë e tij. Prej shkencave që zgjojnë interesim të veçantë te njeriu janë edhe shkencat hyjnore, humane dhe morale. Këto të fundit bëjnë lidhjen e mendjes me jetën, duke rregulluar lidhjet njerëzore me njëri-tjetrin, si dhe përmes dijes, njerëzisë, të vihen në shërbim të njëri-tjetrit.

Përmes dijes do të ndriçojnë rrugën e bamirësisë dhe lumturisë. Për qëndrimin e njeriut në raport me dijen, njohuritë dhe shkencën, më së miri na e sqaron hadithi i lartpërmendur. Allahu xh.sh. e ka dërguar Muhamedin a.s. me Kuran për t’i udhëzuar njerëzisë, për t’i drejtuar në rrugën e vërtetë, për t’i nxjerr nga errësira në dritë dhe për t’i afruar dhe miqësuar në bamirësi dhe devotshmëri. Interesi i të gjithë njerëzve është udhëzimi i drejtë. Këtë e konfirmon Kurani: “Kurani është zbritur udhëzues për njerëzisë...” (El Bekare, 185).

Kurani është një dritë e madhe që mund t’u shërbejë të gjithë njerëzve në globin tokësor, por jo të gjithë po përfitojnë nga

kjo dritë, përkundrazi ka përpjekje që njerëzit ende të vazhdojnë në errësirë dhe injorancë. Allahu xh.sh. thotë: “Ne u kemi zbritur një dritë të qartë (gjithëpërfshirëse – Kuranin).” (En Nisa, 174)

Qëllimi i Fjalës së Allahut është që njeriu ta ndërtojë zemrën dhe shpirtin e tij dhe të lidhet me Krijuesin e tij duke e mësuar Kuranin dhe fjalën e Profetit të Tij. Përmes fjalës hyjnore, njeriu do ta pastrojë veten, shpirtin, mendjen dhe do ta njohë të vërtetën e tij përse ka ardhur në këtë botë, kujt i shërben dhe ku do të transferohet pas kësaj bote.

### KATEGORITË E NJERËZVE NË RAPORT ME UDHËZIMIN DHE DIJEN

Në kategorinë e parë bën pjesë personi i cili është shpirtmirë, zemërgjerë, me natyrshmëri të pastër, i cili nuk bën mëkate, nuk bën çrregullime, që është i orientuar kah udhëzimi hyjnor, kah mësimet e tij, përfiton në çdo hap të jetës, nuk lodhet e as nuk bëhet monoton, mishërohet me mësimet islame, i cili kur flet, flet me mësimet e tij, flet me gjuhën e Kuranit dhe Syneetit, dhe që jeta e tij është në përputhshmëri të plotë me ligjet hyjnore dhe me dashurinë ndaj tyre. Fjalën e Krijuesit e dëgjon me vëmendje, e kupton dhe e mediton, pastaj shpirti i tij ndikohet thellë nga kjo fjalë e vërtetë, zemra hapet dhe gjymtyrët orientohen në praktikë. Këtë kategori të njerëzve, apo këtë person, Pejgamberi a.s. e ka ngjasuar në hadith me tokën e mirë pjellore, me tokën e gjelbër prodhuese, e cila kur t'i bie shiu e thithë atë, e mbijnë bimën, e rritë dhe e zhvillon, pastaj ajo bëhet ushqim për kafshët, dhe bereqeti kthehet prapë te njeriu, i cili nga kafshët përfiton qumështin, djathin, mishin dhe lëkurën. Ai shi që bie në tokën pjellore, kjo me plleshmërinë e saj prodhon rendimente që janë ushqim i drejtpërdrejt i njeriut, si pemët dhe perimet. Pra, toka pjellore e thith ujën në brendësinë e saj për interesa të njeriut, jep fruta, e gjelbëron bimën, e ngjall tokën, e rrit bimën, e ushqen kafshën për të mirën e njeriut. Kështu është edhe zbritja e Kuranit, i cili i gjallëron shpirtin, i freskon zemrat, i inspiron njerëzit për vepra të mira e humane, njeriu i jep mësim për veten e tij dhe e bën të dobishëm edhe për të tjerët. Për këtë kategori të njerëzve flet edhe ky citat i Kuranit: “Thuaj (o Muhamed) Ai (Kurani) është udhëzim dhe shërim për ata që besojnë.” (Fusilet, 44).

Këtij njeriu, Allahu xh.sh. i dha dobi nga ajo me të cilën kishte ardhur Pejgamberi i Tij, me udhëzimin dhe dijen, mandej përfitimi i tij u transmetua te të tjerët brez pas brezi deri në ditën e takimit me Zotin e tij.

### PERSONI QË ËSHTË KANDIL PËR TË TJERËT

Në kategorinë e dytë bën pjesë personi i cili e ka marrë mësimin nga udhëzimi dhe dija me të cilën ka ardhur Pejgamberi a.s.. Ai ka marrë mësimet të mjaftueshme dhe ka grumbulluar dije të ndryshme, kur flet, flet me gjuhën e



besimit, kur përgjigjet po ashtu përgjigjet me gjuhën e Islamit, kur shkruan e plotëson çdo kriter të shkrimit, kur polemizon me kundërshtarët e fesë i mposhtë pa fije problemi, mburret me dijen dhe argumentet që posedon, por ai me këto mësimet që posedon, me dijen që e ka, fare nuk mishërohet e as nuk përputhet me to. Dija e tij ndodhet në një luginë, ndërsa praktika e tij ndodhet në luginën tjetër, pra ndërmjet teorisë dhe praktikës ndodhet një kodër e madhe që nuk i lë të bashkohen apo të mishërohen njëra me tjetrën. Ai u bën dobi njerëzve, i udhëzon, ua sqaron të vërtetën dhe të drejtën, i këshillon, por praktika e tij është e zbehtë dhe e thatë sikur ajo toka që e grumbullon ujën, e mban, u bën dobi njerëzve, u bën dobi kafshëve, është një pellg që grumbullon ujë dhe ju jep të tjerëve, ndërsa vetja e tij është e etshme dhe ankon nga thatësia. Ky është dijetari i cili ka grumbulluar dije, u ka bërë dobi të tjerëve, është krenuar me të, por vetë është sikur kandili i cili të tjerëve u jep dritë, ndërsa vetë digjet, sepse ka dështuar në praktikën e tij sikurse ajo toka që të tjerëve ua ka grumbulluar ujën, ndërsa veten e saj e ka lënë të etshme. Sikur ai lumi i cili e bart ujën për të tjerët, e vetë nuk e pi asnjëherë. Pra, ky person e ka mësuar Kuranin, e ka kuptuar, i ka njohur dispozitat e hallallit dhe haramit, por asnjëherë nuk ua ka rekomanduar vetvetes së tij. Ky i përngjan atyre që Allahu ju drejtohet me këto fjalë: “Ju i urdhëroni njerëzit për përkushtim dhe harroni t’i zbaton ato vetë, ndërsa e lexoni Librin (Tevratin)! A nuk logjikoni pra?” (El Bekare, 44)

Ky kategorizim i njerëzve nuk potencohet në mënyrë direkte në hadith, por që lë të kuptohet në mënyrë indirekte pasi të krahasojmë dy grupet e potencuar në hadithin bazë.

## PERSONI QË NUK ËSHTË AS PËR VETE E AS PËR TJERËT

Në këtë kategori të tretë bën pjesë personi i cili nuk përfitoi për veten, e as nuk u bëri dobi të tjerëve. Ky njeri jeton në errësirën që nuk njeh dritë, nuk njeh mirësi e as udhëzim. Nuk e ngre zërin për të vërtetën e as që do ta dijë të vërtetën. Ai i ka dhënë vetvetes liri të plotë për t'i ushqyer pasionet e tij, për të arritur synimet e unit të tij dhe për t'i plotësuar ambiciet e tij të sëmura. Zemra e tij është e vdekur dhe indiferente ndaj çdo pozitiviteti njerëzor, fetar e human. Mendja e tij nuk ka ekuilibër në çështjet e duhura të jetës. Ai me mendjen e tij është plotësisht i njëanshëm duke u larguar përfundimisht nga peshoja e së vërtetës. Ai është futur në errësirat më të thella të detit. Ai është ndikuar thellë nga kënaqësitë e kësaj bote të përkohshme. Shpirti i tij është bërë i ligë, natyrshmëria e tij është prishur, humaniteti njerëzor i ka humbur, përgatitja e tij ka vdekur, sytë iu kanë verbuar dhe veshët iu kanë shurdhuar duke ia kthyer shpinën udhëzimit hyjnor, duke mos ia vënë mendjen fare. Këta e humbën vetveten dhe i humbën të tjerët për shkak të pasimit të epsheve të tyre. Këta e dinë se i kanë dy këmbë për të ecur, dy duar për të vepruar, dy sy për të parë, dy veshë për të dëgjuar. Nuk kanë synim tjetër me to, përveçse i kanë në shërbim të pasionit të tyre.

Këtë person Pejgamberi a.s. e ka ngjasuar në hadith me tokën e djerrë, tokën e shkretë përplot rërë që ujini e humbë në thellësinë e saj duke mos dhënë as bimë, as fryte, as nuk përfitoi nga shiu, e as nuk i bëri të tjerët të kenë dobi prej tij, as nuk rriti bimën, e as nuk i dha të pinë ujë kafshët e as njerëzit, tokë plotësisht e padobishme. I tillë ishte personi i cili fare nuk e vrau mendjen për udhëzimin dhe dijen me të cilën erdhi Pejgamberi a.s., e as nuk e pranoi, por përkundrazi e refuzoi me mendjemadhësi. Për këtë kategori të njerëzve Allahu iu ishte drejtuar me këto fjalë: “Për ata që nuk besojnë është njësoj, ua tërhoqë vërejtjen apo nuk ua tërhoqë, Allahu ka vulosur zemrat dhe dëgjimin e tyre, dhe në sy kanë perde (e nuk shohin). Për ta do të ketë ndëshkim të madh.” (El Bekare, 6-7)

## RETORIKA E HADITHIT

Në hadith është përdorur shembulli për t'u kuptuar synimi dhe për të qenë kuptimi i tij më afër mendjes. Pas anës së përgjithshme apo intonimit të përgjithshëm ka pasur detajizim.

Fjala e Pejgamberit a.s.: “ka rënë shiu në tokë” është me intonim të përgjithshëm, e që është pasuar me fjalën “e një pjesë e së cilës tokë” që është detajizim i intonimit të përgjithshëm. Në hadith kemi krahasim të ngjashmërisë ndërmjet cilësisë së dijes me kategoritë e njerëzve për nga përfitimi, dhe krahasimi i shiut me llojet e tokës për nga ana e mospërfitimit. Në hadith është zgjedhur fjala el-gajth prej

emrave të shiut si paralajmërim për nevojën e tij të domosdoshme për zbritje, pasi që toka ishte tharë, ashtu ishte nevoja e njerëzve për zbritjen e fjalës së Allahut te Muhamedi a.s., për t'i ringjallur zemrat dhe shpirtrat e njerëzve. Shiu ngjalli tokën e vdekur, ndërsa dija ngjallë zemrën e vdekur.

Fjala “rriti bimë e barë (tërfil)” është lidhshmëri ndërmjet intonimit specifik me intonimin e përgjithshëm, ngase fjala “el-ashebu” – bimë është e përgjithshme, ndërsa “el-keleu” tërfil është specifike, një lloj bime.

Fjala në hadith: “e mban ujini” dhe fjala tjetër “nuk e mban ujini” është përshtatshmëri e kundërt – “tibaku essilbi”, që nënkupton dy kënde të ndryshme.

Foljeve në hadith “kanë pirë, kanë ujitur”, u është hequr kundrina e drejtë për shkak se është e njohur, kështu fjalët imagjinohen të jenë “kanë pirë ujë njerëzit, kanë pirë ujë kafshët e tyre, i kanë ujitur tokat bujqësore”.

Po ashtu në hadith kemi lidhshmëri në mes intonimit të përgjithshëm dhe atij specifik “Atful-hasi alel-‘ami”. Fjala “el-huda” – udhëzim është e përgjithshme dhe përfshin të gjitha llojet e udhëzimit, ndërsa fjala “el-ilmu” – dije është specifike, ngase është prej llojeve të udhëzimit. Është cekur dija për shkak të rëndësisë që ka dhe për inkurajim për t'u kultivuar te çdo gjeneratë.

## KUSH ËSHTË EBU MUSA, TRANSMETUESI I HADITHIT?

Transmetuesi i këtij hadithit është sahabiu i njohur, Ebu Musa, Abdullah ibën Kajs el-Esharij. Ishte nga Jemeni, ndër të parët që pranoi Islamit dhe erdhi te Pejgamberi a.s. në Meke. Ai kishte bërë tre emigrime, hixhrete, për hir të Islamit. I pari ishte emigrimi në Meke prej Jemenit, i dyti prej Mekës në Abisini (Etiopi) dhe së fundi prapë prej Mekës për në Medine. Ishte i njohur për lexim të bukur të Kuranit. Pejgamberi a.s. i ka thënë: “Të është dhënë një melodi prej melodive të familjes së Davudit a.s.”<sup>2</sup>

Kishte zë të bukur dhe shquhej për lexim të mirë të Kuranit. Ai gjithashtu ishte hafëz i Kuranit, bënte ibadet të shumtë edhe gjatë natës. Ai ishte i njohur edhe si luftëtar i dalluar në fushat e betejës. Ishte i emëruar si mëkëmbës i Jemenit, pastaj në epokën e Omerit r.a. ishte udhëheqës i Basrës, kurse në epokën e Othmanit r.a. ishte udhëheqës i Kufes. Në kohën e Omerit r.a. kishte treguar shumë aftësi luftarake në disa vende për t'u çliruar. Tërë jeta e tij ishte në shërbim të xhihadit dhe thirrjes islame, e në veçanti si emisar special i Resulullahut a.s. në Jemen së bashku me Muadh bin Xhebelin. Ka transmetuar 360 hadithe prej Resulullahut a.s.. Vdiq në moshën gjashtëdhjetë e tri vjeçare në Meke, të vitit 50 h.

1 “Sahihul Buhari”, vëll. VIII, fq. 338, nr. 2278.

2 “Sahihul Buhari”, vëll. XV, fq. 470, nr. 4660.

# Rëndësia e konsultimit dhe komunikimit në formimin e shkollës hanefite

Dr. Ejup Haziri

Shkolla juridike hanefite është një shkollë e ndërtuar mbi sparimin e konsultimit dhe pranimit të mendimit nga tjetri. Nuk është një shkollë e bazuar vetëm në opinionin e themeluesit ku ai dikton gjithçka, ndërsa të tjerët shihen vetëm si spektatorë, por është një shkollë e ndërtuar mbi një komunikim dhe debat të shëndoshë ndërmjet pjesëmarrësve, ku secili kontribuonte në mënyrën e vet. Asnjëri nuk ndihej inferiorë e as i anashkaluar, prandaj edhe opinionet ishin të analizuar deri në detajet më të imta.

## AMBIENT I DIJES

Qyteti i Kufës dallonte nga qytetet e tjera. Në të mbaheshin ligjërata e mësimet të panumërta. Kufeja ishte shndërruar në një qendër të dijes ku mbaheshin qindra aktivitete të ndryshme. Vetëm në njërin xhami të saj mbaheshin disa tubime të dijes në të njëjtën kohë, ku dijetarët e fushave të ndryshme ishin pozicionuar nëpër vende të ndryshme të xhamisë dhe nxënësit e tyre e dinin vendin se ku të rreshtoheshin. Çdo fis kishte një xhami që faleshin 5 kohët e namazit dhe mbaheshin ligjërata e predikime. 14 fiset e Kufës kishin 14 xhami dhe ishte një garë sfiduese që synonte ta shtonte edhe më tej interesimin e jashtëzakonshëm për nxënien e dijes dhe përhapjen e saj. Me fjalë të tjera ishte një ambient ku dija lulëzonte dhe komunikimi ishte i hapur për të gjithë.

Në këto rrethana të favorshme për dijen dhe në këtë ambient impozant, lindi dhe u rrit Ebu Hanife, i cili njihet si themelues i shkollës hanefite, shkollë e cila nuk veçohet vetëm në bazë të emrit dhe mendimeve të tij, por edhe në bazë të nxënësve të tij, të cilët patën rol të rëndësishëm në hartimin dhe shpërndarjen e ideve dhe opinionëve të mësuesit të tyre, pa përjashtuar as opinionet e tyre dhe nxënësve të tjerë, e që të gjitha kanë e përbëjnë një mozaik opinionesh e mendimesh.

## KOMUNIKIMI DHE DEBATI I PËRBASHKËT

Se kjo shkollë dallon nga shkollat e tjera, nuk ka dyshim. Në shkollën malikite, dallimi ndërmjet Malikut dhe nxënësve të tij ishte bukur i madh dhe kjo ndoshta edhe ndikoi që brenda asaj shkolle të shihet si figurë e pakontestueshme dhe nuk ishte e lehtë që imamin e vendit të hixhretit-Medinës ta kundërshtonin edhe në mendime e opinione. Edhe te shafitë dhe te hanbelitë nuk kishte ndonjë dallim të madh, ku i pari ishte figurë e shquar në jurisprudencën islame dhe bazat e saj, gjersa i dyti ishte më tepër i njohur në hadithet e të Dërguarit të Allahut. Te këto shkollat e tjera, mësimi dhe ambientet e dijes ishin klasik, ku mësuesi flet e nxënësit dëgjojnë e mësonin. Nuk themi se nuk kishte debate e konsultime, ato ekzistonin, por jo në masë të madhe, ngase dallimi mes tyre dhe nxënësve të tyre ishte bukur i theksuar dhe kjo ndikonte në pozicionimin e fuqishëm të mendimeve dhe opinionëve të tyre. Për dallim prej tyre, nxënësit si Ebu Jusufi, Muhamedi, Zufëri, thuajse ishin gati të njëjtës kategori me themeluesit e shkollave të tjera, prandaj edhe kishte një tjetër diskurs që frymonte në shkollën hanefite, shtojta kësaj edhe faktin se Ebu Hanife kishte një qasje krejtësisht tjetër. Mësimet e tij ishin një ndërveprim mes tij dhe atyre që ndiqnin mësimet e tij. Metoda e tij përfshinte të gjithë, pa dallim, ndonëse krejtësisht e natyrshme që disa shquheshin nga të tjerët. Ai shtronte çështjen, hapte diskutimin mes tij dhe nxënësve të tij, me pas zhvilloheshin konsulta që ishin të mëdha, madje edhe me ditë, dhe kjo qasje e komunikimit të përbashkët, pa cenuar dhe penguar mendimin e tjetrit, ishte një lloj interaktivi që ua lejonte të gjithëve kontributin personal dhe pjesëmarrjen e barabartë në debatin rreth çështjes në fjalë.

Kjo padyshim që ishte një risi e kohës, ku rëndësi të posaçme i jepej konsultimit dhe komunikimit të brendshëm, ku secilit i jepet kohë e hapësirë për të thënë mendimin e tij dhe pastaj për ta argumentuar e mbrojtur atë. Thjesht mësuesi

apo lideri bën hapjen e një trajtесе të caktuar, ku nxënësit i drejton drejt një kërkimi të pavarur, por që në fund ai e ka fjalën kryesore. Kjo qasje krijonte komunikim me njëri-tjetrin, afërsi mes tyre, shpërfaqte pikëpamje të ndryshme, zhvillonte aftësitë e të menduarit dhe mbi të gjitha sillte një dekret përfundimtar të shoshitur nga të gjitha këndet e mundshme dhe të mirë argumentuar.

Në lidhje me këtë çështje autori i mirënjohur, el-Mekij, shprehet: “Ebu Hanife, doktrinën e tij e bëri konsultim ndërmjet të gjithë të pranishmëve, ku nuk e shihte përpjekjen (ixhtihadin) e tij pa prezencën edhe të përpjekjes të tyre (nxënësve)... ai i parashtronte çështjet (meseletë) para tyre, secilën veç e veç, më pas dëgjonte mendimet e tyre, por edhe ai e thoshte mendimin e tij. Ai debatonte me ta rreth atyre meseleve, nganjëherë edhe me muaj, derisa të bëhej e qartë njëri prej atyre mendimeve që ishte më i arsyeshmi, vetëm atëherë Ebu Jusufi i regjistronte të gjitha.”<sup>1</sup> Kjo formë apo metodologji, padyshim që ishte më e drejtë, më reale dhe më e afërt me të vërtetën. Në anën tjetër, një metodë e tillë qetësonte zemrat dhe në fund secili bindej se është përzgjedhur mendimi më i mirë i mundshëm, pasi që meseleja është analizuar deri në detajet më të vogla dhe realisht është përzgjedhur mendimi më i mirë i mundshëm, pasi që çështja është analizuar nga një grup ekspertësh që i takonin grupit të muxhtehidëve në fushat e tyre përkatëse.

Për këtë konsultim e debat që zhvillohej te kjo plejadë, më së miri tregon Esed ibën Furati, i cili thotë: “Më ka thënë Esed ibën Amri: “Ata (nxënësit e Ebu Hanifes) nuk pajtoheshin me të në përgjigjen rreth ndonjë çështjeje, ku secili vinte me ndonjë përgjigje, e pastaj ato përfundonin tek imami dhe e pyesnin atë, e përgjigja nuk mungonte prej tij. Shpeshherë rreth një çështje diskutonin tre ditë, e më pas e shënonin në divan.”<sup>2</sup>

Ebu Hanife nuk i detyronte nxënësit e tij ta pranojnë vetëm mendimin e tij, përkundrazi ai i nxiste ata që të japin mendimet e tyre personale dhe ta kuptojnë çështjen. I nxiste

El-Mekij, shprehet:  
“Ebu Hanife,  
doktrinën e tij e bëri  
konsultim ndërmjet  
të gjithë të  
pranishmëve, ku  
nuk e shihte  
përpjekjen  
(ixhtihadin) e tij pa  
prezencën edhe të  
përpjekjes të tyre  
(nxënësve)... ai i  
parashtronte çështjet  
(meseletë) para tyre,  
secilën veç e veç, më  
pas dëgjonte  
mendimet e tyre,  
por edhe ai e thoshte  
mendimin e tij.

ata që të mendojnë, hulumtojnë dhe ta japin mendimin e tyre se si e shohin çështjen në fjalë. Vetëm në fund, pas një diskutimi të gjatë, vinte përgjigja vendimtare. Madje, Ebu Jusufi në disa raste e kishte përshkruar klimën e konsultimit, debatit dhe mendimit ndryshe, saqë nganjëherë ata polemizonin me javë e ndoshta edhe një muaj vetëm për një çështje të caktuar. Nuk nguteshin sa për ta përfunduar një çështje dhe për t'i dhënë epilog të caktuar, por mbi të gjitha e analizonin nga të gjitha këndet.

### PLURALIZËM MENDIMESH

Kjo qasje e Ebu Hanifes ndryshonte prej dijetarëve të tjerë, si në Kufe ashtu edhe jashtë saj. Kishte shumë të ditur, por që mësimet e tyre nuk patën shumë jehonë, për shkak se ata nuk lanë nxënës të zellshëm që i bartin dhe transmetojnë opinionet e tyre. Lejth ibën Sâdi ishte i rangut të Malikut, por nxënësit e tij nuk e morën seriozisht fikhun e tij për ta bartur te të tjerët. Madje Shafiu e llogarit Lejthin më të ditur në fikh se sa vetë Malikun, ai thotë: “Lejthi ishte më fekih se Maliku, mirëpo nxënësit e tij nuk e bartën fikhun e tij.”

I tillë ishte edhe Taberiu që kishte shkollë në fikh, por që mësimet e tij në fikh nuk patën jehonë dhe nuk u bartën te të tjerët.

Ebu Hanife ishte shumë i afërt me nxënësit e tij. Nuk luante rolin e një dijetari që mburrej me dijen e tij e as që i nënçmonte kur ata bënin gabime. Thuajse nuk kishte lënë barrierë mes tij dhe tyre. Ata e ndienin veten të lirë të debatonin, madje edhe ta kundërshtonin imamin e tyre. Librat e kësaj shkolle janë të mbushura me mendime e opinione ku jo rrallëherë ata (njëri apo më shumë) nuk pajtohen me opinionet e mësuesit të tyre. Ato opinione, edhe të kundërta mes vete, ishin edhe në të gjallë të mësuesit të tyre. Ato mbetën të regjistruara, sepse imami i tyre e donte këtë. Donte që tërë mendimet të regjistroheshin, por mbi të gjitha mendimi më i argumentuar dhe më i pranuar nga të gjithë, të shënohej në fund si mendim zyrtar. Ajo që ngadhënjente ishte argumenti, e jo kush e thoshte atë. Kishte një pluralizëm në të menduar dhe mendimi ndryshe ekzistonte në atë rreth të famshëm që kishte qindra nxënës, ku në mesin e tyre ishin 40 muxhtehidë,<sup>3</sup> e prej tyre Ebu

Jusufi, Muhamedi e Zuferi, ku këta të fundit ishin në një rang më të lartë të dijës e njohjes.


Imam Ebu Hanife i jepte rëndësi të madhe debatit dhe mendimit ndryshe, saqë raportohet se kur nuk prezantonte Afijeh-nxënës i tij, dhe shqyrtoheshin meseletë e caktuara, Ebu Hanife vetëm shqyronte meseletë me nxënësit e tjerë, por nuk pranonte t'i shënonte ato si mesele të përfunduara, para se Afijeh ibën Jezidi ta jepte edhe mendimin e tij personal.<sup>4</sup> Kjo tregon më së miri për klimën e studimit dhe debatit që kishte kjo shkollë juridike, ndonëse Ebu Hanife ishte një rang më lartë se Afijeh apo Ebu Jusufi, megjithatë ai gjithnjë priste opinionet e tyre. Në këtë pikë, Ebu Hanife me zgjuarsinë e tij kishte vërejtur nuancat e nxënësve, ku disa kishin aftësi të jashtëzakonshme në çështjet e fikhut, e disa të tjerë në ato të hadithit, përderisa dikush kishte talent të madh në të kuptuarit e thellë të gjuhës, andaj kur analizohej e debatohej rreth një çështje të caktuar, ai pyeste secilin nga fusha e tij për të ardhur deri te një version përfundimtar që ishte i pranuar për të gjithë. E nganjëherë kur çështja kishte të bënte me aspektin gjuhësor, zgjidhte ata që dalloheshin në gjuhë, e nuk i rëndonte të tjerët!

I tillë ishte debati, dhe në këtë formë bëheshin analizat në mes dijetarëve të shkollës hanefite. Nuk dilnin fetva e opinione të pa kontrolluara e të pa analizuara. Madje nuk kishte verdikte qesharake çfarë shohim ne në kohën aktuale, me gjithë përparimin dhe avancimin e teknologjisë. Thënë shkurt ishte një shkollë në vete që nuk kishte të ngjashme me të, që kishte krijuar një ambient të fuqishëm ku prezantuesit shfaqnin dijen e përkushtimin, jo famën e arrogancën.

### DOBITË DHE PËRFITIMET NGA KONSULTIMI DHE KOMUNIKIMI

Ky konsultim e komunikim i hapur përveç që e begatonte ambientin dhe harmoninë e pjesëmarrësve, zbulonte edhe dijen, largpamësinë dhe të kuptuarit e shpejtë të tyre. Përveç kësaj, pjesëmarrësit dalloheshin edhe në njohuritë që i posedonin dhe dallimin mes tyre në njohuritë për shkencat e ndryshme. Kishte prej tyre që kishin shumë prirje në fikh, përderisa disa të tjerë shquheshin më tepër në hadith. Dikush kishte aftësi të jashtëzakonshme në analogji dhe krahasim. Dikush i analizonte tekstet profetike edhe nga aspekti i gjuhës, ngase zotëronte njohuri të mëdha në gjuhë.

Tërë këto elemente kur bëhen bashkë janë një tregues i qartë se vendimet që merreshin, nuk ishin aty për aty, por ishin konsulta e debate të mëdha, ku çështjet analizoheshin tejmasë. Edhe nëse dikush jepte mendim të gabuar, tjetri e përmirësonte. Konsultat, debatet dhe analizat e gjata, krijojnë një klimë të jashtëzakonshme, ngase secili mendim analizohej, sikurse edhe argumentet. Për këtë arsye, në çështje



të ndërlikuara, debatet dhe konsultimet zgjatnin me javë, derisa shtereshin të gjitha argumentet, dhe vetëm atëherë konfirmohej mendimi i përzgjedhur, duke përmendur të gjitha argumentet, pa lënë anash as mendimet e tjera.

Komunikimi dhe konsultimi i përbashkët është më i qëlluar se sa mendimi i një individi që mbyllet në mendime dhe nuk respekton mendimin tjetër. Madje, konsultimi është urdhër i Allahut dhe traditë e të Dërguarit të Allahut. Në Kuran shumë qartë precizohet: "... dhe konsultohu me ta për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai." (Ali Imran, 159). Përveç kësaj, Kurani përderisa përmend cilësitë e mira të besimtarëve, citon edhe konsultimin e përbashkët: "...ata që i përgjigjen thirrjes së Zotit të tyre dhe e falin namazin rregullisht dhe ata që konsultohen mes vete për punë të përbashkëta, e nga ajo që Ne ua japim ata e shpërndajnë." (Shura, 38).

I Dërguari i Allahut ishte shembull në konsultim e komunikim me shokët dhe familjen e tij, aq sa kur e përshkruan Ebu Hurejre, thotë se: "Nuk kam parë dikë që të konsultohet me shokët e tij më shumë se i Dërguari i Zotit."<sup>5</sup>

Ai përgjatë jetës dhe misionit të tij, në çështjet për të cilat nuk kishte zbritur shpallja, ai mbledhte shokët e tij dhe komunikonin mes vete e konsultoheshin gjerë e gjerë, në mënyrë që të arrijnë deri te një mendim më i mirë dhe më i favorshëm.

Në çështjet e tilla, ai nuk insistonte që të merrej për bazë vetëm mendimi i tij, e të refuzohej mendimi i shumicës. Në betejën e Uhudit, ai konsultoi shokët e tij se a të qëndronin në Medinë dhe t'i prisnin armiqtë aty, apo të dilnin jashtë Medinës? Shumica i sugjeruan që të dilnin jashtë Medinës, e të mos qëndronin brenda qytetit. Ai mori mendimin e shumicës, - edhe pse vetë mendonte se të qëndruarit brenda qytetit është më mirë, - dhe dolën jashtë qytetit, derisa mbërritën në Uhud. Aty u pozicionuan dhe aty ndodhi beteja e njohur. Me fjalë të tjera, i Dërguari i Allahut përzgjodhi mendimin e shumicës, ndonëse personalisht kishte mendim ndryshe.

Këtë metodologji e ndoqi gjatë gjithë jetës së tij. Ai edhe para betejës së Uhudit, u konsultua me disa prej shokëve të tij të përzgjedhur se çfarë të vepronte me të zënit rob nga armiqtë e tij. Ai u konsultua edhe në betejat tjera dhe edhe në shumë çështje tjera ku nuk kishte shpallje. Kjo tregon më së miri se ai nuk ishte autokrat, por analizonte situatën, merrte mendime të ndryshme dhe vepronte në bazë të atyre që vlerësoheshin si më të sakta.

Ajo që vlen të përmendet është fakti se në konsultimet dhe komunikimet e debatet e të Dërguarit të Allahut me shokët e tij, i Dërguari i Allahut përdorte strategji të ndryshme, ku nganjëherë i konsultonte të gjithë, siç ishte rasti në Uhud, por theksi ishte më tepër te medinasit, ngase ishin vendas dhe e dinin më tepër dhe më mirë për vendin e tyre. Herëve të tjera, ai i konsultonte vetëm disa prej tyre që ishin më të shquar, më besnikë dhe më të njohur, siç vepronte me të zënit rob në betejën e Bedrit, ku ai konsultoi Ebu Bekrin dhe Omerin, ngase këta dy ishin nga Meka dhe të zënit rob ishin po ashtu nga Meka. E, në rastin e shpifjes ndaj Aishes, ai konsultoi Aliun dhe Usame ibën Zejdin, ngase çështja ishte tepër personale dhe familjare, ndaj edhe konsultimi ishte bërë me ata që i konsideronte si pjesë të familjes së tij, ngase Aliu ishte djali i xhaxhait të tij, ndërsa Usameja ishte i biri i Zejdit, i cili ishte rritur në familjen e të Dërguarit të Allahut!

Konsultat, debatet dhe analizat që bëhen me të tjerët, janë dëshmi se vendimet që dalin prej tyre janë më të favorshme, më të drejta dhe kanë për qëllim që t'i largojnë dyshimet e paragjykimet, që shpeshherë na trazojnë në jetën e përditshme. Prandaj, konsultimi dhe debatet, sado që mendohet se humbet kohë, janë në të mirë dhe prodhojnë rezultate konkrete.

Konsultimi dhe analizat e përbashkëta inkurajojnë individët që ta ndiejnë vetën se janë të rëndësishëm, se i përkasin atij grupi dhe në vete bartin një ndjenjë përgjegjësie ndaj çështjeve që preokupohet shoqëria.

Përveç kësaj, një klimë e tillë debatuese e konsultuese përfron mendimet dhe qasjet e tyre të ndryshme, kombinon përpjekjet e secilit, ndan përgjegjësitë dhe shfrytëzon energjinë e duhur për të arritur deri te një epilog i synuar. Shtu kësaj edhe harmoninë në grup, bashkimin e zemrave, respektin maksimal të ndërsjellë dhe krijimin e një uniteti të pandarë.

## PËRFUNDIM

Të pafuqishme ishin fjalët tona për ta përshkruar debatin dhe konsultat e shumë viteve që bëheshin ndërmjet dijetarëve të shkollës hanefite, në mënyrë që të elaboroheshin tërë ato mesele dhe t'i jepej epilog secilës prej tyre, e që ne sot t'i kemi të gatshme. Gumëzhinte xhamia dhe zërat ishin të lartë, por në fund kur vinte epilogu të gjithë pajtoheshin dhe një heshtje i kaplonte të gjithë. E tillë ishte shkolla juridike hanefite që meseletë i shtjellonte deri në detajet më të vogla, duke mos u lënë vend e hapësirë kritikave të të tjerëve. Edhe pse në dekadat e fundit është sulmuar tejmase, por kritikën dhe sulmet e tyre ishin (dhe janë) plotësisht të kota, qëllimkëqija dhe nuk mund ta dëmtojnë madhështinë e kësaj shkolle dhe nuk mund as ta pluhurosin atë plejadë dijetarësh që zbrërthyen meseletë dhe shpjeguan në formë brilante.

Funksionimi i të gjithëve për një, krijoi një ambient të përshtatshëm, ku secili jepte mundin e tij maksimal të shprehur brenda një opinioni, që më pas pasonte një diskutim mes pjesëmarrësve dhe analizë e thuktë që krijonte një opinion zyrtar, të fuqishëm e argumentues.

Vetëm kështu të bashkuar e të koordinuar mes vete, duke pranuar mendimin e njëri-tjetrit, dhe duke bashkëpunuar mes vete, mbetën shembull për çdo lëvdatë dhe arritën atë që pakkush e arriti pas tyre.

1 Muhamed Zahid el-Kevtherij, *Husnu-t tekadi fi sireti-l imam Ebu Jusuf el-kadi*, (el-Mektebeh el-Ezherijeh lit-turath, Kairo), f.13.

2 Muhamed Zahid Kevtherij, *Fikhu Ehlul Iraki ve Hadithuhum*, (el-Mektebetu Ezherijetu lit-turath, Kairo), f.55.

3 Mustafa Sibai, *Es-sunetu ve mekanehuha fit-teshriil Islamij*, (darul verrak, Damask), f.164.

4 Sajmerij, *Ahbar Ebi Hanife ve ashabuhu*, (bot.III-të, 1985, Alemul Kutub, Bejrut), f.149.

5 Tirmidhiu në Sunen, nr. 1714.

# Kush mund të flasë në emër të Islamit?

Dr. Muhamed Stublla

## KUSH MUND TË TRANSMETOJË HADITHE DHE KUSH KA TË DREJTËN TË FLASË NË EMËR TË KËSAJ FEJE HYJNORE?

Allahu xh.sh. ka siguruar se ruajtja dhe vazhdueshmëria e fesë është në garancinë e Tij. Por ruajtja e fesë nuk mund të jetësohet pa ruajtjen e autenticitetit të Kuranit dhe të Hadithit. Prandaj, detyrimisht origjinaliteti i këtyre dy bazave, që burimin e kanë të përbashkët, do të ruhet deri në kataklizëm, pavarësisht se dallojnë për nga forma e transmetimit.

Ata që bartën Kuranin dhe hadithet, janë po ata që e shoqëruan Muhamedin a.s. gjatë shpalljes, tubuan Kuranin në një libër, që u quajt Mus'haf, dhe po të njëjtit e transmetuan hadithin te nxënësit e tyre, tabinët, të cilët edhe nën organizimin zyrtar, në prezencë edhe të disa sahabëve<sup>1</sup>, shkruan hadithin që të garantohet ruajtja e tij.

Shpejtësia e shkrimit zyrtar të haditheve varej nga nevoja që paraqitej për shkrimin e tyre, pikërisht ashtu siç ishte urgjencë tubimi i Kuranit pas luftës së Jemames, në të cilën ranë dëshmorë shumë hafëz të Kuranit, dhe kështu do të garantohej ruajtja e tij.<sup>2</sup>

Në ritëm të ngjashëm shkruhej dhe tubohej edhe hadithi, siç ishte shfaqja e konflikteve, fillimi dhe sinjalet e shpërndarjeve të vetive negative etj., sinjale këto të cilat bënë që dijetarët islam të shkruajnë hadithet.<sup>3</sup>

Kujdesuni nga gënjeshtria, sepse të shpie në shturje, ajo të shpie në amoralitet, i cili të përcjellë në zjarr. Nëse njeriu vazhdon të gënjejë dhe (me vetëdije gënjen dhe nuk tenton të largohet nga gënjeshtria), ai do të regjistrohet tek Allahu gënjeshtar.”

Kështu gradualisht ashpërsoheshin edhe kushtet që duhej të plotësonin transmetuesit që t’iu besohej transmetimi i këtyre teksteve. Ata patjetër duhet të posedonin cilësi të veçanta. Prej kriterëve kyçe që duhej të posedonte një transmetues është:

Sinqeriteti – korrektësia, është prej vetive më fisnike të njeriut. Me të synojmë korrektësinë e njerëzve në raport me të tjerët, e cila manifestohet përmes të folurit dhe veprave të mira, natyrisht duke qenë e pandashme korrektësia në raport me Krijuesin. Allahu xh.sh. tregon që ditën e llogarisë, të sinqertëve do t’ju bëjë dobi sinqeriteti: “Allahu thotë: Kjo është dita në të cilën të sinqertëve u sjell dobi sinqeriteti i tyre...” (El Maide, 119). Përderisa sinqeriteti është komponentë profitabile në ditën e llogarisë, ai patjetër se është komponentë kyçe edhe në llogarinë shkencore për pranimin e transmetimeve.

Pejgamberi Muhamed a.s., në shumë hadithe ndalon, por edhe potencon rreziqet e gënjeshtres, ai ndër të tjera thotë: “... Kujdesuni nga gënjeshtria, sepse ajo të shpie në shturje e ajo në amoralitet, i cili të përcjellë në zjarr. Nëse njeriu vazhdon të gënjejë dhe (me vetëdije gënjen dhe nuk tenton të largohet nga gënjeshtria), ai do të regjistrohet tek Allahu gënjeshtar.” (Buhariu, 6094 dhe Muslimi, 2067).<sup>4</sup>

Ky person, që gënjen, patjetër se edhe në këtë botë do të sanksionohet. Duke pasur parasysh rrezikshmërinë e gënjeshtres dhe ndikimin negativ të saj, i Madhi Zot na ka



porositur që fillimisht t'i vërtetojmë informacionet para se t'i gjykojmë ato. Ai thotë: "O ju që keni besuar! Nëse ndonjë i pandershëm ju sjell ndonjë lajm, sigurohuni për saktësinë e tij, që pa dashje t'i bëni dëm ndokujt, e pastaj të pendoheni për atë që keni bërë." (Huxhurat, 6).

Dijetarët islam, duke ditur që siguria e informacioneve-teksteve fetare është më me prioritet sesa informacionet e ngjarjeve ditore, pasi që ishte çështje besimi, vendosen të verifikojnë tekstet se nga kush transmetohen.<sup>(5)</sup> (Ed Darimij, 438). Ata vendosen rregulla, të bazuara në tekstet kuranore dhe në hadithet profetike, përmes së cilave do të pamundësohej përfshirja e ndonjë informacioni në tekstin e shpalljes dhe anasjelltas.

Atyre të cilëve do t'ju pranoheshin punimet shkencore, në këtë rast transmetimet e haditheve, duhej të posedonin cilësi apo veti njerëzore dhe fetare, përmes së cilave do të garantohej ruajtja e fesë-teksteve fetare. Gjithashtu, përmes cilësive të këtyre transmetuesve e kuptojmë se ku rangohen ata të cilët kritikojnë apo refuzojnë transmetimet e caktuara të haditheve. Kështu do të kemi një vlerësim të seriozitetit të kritikës së tyre. Prandaj, kushti i parë që duhet të posedoj një transmetues, që të pranohet transmetimi i tij është:

1. Drejtësia - konsekuenca fetare, që transmetuesi të jetë i drejtë duhet të plotësojë disa kriteret:

a. Të jetë mysliman, ky parim është i pa kontestuar, sa që për mos pranimin e mendimeve apo transmetimeve të jomuslimanëve është konfirmuar konsensusi i dijetarëve, profesionalistëve të fushës.<sup>6</sup> Kështu që, nuk duhet të vlerësohen, e assesi të pranohen si të mirëqena qëndrimet, opinionet e jomuslimanëve. Opinionet e tyre janë të pasakta, në rastin më të mirë të dyshimta dhe aspak të nevojshme.

b. Të jetë moshërritur,<sup>7</sup> fëmijët mund të jenë nxënës të zellshëm, por plasimi i mësimave të nxëna në këtë moshë, trajtohen me rezerva dhe kërkojnë verifikim shtesë në burime e tjera.

c. Të jetë i mençur,<sup>8</sup> ai që nuk ka atësi të të vepruarit, nuk di çfarë thotë, fjalët dhe veprat e tij nuk rezultojnë nga vetëdija e baraspeshuar, prandaj atë që ai e thotë nuk hynë në fushën e mundësisë së trajtimit apo vlerësimit.

d. Të jetë larg elementeve të shthurjes apo degjenerimit. Konkretisht, të mos bëjë mëkate të mëdha dhe gabimet e vogla të mos jenë të vazhdueshme.<sup>9</sup> Ndoshta definimi më përmbledhës i mëkateve të mëdha është: veprat për të cilat është paralajmëruar dënim i veçantë ose ato mëkate që irritimi dhe fatkeqësia e tyre është shumë e madhe edhe nëse nuk është caktuar mëkati i tyre, p.sh. sikurse që është fyerja e Qabesë, hedhja e Kuranit në vend papastërtie etj.<sup>10</sup> Por mund të themi se definimi i mëkateve të mëdha realizohet përmes mos kryerjes së obligimeve, farzeve apo veprimi i të ndaluarave, haramëve, si p.sh.: mos falja e namazit, mos

dhënia e zekatit, mos agjërimi i ramazanit, vrasja, mos respekti i prindërve, amoraliteti etj.. Ndërsa gabimet e vogla, janë të gjitha ato që nuk janë të mëdha,<sup>11</sup> e të cilat janë të shumta, nëse bëhen vazhdimisht, ato në përmbledhje trajtohen si të mëdha.

Ata të cilët flasin për Islamin, apo për hadithet, fillimisht duhet të sigurohemi se ata, a janë të besueshëm? Besueshmëria e tyre vlerësohet duke qenë të pastër nga gabimet e mëdha dhe mos të shpeshtojnë gabimet e vogla, pavarësisht se përsëritja e atyre gabimeve është e të njëjtit lloj apo të natyrave të ndryshme.

e. Të jetë i distancuar nga vetitë denigruese që cenojnë dinjitetin.<sup>12</sup> Me këtë kriter synohet që transmetuesi të ketë virtyte dhe parime fetare e njerëzore të ngjashme me shoqërinë apo bashkëkohësit e tij.<sup>13</sup> Nuk pranohet interpretimi i fesë nga ai që sjelljet e tij nuk përkojnë me konditat e fesë. Prej veprimeve që mund të bëjë ndokush e të trajtohet si jo i drejtë mund të përmendim: shoqërimi me njerëz vepërligë, shoqërimi i panevojshëm me gjininë e kundërt, humori i tepërt i cili shfaq mos seriozitet etj.

2. Përpikëria e transmetuesve, e cila është e nevojshme në momentin kur e dëgjon hadithin, pastaj e kupton tekstualisht, por e kupton edhe domethënien e tekstit, veçanërisht nëse transmeton hadithin kuptimisht, dhe këtë e memorizon mirë deri në momentin e tregimit, kurdo që e tregon hadithin, ta tregojë të plotë, ashtu sikurse e ka dëgjuar.<sup>14</sup> Pejgamberi a.s. ka thënë: "Allahu e ndriçoftë atë që ka dëgjuar hadith nga ne, dhe e ka mbajtur në mend derisa e ka treguar (te të tjerët)..." (Ebu Davud et Tajalisij, 618).<sup>15</sup>

Nëse transmetuesi është i përpiktë në memorizimin dhe posedon libër apo libra, atëherë ai, jo vetëm që pranohet, por edhe përzgjidhet transmetimi i tij në rast të kontradiktave të haditheve, sigurisht sipas specifikave, rregullave të njohura nga studiuesit e fushës.



Nëse njëri nga këto kushte nuk gjendet te transmetuesi, atëherë ky transmetues është i pabesueshëm, nuk pranohet, nuk lejohet të punohet me transmetimin apo fjalën e një njeriu të pabesë, që nuk i besohet në atë që thotë.<sup>16</sup>

Nëse dikush dëshiron të japë mendim apo opinion për Islamin, duhet që të jetë i besueshëm dhe të njohë rregullat e fushës për të cilën flet. Thënë ndryshe, nuk lejohet të mbështeteni në mendimet që japin për Islamin ata që nuk janë të besueshëm, pavarësisht se kush janë. Pasi që Allahu xh.sh. dhe Pejgamberi a.s. nuk pranojnë opinionet e askujt për fenë islame, nëse personi në fjalë nuk është pjesë e kësaj feje, nuk pranojnë opinione edhe të atij që nuk pranon ta falë namazin, ta japë zekatin, ta agjërojë ramazanin, as të atyre që nuk respektojnë prindërit, të vrasësve, të pamoralshmëve, me një fjalë, të atyre që veprojnë mëkate të mëdha, madje, prioritet në refuzim, dhe injorim duhet bërë atyre që arsyetohen dhe krenohen me ato mëkate. Por jo vetëm këta janë të pabesuar, të pabesueshëm janë edhe të gjithë ata që janë insistues e të vazhdueshëm në mëkate të vogla, apo mburren me to!

Ata që flasin për fe, apo për hadithe duhet të jenë larg elementeve të shthurjes apo degjenerimit, dhe të jenë të distancuar nga vetitë denigruese që cenojnë dinjitetin e tyre fetar dhe edukatën e mirë që është në përputhje me parimet fetare. Gjithashtu, që të jetë e dëgjueshme fjala e atij që thërret për Islamin, ai patjetër duhet ta njoh fushën për të cilën deklarohet, të kuptojë atë që lexon dhe dëgjon, të kuptojë përbërjen e fjalëve dhe fjalive që thotë në mënyrë që të ketë kompetencë të përcjellë opinione apo atë që ka dëgjuar për Islamin. Por assesi, kjo kompetencë nuk i jep të drejtë të gjykojë për shkencat islame pa u plotësuar edhe shumë kushte të tjera.

Prej 114 mijë sahabëve afërsisht sa mendohej që ishte numri i shoqëruesve të Muhamedit a.s.,<sup>17</sup> vetëm rreth 130 ose më pak se 0.5%, prej tyre kanë dhënë mendime për normat islame. Shtatë janë prej atyre që kanë dhënë më së shpeshti fevfa prej tyre, dhe njëzet të tjerë mesatarisht. Ndërsa, të tjerët kanë dhënë opinione juridike shumë pak, një, dy fetva apo pak më shumë, por mendimet juridike të tyre janë aq të kufizuara sa që nuk i bëjnë ata të njohur.<sup>18</sup> Ndërsa, në kohen tonë, mund të mos gjejmë rreth 0.5% që nuk flasin për fe e hadithe, përkundrazi, ndoshta vetëm 0.5% e qytetarëve nuk pranojnë përgjegjësinë për të folur për fe? Të tjerët, për çdo mundësi që kanë, me shpejtësi e ëndje komentojnë, japin opinione edhe nëse nuk janë kompetentë. Ky guxim sigurisht buron nga injoranca apo mos vlerësimi i duhur i çështjes, të cilës iu kanë qasur pa kurrfarë dije e kompetence. Prandaj të gjithë ata që nuk i plotësojnë këto kushte, ju ndalohej që të marrin përgjegjësi të tilla, dhe po ashtu ndalohej t'u dëgjohen apo të përdoren mendimet e tyre.

Pavarësisht se mund të jenë praktikues të fesë, apo edhe pretendent se i njohin shkencat islame mirëfilli, madje, kjo përfshin veçanërisht ata, që nuk janë të fushës siç janë: gazetarët, opinionistët, politikanët, tregtarët, organizatat e ndryshme etj.. Islami është fe, besim, duhet të dihet nga kush e mësojmë apo dëgjojmë për fenë tonë.

Nëse një hadith nuk lejohet të merret nga një i pabesueshëm, si të mësojmë fenë apo të refuzojmë hadithe përmes të pabesueshmëve?! Ata që flasin për fenë islame, hadithet etj., duhet t'i kalojnë këta filtra të cilët i kanë vendosur ekspertët e hadithit, në të cilët, ata, kanë vendosur transmetuesit. Ai që dëshiron të flasë për këtë shkencë, e përmes saj për Islamin, të paktën duhet të posedojë cilësitë e transmetuesve të pranuar në mënyrë që të dëgjojmë opinionin e tij. Ndërsa pranimi apo mospranimi i opinionit të tyre varet nga filtrimi që bëhet përmes parimeve të shkencave relevante islame.

1 Shkrimi i haditheve daton që nga koha e shpalljes. Udhëheqësi i myslimanëve, Omer bin Abdulazizi, në përmbyllje të shekullit të parë, edhe zyrtarisht kishte urdhëruar për mbledhjen apo shkrimin e haditheve. Shih Imam Enes ibën Maliku, *Muvata – transmetimi i Muhamed bin el Hasen esh Shejbanit* - (Bejrut, El Mektebetu El Ilmijeh) vëll. 1, faq. 330, nr. 936.

2 Muhamed bin Ismail el Buhari, *Sahih el Buhari*, (Liban, Dar Tuk En Nexhah 1422h.) vëll.6, fq. 183, nr. 4986.

3 Muslim, Muslim bin el Haxhaxh el Kushejri, *Sahih Muslim*, (Bejrut, Dar Ihja Et Turath El Arabij) vëll.1, fq.15.

4 Sahihu i Buhariut, vëll.8, fq. 25 dhe Sahihu i Muslimit, vëll.4, fq. 2012.

5 Ed Darimij, Ebu Muhamed, Abdullah bin Abdurrahman bin el Fadl..., *Sunen Ed Darimij*, (Arabia Saudite, Dar El Mugni InNesher ve Et Tvzia, 0002) vëll.1, fq. 398, nr. 438.

6 Muhamed bin Muhamed el Gazali, *El Mustesfa fi Ilm El Usul*, (Bejrut, Dar El Kutum El Ilmije, Bot. 1, 3141h.) fq. 124

7 Ibën Es Salah, Uthamn bin Abdu rrr Rrahman, *Marifetu Enva Elum El Hadith*, (Siri, Dar El Fikr, Bejrut, Dar El Fiker El Muasir 1998) faq. 104.

8 Burimi paraprak.

9 Zejnudin Muhamed el Menevi, *El Jevakit ve Ed Durar fi sherh Nuhbeti Ibn Haxher*, (Rijad, Mektebetu Err Rruzhd, 1999) vëll.2, fq. 351.

10 Ibën Abdu es Selam, Ebu Muhamed Iziddin Abd el Aziz, *Kavaid El Ahkam fi Mesalih El Enam*, (Kajro, El Mektebatu El Kulijatu El Ezherijeh 1991), vëll. 1, faq.24.

11 Referimi paraprak, vëll.1, faq.23.

12 El Fejumi, Ahmed bin Muhamed bin Alij, *El Misbah El Munir fi Garib Esh Sherh El Kebir*, (Bejrut, El Mektebu El Ilmijeh) vëll.2, fq. 569.

13 Errafij, Abdulkerim bin Muhamed bin Abdulkerim, *Esh Sherh El Kebir*, (Liban, Bejrut, Dar El Kutub El Ilmijeh, 1997) vëll. 31, fq. 21.

14 Dr. Nuridin Iter, *Usul El Xherh ve Et Tadil ve Ilm Err Rrixhal* (Kuvajt, Dar El Jemameh dhe El Ferkun libatu ve En Nesher ve Et Tevzia 2001) fq. 58.

15 Ebu Davud, Sulejman bin Davud bin el Xharud, *Musnedi i Ebu Davudit*, (Egjip, Dar El Hixher, 1999) vëll.1, fq. 505.

16 Ibën Kthir, Ebu El Vefae, Ismail bin Omer, *Ihtisar Ulum El Hadith*, (Liban, Bejrut, Dar El Kutub El Ilmijeh) vëll.1 faq. 92.

17 Ibën Sallahu në Mukadimeh, vëll.2, fq. 497. Mugletaj, bi Kulejxh bin Abdillah bin El Bekxherij El Hanefij, *El Isharatu Ila Sira El Mustafa ve Terih men badehu min El Hulefa*, (Dimeshk, Dar El Kalem dhe Bejrut, Dar Esh Shamije 1996) Vëll.1, fq. 346. Këta dietarë e kanë zgjedhur këtë mendim.

18 Ibën Kajmi, Ebu Abdullah, Muhamed bin Ebi Beker bin Ejup, *Ja'lam El Mukiaian an Rab El Alemin*, (Arabia Saudite, Dar Ibën El Xhevzi Linesher ve Et Tevzia, 1423h.) vëll.2, fq.18-20.

# Kafshët e therura prej jomyslimanëve

Mr. Besim Krasniqi

Legjislacioni islam i rregulloi raportet me të gjitha kategoritë e shoqërisë, përfshirë këtu edhe ato me jomyslimanët. Tema rreth dispozitave të ushqimeve të jomyslimanëve është bërë akoma më e rëndësishme dhe aktuale gjatë kohës moderne, ku njerëzit janë afruar me njëritjetrin, pavarësisht besimeve dhe bindjeve të tyre fetare, andaj janë të nevojshëm për njëritjetrin në shumë fusha, sigurisht edhe në atë të ushqimit. Por, kjo temë nuk është temë e re për legjislacionin islam. Rregullat dhe dispozitat për këtë çështje i gjejmë direkt në Kuranin famëlartë dhe në Sunetin e Pejgamberit a.s..

## KLASIFIKIMI I JOMYSLIMANËVE

Në literaturën islame, jomyslimanët klasifikohen në dy grupe: Ithtarët e librit (pasuesit e librave qiellorë që ndryshe njihen si “ehlul kitab”) dhe idhujtarët apo pjesëtarët e besimeve të tjera. Ky klasifikim na shërben edhe në shumë prej çështjeve të tjera, jo vetëm në sferën e ushqimeve.

## KAFSHËT E THERURA PREJ ITHTARËVE TË LIBRIT

Me termin “ithtarët e Librit” kuptojmë atë që Allahu na e ka shpjeguar në Librin e Tij, e ata janë jehudët dhe të krishterët. Janë quajtur me këtë emër për shkak se Allahu ka zbritur tek ata libra, siç është Teurati dhe Inxhili. Në literaturën islame i gjejmë me termin “Ehlul-kitabejn” – “Ithtarët apo pasuesit e dy librave”.

*“Sot u lejuan për ju ushqimet e mira, edhe ushqimet (të therurat) e ithtarëve të librit janë të lejuara (hallall) për ju, edhe ushqimet (të therurat) tuaja janë të lejuara për ta (u janë lejuar)...” (El Maide, 5).*

Për dallim prej politeistëve dhe jomyslimanëve të tjerë, për ta, ka dispozita të veçanta në legjislacionin islam.<sup>1</sup> Andaj, kur përdoret termi “ithtarët e Librit” nënkuptohen hebrenjtë dhe të krishterët.<sup>2</sup> Në Kuran flitet për ushqimin e ithtarëve të Librit dhe në parim ai ushqim lejohej. Allahu i Lartësuar ka thënë:

“Sot u lejuan për ju ushqimet e mira, edhe ushqimet (të therurat) e ithtarëve të librit janë të lejuara (hallall) për ju, edhe ushqimet (të therurat) tuaja janë të lejuara për ta (u janë lejuar)...” (El Maide, 5).

Në komentin e këtij ajeti, Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!), ka thënë: “Ushqimet e tyre janë të therurat e tyre.”<sup>3</sup>

Lejimi i ushqimeve të ithtarëve të Librit është aq i qartë, sa që nuk ka vend për dyshime, kjo vërtetohet edhe me vetë praktikën e Pejgamberit a.s.. Është i njohur rasti i helmimit të tij me mishin e qengjit të përgatitur nga gruaja hebreje.<sup>4</sup> Mirëpo, ky lejimi i të therurave nga ana e ithtarëve të Librit ka edhe disa kushte që duhen përmbajtur, e të cilat janë:

**Të jetë mish i lejuar.** Pra, mishi i therur nga ana e tyre duhet domosdo të jetë i lejuar në Sheriatin tonë, andaj nëse mishi i therur nga ta është mish derri ose ndonjë nga kafshët e ndaluara, kjo nuk e bënë të lejuar për ne vetëm pse është therur nga një ithtar i Librit.

Por, ajo që është diskutuar te dijetarët është se cila është norma e mishit të therur që



ithtarët e Librit e kanë të ndaluar në librat e tyre? Allahu i Lartësuar e përmend në Kuran se ithtarët e Librit kanë pasur të ndaluara disa ushqime, ndryshe nga legjislacioni ynë. Në suren El-Enamë, Allahu i ka përmendur disa nga këto ushqime, ku thotë:

“E (posaçërisht) ndaj atyre që janë jehudi. Ne u kemi ndaluar çdo (kafshë) thundrake: nga lopët dhe delet u kemi ndaluar dhjamin e tyre, pos atij (dhjami) në shpinën dhe në zorrët e tyre dhe pos atij të përzier me ndonjë asht. Këtë (masë-ndalesë) e morëm si ndëshkim ndaj mëkatit të tyre. S’ka dyshim, Ne jemi të vërtetë (në çka ju rrëfejme).” (El Enamë, 146).

Andaj, cila është norma e këtyre ushqimeve nëse theren nga ithtarët e Librit? Imam Maliku (Allahu e mëshiroftë!), e përmend këtë çështje dhe thotë: “Mishrat e ndaluara për ithtarët e Librit nuk janë të preferuara (mekruh) për ne (myslimanët).” Ndërsa, shumica e dijetarëve i konsiderojnë të lejuara, ngase ato nuk janë të ndaluara në Sheriatin tonë (pra, nuk kemi tekst për ndalimin e tyre), dhe kur nuk ka argument për ndalimin e tyre, themi se në bazë gjërat janë të lejuara.”<sup>5</sup>

**Të theret sipas normave shariatike.** Nuk mjafton vetëm kushti që kafsha e therur të jetë e lejuar (hallall), por duhet që ajo kafshë të jetë therur (jo të mbytet përmes metodave bashkëkohore) sipas normave shariatike dhe që t’u përmbahet kushteve të therjes. Nëse nuk janë plotësuar këto kushte, atëherë nuk lejohet ngrënia e atij mishi, pavarësisht se a është therur nga myslimani apo nga ithtari i Librit.<sup>6</sup>

Megjithatë, disa dijetarë anojnë ka lejimi i kafshëve të therura nga ithtarët e Librit, edhe nëse nuk plotësohen kushtet e therjes. Kështu mendon Ibën el-Arabiju, i cili pasohet edhe nga disa dijetarë bashkëkohorë, si Ebu Abdullah

el-Hiffari, Muhamed Abduhu, Rashid Rida, Jusuf Kardavi, etj.<sup>7</sup> Këta dijetarë argumentojnë me atë se Allahu i ka lejuar kafshët e therura nga ithtarët e Librit dhe se nuk e ka përmendur se ato duhet të theren sipas metodave të therjes së myslimanëve, por i ka lejuar ato me çka ushqejnë ata vetën e tyre. Kështu mendon Ebi Bekër ibën el-Arabij el-Malikij, i cili thotë: “Dikush më parashtrroi këtë pyetje: “Nëse një i krishterë e përdredhë qafën e pulës dhe pastaj e gatuan (pra nuk e therë, por e mbyt duke e përdredhur qafën e saj), a lejohet të ushqehet myslimani nga ai ushqim?” Ndërsa, unë iu përgjigja: “Ushqehet nga ai ushqim, ngase ai është ushqimi i atij të krishterit dhe i priftërinjve të tij, edhe pse nuk është therur sipas therjeve tona. Kjo sepse Allahu i ka lejuar ushqimet e tyre në përgjithësi dhe çdo gjë që në fenë e tyre është e lejuar, e tillë është edhe te ne, përveç ato gjëra që Allahu i ndaloi në Librin e Tij.”<sup>8</sup> Por, kjo nuk llogaritet si mendimi më i saktë dhe në të njëjtën kohë nuk përkrahet nga shumica e dijetarëve, ngase kushtet e therjes nuk janë vetëm fjalë të dijetarëve, por janë kërkesa dhe ligje të vendosura nga vetë Allahu dhe i Dërguari i Tij. Shembulli i përdredhjes së kokës së pulës që e përmend Ibën el-Arabiu (Allahu e mëshiroftë!), hyn te kategoritë e ndaluara me ajetin kuranor, si e “furma”, e për këtë kemi ajetin: “Juve u janë ndaluar (t’i hani): ngordhësit, gjaku, mishi i dërrit, ajo që theret jo në emrin e Allahut, e furnja...” (El Maide, 3).

Pra, te ndalesa për kategorinë “e furma”, hyn edhe pula që iu është përdredhur qafa dhe nuk ka aspak rëndësi nëse e ka bërë myslimani apo ithtari i Librit.<sup>9</sup>

Çështja që më së shumti diskutohet në mesin e dijetarëve në kapitullin e ushqimit të ithtarëve të Librit, është çështja e përmendjes së emrit të shenjtorëve të tyre para therjes së kafshëve. Te kushtet e therjes, përmendet se për myslimanin

është kusht që gjatë therjes të përmendet emri i Allahut të Lartësuar. Mirëpo, si ta klasifikojmë si hallall mishin e therur nga ithtarët e Librit, kur ai mish është therur në emër të Jezusit, për ndonjë kishë a shenjtor të tyre, ndërkohë që ndalohet mishin e therur për tjetërkënd përveç për Allahun? Ndërsa, në anën tjetër, si mund t'ia obligojmë ithtarëve të Librit të therin kafshë në emër të Allahut, kur ata kanë tjetër besim dhe kur ushqimet e tyre janë të lejuara me ajetin kuranor?

Dijetarët për këtë çështje janë të ndarë në disa mendime: Një pjesë e madhe e dijetarëve e kanë ndaluar mishin e therur nga të krishterët për shenjtorët e tyre, si Mesihu, e po ashtu edhe mishin e hebrenjve që theret në emrin e Uzejrit, e të ngjashëm me të. Ata janë bazuar tek ajeti: “Dhe mos hani nga ajo që (para therjes së saj) nuk është përmendur emri i Allahut, vërtet ajo (ngrënia) është mëkat...” (El Enamë, 121). Në lidhje me këtë, Ibën Uthejmini ka thënë: “Qëllimi është që gjatë therjes të mos përmendet emër tjetër përveç emrit të Allahut, p.sh. të thotë: “Në emër të Mesihut” ose “Në emër të Muhamedit” e të ngjashme me to. Të gjitha këto i bashkëngjiten kategorisë së ndalesës.<sup>10</sup>

Malikitë, mishin e therur në emër të shenjtorëve të ithtarëve të Librit nuk e konsiderojnë të ndaluar, por nuk e preferojnë atë. Malikitë dhe dijetarët e tjerë që kanë këtë mendim, thonë, se Allahu i ka lejuar të therurat e ithtarëve të Librit dhe Ai e ka ditur se gjatë therjes së tyre do të përmendin shenjtorët e tyre, ngase ata nuk e përmendin Zotin e vërtetë, Allahun.<sup>11</sup>

Andaj, këta dijetarët e konsideruan hallall mishin e therur nga ithtarët e Librit, pavarësisht se emrin e kujt e përmendin nga besimi i tyre, sepse mishin e therur në këtë aspekt trajtohet si mishin e therur nga myslimanët, me të cilin dëshirojnë të afrohen tek Allahu i Lartësuar. Ky është edhe njëri nga dy mendimet e Imam Ahmedit sa i përket kësaj çështjeje.<sup>12</sup>

Në lidhje me këtë, dijetari i madh, Atau,<sup>13</sup> ka thënë: “Ushqehu nga mishin e therur nga i krishteri edhe nëse e dëgjon duke thënë “Në emër të Mesihut”, ngase Allahu i ka lejuar të therurat e tyre, duke e ditur se çka përmendin ata gjatë therjes.” Ngjashëm me të thotë edhe Kasim ibën Muhajmireh, Zuhriu, Shabiu, Mekhuli, dhe kështu transmetohet edhe nga dy sahabët, nga Ebu Derda dhe Ubade ibën Samiti (Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata!).<sup>14</sup>

Ky është mendimi të cilin e favorizon Imam Taberiu, dhe ndoshta të punuarit me këtë mendim do të ishte një lehtësim i madh për myslimanët.

## KAFSHËT E THERURA NGA IDHUJTARËT DHE PJESËTARËT E BESIMEVE TË TJERA

Në këtë grup hyjnë pjesëtarët e çdo besimi tjetër, idhujtarë - politeistët, mexhusitë,<sup>15</sup> sabiinët,<sup>16</sup> murtedët,<sup>17</sup> dhe ata që s'kanë asnjë besim – ateistët.<sup>18</sup>

Kafshët e therura prej të gjithë këtyre grupeve janë të ndaluara – haram në Sheriatin tonë.

Ajo që është diskutuar në këtë tematikë ka të bëjë me mexhusitët, të cilët disa dijetarë i konsiderojnë si ithtarë të Librit, bazuar në hadithin: “*Trajtoni mexhusët sikur i trajtoni ithtarët e Librit.*”<sup>19</sup> Hadithi ka forma të tjera të transmetuara, e që janë sqaruese për këtë tematikë, andaj hadithi vlen vetëm për çështjen e xhizjes, ndërsa sa i përket çështjes së martesave dhe ushqimeve, ata trajtohen plotësisht si politeistë dhe në këtë nuk ka mospajtim ndërmjet dijetarëve (të hershëm), përveç mendimit të Seid ibën Musejebit, i cili mendon se edhe nga ushqimi i therur nga mexhusiu nuk ka të keqe, nëse për këtë e urdhëron myslimani.<sup>20</sup>

1 Abdulaziz ibën Baz, “*Ehlul-kitab ve hukmuhum.*” Lidhja e shkrimit: <https://binbaz.org.sa/fatwas/7598/> (Parë për herë të fundit më 01/05/2021).

2 Dr. Muhamed ssh-Sheaal, “*Luhumu ve dhebailu ve evaani gajral-muslimin.*” Lidhja e shkrimit: <http://drshaal.com/media/news/lahem-2015-01-29.pdf> (Parë për herë të fundit më 01/05/2021).

3 Transmeton Buhariu, 9/787.

4 Imam Alaudin Ebi Bekr ibën Mesud El-Kasanij, *Bedai'u es-sanai*, (Beirut, Dar el-kutub el-ilmijeh, 1997), 230.

5 Dr. Vehb ez-Zuhejli, “*El-fikhu el-islamij ve ediletuhu*”, (Daar el-fikr el-muassar, vëll. IV, 2004), 2671.

6 Muhamed Salih el-Munexhid, “*Shurut el-ekli min dhebihati el-jehud ve en-nasara*” Lidhja e shkrimit: <https://islamqa.info/ar/answers/88206/> (Parë për herë të fundit më 02/05/2021).

7 Shiko: Usamah ibën Muhamed Dhaferullah. “*Hukm el-luhum el-muslevrideh*” Lidhja e studimit: <https://iri.aiou.edu.pk/indexing/wp-content/uploads/2016/06/hukm-ul-luhum-almustawrida.pdf> (Parë për herë të fundit më 15/05/2021).

8 Dr. Muhamed Sulejman el-Eshkar, “*Edh-Dhebaiah ve turuk esh-sheh'ijeh fi inxhaaz edh-dhekaah*”, Revista: Mexhmu'ul fikh el-islamij ed-duvelij, Nr.10, pjesa I, fq. 358.

9 Dr. Ejmen Feuzij Rahim El-Kubejsij, “*Ahkam el-et'imeh ve el-eshrabeh el-muslevrieh min ed-duvel gajra elislamijeh*”, (Oman, Daar Me'mun, 2016), 1.

10 Muhamed Salih el-Munexhid, “*Shurut el-ekli mea el-jehud ve en-nasara*” Lidhja e shkrimit: <https://islamqa.info/ar/answers/88206/> (Parë për herë të fundit më 20/05/2021).

11 Dr. Vehb ez-Zuhejlij, “*El-fikhu el-islamij ve ediletuhu*”, fq. 2762.

12 Muhamed Sale el-Munrxhid, “*Shurut el-ekli mea el-jehud ve en-nasara.*” Lidhja e shkrimit: <https://islamqa.info/ar/answers/88206/> (Parë për herë të fundit më 02/05/2021).

13 Ata ibën Ebi Rebah, fekih dhe dijetar i shquar i hadithit. Llogaritet nga fekihët më të mëdhenj të tabiinëve. Ka mësuar nga Aisheja, Umu Selemeh, Abasi etj. Ka vdekur në Meke në vitin 114 hixhrij.

14 Ahmed ibën Ebi Bekr El-Kurtubij, “*El-xhami' el-ehkam el-Kuran*”. fq. 316.

15 Adhruesit e zjarrit.

16 Religjion në mes të adhruesve të zjarrit dhe krishterimit, që beson në influencën e yjeve.

17 Personat që kanë qenë myslimanë, mirëpo kanë mohuar diçka prej parimeve islame dhe janë larguar nga Islami.

18 Personat që mohojnë ekzistimin e çdo gjëje hyjnore, nuk kanë fe, rrjedh nga gjuha latine: a- parashtesë mohuese, theos-Zot.

19 Hadithi gjendet në “Muveta” të Imam Malikut (1/278/42), e transmeton po ashtu Bejhakui (9/189), Ibën Ebi Shejbe në “Musannef” (2/227/2). Hadithi ka disa vërejtje në vargun e zinxhirit transmetues, sipas Shejh Nasirudin Albanit hadithi është daif (i dobët).

20 Ibën Abdul-Berr “*El-Isidhkaru li-medhahib ulema fil-emsar fima tadminuhu el-muveta' min meani er-Raj'i velether*”. Lidhja e faqes: <http://www.al-eman.com/> (Parë për herë të fundit më 05/05/2021).

(Përshkrim i mbresave nga rrugëtimin drejt vendeve të shenjta, Meke dhe Medinë)

# “Ju luta Zotit për mëshirë në vendin ku u lutën profetët”

Shpresa Hetemi

Dita e re filloi me vizitën e varrit të Pejgamberit, alejhi selam. Vendi quhej Kopshti i Luleve të Xhenetit-Reudah. Ishte mes shtëpisë dhe xhamisë-minberit të Pejgamberit, alejhi selam.

Në jetën e njeriut, ambiciet e dëshirat zënë vend të rëndësishëm, për mos të thënë kryesoret. E, në kuadër të dëshirave të mia të kamotshme që dhe rrugëtimi shpirtëror do ta quaja, rrugëtimi për në qendrën e botës. Njohuritë historike për vendet në të cilat shkelën këmbët profetike qenë njohuri të lexuara, por jo dhe të prekura, apo shikuara nga afër, e aq më pak të shkelura. Ishte dhjetori i vitit 2022, çasti që hapi shtigjet e reja të vizitave të mia në vendet e shenjta. Nën organizimin e BIK-ut dhe nën udhëheqjen e hoxhë Fitim Gashit, morëm rrugën për të kryer umren, ritual ky që përkon me vizitat e vendeve të shenjta. Vizita që madhështore, ngase pjesë e grupit të rrugëtimit tonë ishin gjithsej 44 persona të moshave e profesioneve të ndryshme. Që vullnet i Zotit që unë të isha

pjesë e këtij karvani në moshën 66 vjeçare, e me ndihmë e Zotit, duke shijuar rrugëtimin me shëndet e fuqi të një vajze të re. Me anëtarët e grupit u njoftuam në aeroportin “Adem Jashari” në Prishtinë. Që në njoftimet e para filluan mirëkuptimet, emocionet, e humanizmi mes nesh, dhe këto emocione e kjo dashuri vëllazërore na përcolli deri në kthimin nga rrugëtimi ynë.

Arritja në aeroportin e Stambollit ishte rreth drekës. Prandaj, për të mos u shndërruar dita në një ditë monotone, gjerë në mbrëmje, hoxha organizoi vizita në qytetin e bukur të Stambollit, në qytetin e gërshetimeve të kulturave të ndryshme, në qytetin e dy kontinenteve, në qytetin e historive të lashta. Në vazhden e vizitave të qytetit të Stambollit, vizituam Xhaminë e Kaltër, Aja-Sofinë (aty dhe u bë





falja e namazit të drekës dhe ikindisë), etj. Të magjepsur me historinë e këtyre xhamive dhe qytetin e Stambollit në përgjithësi, që na i sqaronte cicëroni, në mbrëmje, të relaksuar u nisëm për në aeroportin e Stambollit, që pastaj të nisemi për në Medinë. Në fytyrat e anëtarëve të grupit shquhej buzëqeshja dhe dëshira që sa më parë të arrijmë në Medinë, në qytetin e Profetit tonë. Për ne fillestarët kjo qe një dëshirë e flaktë që mezi pritnim ta realizonim.

Të lodhur paksa nga rrugëtimi, por sa arritëm në hotelin e Medinës, u freskuam nga pritja e ëmbël e stafit të hotelit, duke na uruar mirëseardhje me hurma dhe me nga një trëndafil të kuq. Akomodimi në hotel ishte në mënyrën më të përsosur.

Dita e re filloi me vizitën e varrit të Pejgamberit a.s.. Vendi quhej Kopshti i Luleve të Xhenetit-Reudah. Ishte mes shtëpisë dhe xhamisë-minberit të Pejgamberit a.s.. Emocionet nuk mungonin. Emocione të pa përshkruara. Isha e pasionuar dhe e mahnitur që nga pamja e jashtme, e mahnitur nga adhurimi i mrekullueshëm që i bëhej Zotit nga besimtarët nga anekënd botës. Lutjet dhe dëshirat, falënderimet për Zotin tonë, falënderime dhe për Pejgamberin a.s., që la mesazhe të bukura, që na e mësoi rrugën e Islamit dhe që na e la Kuranin famëlartë.

Qëndrimi ynë aty ishte shumë i shkurt, por tejet mbresëlënës. Aty kuptova se si duhet sjellë myslimani gjatë jetës. Mësova se si të meritojë të gëzojë këtë botë dhe botën tjetër, me të dashurit.

Pasdite, kënaqësinë e vizitës të varrit të Pejgamberit a.s., e kishin meshkujt. Rreshtat e vizitorëve nga mbarë vendet myslimane, nuk mund të përshkruhen me fjalë. Qenë rreshta të gjatë, por pritja bëhej në qetësi e me durim të mirë. E unë,

me djalin tim, isha në Kopshtin e Luleve. Dhe për disa ditë rresht, aty u falëm e u lutëm. Në kuadër të këtij udhëtimi madhështor, në Medinën e Ndrirshme vizituam vende me rëndësi historike islame si; Kodrën e Uhudit, Xhaminë Kibletejni, Xhaminë Kuba etj.. Ditën e diel u nisëm për në Mekë, në qendrën e tokës. Me autobus komod gjatë rrugës do t'i vizitonim vendet të cilat

Muhamedi a.s. gjatë përhapjes së Islamit i kishte frekuentuar kush e di se sa herë. Meshkujt ishin veshur me ihrame, e femrat veshje normale. Dhe para hyrjes në Mekë, në xhami, bëmë nijetin për umre. Gjatë rrugës, hoxha Fitim, na i shpjegonte historinë islame, rrugëtimin e Pejgamberit a.s., këndonte telbijen, ndërsa ne e përcjellshim së bashku, na këshillonte si të lutemi e sillemi, se si ta bëjmë umren.

Rruga kaloi shumë shpejt dhe të gjithë të buzëqeshur e të lumtur e përfunduam rrugën. Edhe këtu në hotel na pritën me hurme dhe ujë zemzem. Pastaj u nisëm drejt Qabesë. Aty ku ishte guri i Qabesë, ajo shputa e H. Ibrahimit, burimi i ujit zemzem, aty ku gjendet qendra e botës, aty në mesin e mijëra të pranishmëve isha unë, djali im dhe grupi. Në një çast e pyesja veten: O Zot, si e paskam arrit mëshirën Tënde, që ma mundësove të lutem në vendet ku u lutën profetët, të falem aty ku tokën e preku balli i Profetit Muhamed, të kërkojë mëshirë në vendin ku kërkuan dhe profetët, të qëndrojnë me këmbë në këtë plato, në të cilën eci "Drita e Tokës", të prekë gurin e Qabesë, dëgjoj zëra që luten me përgjërime, që qajnë, thërrasin: Allahu Ekber (Zoti është Një), të eci rrugën ku Haxherja kërkonte ujë për të birin?! Ti je o Zot, Ai që e shpërbleve atë me ujë, e sot miliona njerëz pinë këtë ujë të bekuar. (Kjo është mrekullia)" - thosha me vete e mahnitur.

Ditëve të tjera u mbushem me emocione gëzimi akoma më shumë, sepse u njoftuam me vendet si: Arafatin-Kodrën e Mëshirës, Muzdelifen, Minen, Kodrën Thevr, Kodrën Nur etj. Për të gjitha këto vizita, unë u jam mirënjohës përjetësisht Bashkësisë Islame të Kosovës për organizimin e tyre të këtij rrugëtimi tonë.

E lus Zotin që adhurimet e lutjet tona të na i ketë pranuar! Amin!



# Fara e lirit – lubrifikanti më i mirë për organizmin e njeriut

Mr. Njomza Sadriu

Duke marrë parasysh që lipidet, proteinat dhe elementet biogjene paraqesin pjesën më të madhe të materieve organike në qeniet e gjalla dhe marrë parasysh rolin e tyre në funksionimin e organizmave të gjallë, ekziston një interesim i madh për hulumtimin e këtyre komponimeve, si në botën bimore, ashtu edhe në atë shtazore.

Deri më tani janë kryer disa studime rreth përbërjes kimike të lirit, respektivisht të përcaktimit të sasisë dhe identifikimit të llojeve të lipideve në këtë farë. Në këtë hulumtim do të fokusohemi në përcaktimin sasior të proteinave, lipideve dhe mineraleve në farën e lirit.

## FARAT E LINIT (LIRIT)

Liri njihet si lubrifikanti më i mirë për organizmin e njeriut. Popullsia e Abisinisë ka qenë e para që ka përdorur këtë farë si ushqim. Ajo është një bimë vjetore me lule bojëqielli.

## PËRMBAJTJA USHQYESE

Farat e saj janë të pasura me acid - grasi esenzial (AGE) omega-3 dhe omega-6. Fara e lirit përmban 55% të saj acido-omega-3, e që e bënë atë burimin kryesor natyral të omega-3 në botë.

50gr. liri në kuptim të efektit janë sikur 20gr. fibra, ndërsa 50gr. kumbulla të thata përmbajnë 7.5gr. fibra, dhe 50gr. fasule të zeza përmbajnë 7.2gr. fibra dhe orizi integral 4.8gr.. Ndërsa nevoja ditore jona është 30gr. fibra. Gjithashtu ai përmban në sasi të ekuilibruar edhe omega-6, që në ushqimin e përditshëm e kalon nevojën tonë ditore edhe 20 herë duke krijuar një disekuilibër midis tyre.

Këto vajra (AGE) nuk mund të sintetizohen nga organizmi ynë, por duhet të merren nëpërmjet ushqimit. Ato janë përbërësit kryesor të membranës qelizore dhe kur mungon



AGE, qeliza ndërton membranën e saj me vajra të tjerë të cilësisë më të ulët që e bënë atë më delikate.

Liri përmban dy herë më shumë omega-3 se çdo lloj peshku që njihet si burimi kryesor i tyre.

Omega-3 hiqet në të gjitha ushqimet e paketuara nëpër fabrika sepse ul shumë datën e skadimit gjë që nuk i intereson prodhuesve.

### AFTËSITË KURUESE

Pejgamberi a.s. ka thënë: “Për çdo sëmundje ka ilaç.” Po ashtu, ai a.s. ka thënë. “Stomaku është ena qendrore e trupit, dhe venat janë të lidhura me të. Kur stomaku është i shëndetshëm, gjendja e tij bartet në vena, dhe nga ana tjetër venat do të qarkullojnë njëjtë, dhe kur stomaku është i prishur, venat do të thithin prishjen nga ai dhe do të vazhdojnë në qarkullim.”

Farat e lirit kanë aftësi ipocolesterolemizzanti dhe afrodisiake, të cilat ndihmojnë në rregullimin e peshës trupore dhe gjithashtu njihen edhe si ushqimi i bukurisë, pasi i jep jetë dhe shkëlqim lëkurës, flokëve, thonjve e syve. Farat e lirit ndihmojnë në uljen, dendësinë e gjakut, si dhe bllokojnë rritjen e qelizave tumorale.

Omega-3 edhe pse është yndyrë, nuk ndikon aspak në rritjen e peshës trupore, përkundrazi hynë në reaksion me yndyrat e tjera, duke i shkriur ato sipas studimit të bërë nga Universiteti i Pensilvanias, prandaj dhe mungesa e tyre bënë që organizmi ynë t'i tretë me vështirësi yndyrat e tepërta të grumbulluara në pjesë të veçanta të trupit.



**Fara e lirit  
ndihmon në uljen,  
dendësinë e gjakut,  
dhe e njejta ka efekt  
në parandalimin e  
rritjes së qelizave  
tumorale.**

Omega-3 ka aftësi antikanceroze, andaj farat e lirit mund të përdoren për kurimin e rreth 26 sëmundjeve të ndryshme.

Njihet si ulëse e kolesterolit dhe sheqerit të lartë, parandaluese e kancerit, paralizimit. Ka efekt pastrues të zorrët dhe është e mirë në rastet e sëmundjeve të stomakut dhe zorrëve, forcon kockat dhe sistemin imunitar, forcon kujtesën dhe sistemin nervor, njëkohësisht ka veti anti depresante. Parandalon sëmundjet romatizmale, rrit përqendrimin, po ashtu vlen dhe në rastet e sëmundjeve të lëkurës dhe mbylljeve të plagëve kur përdoret nga jashtë.

Sipas kërkuesit shkencor amerikan, Donald Rudin, mungesa për një kohë të gjatë e omega-3 shkakton probleme mentali të memories, të dimensionit, të komunikimit ndërmjet tyre dhe si përfundim ngadalësimin e zhvillimit të mendimit.

Ndërsa vajrat e tjerë, sidomos ato të skuqur dhe që janë të pasur vetëm me omega-6, rëndojnë shumë punën e pankreasit dhe tëmthit, duke na bërë të ndiejmë një dhimbje në krahun e djathtë poshtë brinjës së fundit, japin dhimbje në shpatulla dhe bëjnë që të bien thonjtë e këmbëve. Prandaj duhet që këto dy vajra të jenë në ekuilibër e siç ndodh sot me ushqimin modern që ka pothuajse vetëm omega-6.

Vajrat që janë në shitje gjatë përpunimit të tyre përdorin temperatura shumë të larta që formojnë në të acidtranslinolenico që është pothuajse i patretshëm nga organizmi ynë dhe si i tillë krijon probleme dhe sëmundje të shumta.

### PËRDORIMI

Merrni një lugë kafeje me fara lini (liri) dhe hidheni në një gotë ujë të ngrohtë para se të flini dhe kur të zgjoheni në mëngjes pini ujë e gotës, uji tani është kthyer në një masë të dendur të yndyrshme. Pini pa frikë atë të paktën 4 herë në javë. Farat e lirit mund të hidhen edhe në sallatë ose të hahen direkt pa asnjë problem. Duhet të ruhen në frigorifer.

Fara e lirit është mjaft e njohur dhe e përdorur si një bimë shumë e vlefshme për vlerat e saj mjekësore për 10.000 vite. E pasur me acidet omega-3-6-9, proteina, minerale, vitamina, lignane (elemente antikancerogjene), fibra etj., është një bimë, vlerat mjekësore të së cilës nuk kanë fund.

# Kultivimi i dashurisë prindërore

Mihana Goga-Bekteshi



Feja islame na ka mësuar se prindërit janë dy qenie shumë të shtrenjta për ne dhe duhet të gëzojnë dashurinë dhe respektin maksimal në çdo moment të jetës sonë.

Feja islame na ka mësuar se prindërit janë dy qenie shumë të shtrenjta për ne dhe duhet të gëzojnë dashurinë dhe respektin maksimal në çdo moment të jetës sonë. Arroganca dhe dhuna kanë qenë gjithmonë në të kundërtën e udhëzimeve islame. Për këtë, Allahu xh.sh. thotë: “Ne e kemi porositur njeriun të sillet mirë ndaj prindërve të vet.” (El Ankebut, 8). Po ashtu, Allahu xh.sh. thotë: “Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuronit tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve.” (El Isra, 23).

Lidhur me këtë kemi edhe hadithin e Pejgamberit a.s., të cilin na e transmeton Abdullah ibën Mesudi r.a., i cili thotë se është pyetur Pejgamberi a.s. se cila është vepra më e dashur tek Allahu, e ai u përgjigj: “Namazi në kohën e vet”. Po pas kësaj, e pyeti prapë, po pastaj: “Bamirësia ndaj prindërve” iu përgjigj.<sup>1</sup>

Për të treguar rëndësinë dhe vlerën që ka respekti ndaj prindërve, Zoti xh.sh. e përmendi atë menjëherë pas adhurimit të Tij. Kjo na bën të kuptojmë se adhurimi dhe përkushtimi ndaj Zotit xh.sh. nuk është i plotë nëse mungon respekti ndaj prindërve. Nëse prindërit janë të shqetësuar, të zemëruar, të nënçmuar, të lënë anash e pa përkujdesje nga fëmijët e tyre, atëherë kuptohet se edhe Zoti xh.sh. nuk është i kënaqur me ata që nuk shprehin respekt ndaj tyre.

Madje, edhe sikur prindërit të jenë gabimtarë në aspekte të ndryshme, ata duhen respektuar e nderuar dhe assesi e në asnjë moment askush nuk duhet t’i fyej ata. Transmetohet nga Abdullah ibën Amri se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Prej gjynaheve të mëdha është kur njeriu fyen prindërit e tij.” Dikush nga të pranishmit e pyeti: “Si ka mundësi njeriu të fyej prindërit e tij?” Pejgamberi a.s. tha: “Kur një person e fyen babanë e dikujt, atëherë edhe ai e fyen babën e tij, gjithashtu kur fyen nënën e dikujt edhe ai fyen nënën e tij.”<sup>2</sup>

Mësimet burimore fetare na mësojnë se prindi nuk respektohet dhe nderohet një herë në vit, ose një herë në muaj, ose një herë në javë! Jo, ai duhet respektuar e nderuar çdo ditë dhe çdo moment.

Pejgamberi a.s. na tregon se kujdesi më i madh duhet të tregohet ndaj nënës e më pastaj ndaj babait. Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a., i cili thotë: “Erdhi një njeri te Pejgamberi a.s. dhe e pyeti: “O i Dërguar i Allahut, kush është më i denjë për respekt ndaj tij?” Pejgamberi a.s. tha: “Nëna jote.” Po pastaj? Pejgamberi a.s. tha: “Nëna jote.” Po pastaj pyeti përsëri? Pejgamberi a.s. tha: “Nëna jote.” Po pastaj pyeti përsëri? “Babai yt” – iu përgjigj Pejgamberi a.s..<sup>3</sup>

Më të afërmit e njeriut janë prindërit e tij. Nëse jemi bamirës ndaj tyre, Zoti xh.sh. na i



pranon lutjet. Këtë na e tregon hadithi të cilin e transmeton Abdullah ibën Omeri r.a., i cili thotë: “E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut a.s. duke thënë: “Tre veta nga gjeneratat para jush u nisën për rrugë, e një ditë i zuri nata para një shpelle në të cilën hynë për të fjetur. Një shkëmb u rrokullis nga kodra dhe e mbylli plotësisht hyrjen e shpellës. Ata thanë: “Shpëtimi nga ky shkëmb është vetëm që ta lusim Allahun e madhërishëm që ta largojë për hir të veprave tona të mira”. Njëri prej tyre tha: “O Zoti im, unë i kam pasur prindërit pleq të thinjur dhe asnjëherë nuk ju kam dhënë të hanë e as të pinë fëmijëve të mi e as mallit tim (shërbëtorëve) para tyre. Një ditë më argëtoi kërkimi i kullës së mirë për kopenë time e nuk ju erdha me kohë, andaj ata kishin fjetur. Unë e mola qumështin në enë dhe ua solla, por i gjeta duke fjetur. Më erdhi keq t’i trazon, por nuk doja që t’i ushqej familjen dhe shërbëtorët para tyre, prandaj kam pritur me enë në dorë dhe kam shikuar kur do të zgjohen e kjo pritje ka zgjatur deri në agim. Fëmijët e mi aty te këmbët e mia qanin të uritur, por unë ua dhashë qumështin vetëm pasi janë zgjuar prindërit dhe e kanë pirë qumështin të cilin ua kisha sjell. O Zoti im! Nëse këtë e kam bërë vetëm për Ty e për askënd tjetër, atëherë na e largo neve këtë shkëmb nga hyrja e kësaj shpelle në të cilën gjendem!” me këtë rast shkëmbi lëvizi pak...<sup>4</sup>

T’i kujtojmë me lutje pasi kanë vdekur, të bëjmë dua për ta: “Zoti ynë! Më fal (gabimet) mua edhe prindërve të mi, fali edhe të gjithë besimtarët ditën kur jepet llogaria!” (Ibrahim, 41).

### DETYRAT E FËMIJËVE NDAJ PRINDËRVE

- Të sillen mirë ndaj prindërve të tyre;
- Të sigurojnë jetesën e tyre, në rast se ata kanë probleme të tilla;
- Të mos ua thyejnë zemrën prindërve me fjalë apo me sjellje, madje të mos u thuhet as “of!”;
- T’u buzëqeshim atyre, t’u themi fjalë të ëmbla, dhe të mos i shikojmë të nervozuar dhe me shikim të vrazhdë;
- T’u shërbejnë atyre, në rast se kanë nevojë për shërbim dhe ta përmbushim këtë me dëshirë;
- Të mos flasin me zë të lartë para tyre;
- Të mos kalojmë para tyre kur ecim në rrugë;
- T’u përgjigjemi menjëherë kur na thërrasin;
- T’i kujtojmë me lutje pasi kanë vdekur, të bëjmë dua për ta: “Zoti ynë! Më fal (gabimet) mua edhe prindërve të mi, fali edhe të gjithë besimtarët ditën kur jepet llogaria!” (Ibrahim, 41).

1 Sahihul Buhari në gjuhën shqipe nga F. Mehdiu, hadithet, 5351- 6226, Prishtinë, 2014, fq. 275.

2 Po aty, hadithi nr. 6529

3 Sahihu Muslim, hadithi nr. 2548

4 Sahihul Burahi, hadithi nr. 2333, Sahihu Muslim, hadithi nr. 2743

# Mjedisi dhe rrethi shoqëror si faktorë ndikues në formësimin e personalitetit të fëmijës

Phd. Melihate Zeqiri

## MJEDISI SHOQËROR - GRUPMOSHA

Njerëzit, nevojat e ndryshme sociale dhe psikologjike mund t'i plotësojnë vetëm duke u bërë pjesë e një grupi. Duke u bërë pjesë e një grupi, njeriu ndihmohet të fitojë një pozicion social, kurse nga ana psikologjike të fitojë formimin e një ekuilibri. Te këto grupime hyjnë grupet shoqërore dhe grupmoshat. Grupet shoqërore dhe grupmoshat në përgjithësi formohen prej anëtarëve që kanë të njëjtën moshë dhe vendndodhje. Përfshijnë njerëz me nivele të ngjashme ekonomiko-sociale, me fe dhe prejardhje etnike të njëjtë. Qëllimet, interesat, pritshmëritë, vlerat, parimet dhe mënyrat e komunikimit janë të njëjta.<sup>1</sup>

Pas familjes, mjedisi shoqëror është ambienti ku fëmija kalon më të shumtën e kohës, ku ndan sekretet e tij me të tjerët, vepron për të tejkaluar ndjenjat dhe mendimet e tij. Fëmija që bëhet pjesë e një ambienti të tillë, merr iniciativën e ndërtimit të marrëdhënieve të mira. Mëson të jetojë në harmoni me moshatarët e tij. Kjo lloj marrëdhënieje zhvillon aftësitë sociale si shoqërimi, solidarizimi, ndarjen me të tjerët dhe krijimin e miqësisë. Fëmija, i cili bëhet anëtar i një grupi shoqëror, njeh vetveten, zhvillon personalitetin e vet dhe hedh hapat e para drejt botës së të rriturve.<sup>2</sup>

Pas familjes, mjedisi shoqëror është ambienti ku fëmija kalon më të shumtën e kohës, ku ndan sekretet e tij me të tjerët, vepron për të tejkaluar ndjenjat dhe mendimet e tij.

Në grupin shoqëror, fëmijët mësojnë të mendojnë, vendosin dhe të veprojnë bashkërisht, e të tjera sjellje si këto. Në të njëjtën kohë, cilësi si: besimi reciprok, respekti dhe përshtatshmëria ndërmjet anëtarëve të grupit kthehen në elementë të pazëvendësueshëm. Si anëtar i grupit përkatës, fëmija përvetëson sjelljet dhe vlerat e grupit. Për të nuk është e rëndësishme shoqëria, por mendimi dhe vlera që grupi i jep atij. Për këtë arsye, ndikimi i grupit në zhvillim e personalitetit dhe moralit të fëmijës është i rëndësishëm.<sup>3</sup>

Mjedisi shoqëror i grupmoshave është ambient shoqërizimi. Ky ambient i përgatit ata për aktivitete të ndryshme e për mundësi mësimi: të japësh, të marrësh, të ndash punë gjatë bashkëpunimit, të ndjesh kënaqësi për veprimet e tjetrit dhe të mësosh si ndihet një njeri tjetër, besnikërinë, guximin, barazinë, motivimin e ndjenjës së pjesëmarrjes si dhe përforcimit të gjërave. Fëmijët dhe të rinjtë në mjediset shoqërore me grupmoshat, në njërën anë u përshtaten mjediseve, mësojnë normat dhe lidhen me to, si përfundim përvetësojnë vetveten, ndërsa në anën tjetër mësojnë të shprehin qëndrimet dhe shprehin lirshëm gjykimet e tyre. Ky mjedis u mëson atyre bashkëpunimin dhe frymën e grupit, të fitojnë aftësinë e liderit si dhe kontrollin e liderit. Këto njohuri dhe aftësi atyre iu hyjnë në punë kur të rriten.<sup>4</sup>

Grupmoshat dhe shokët, në të njëjtën kohë janë edhe modele që imitohen nga anëtarët e tjerë të grupit. Fëmijët fitojnë aftësi të reja duke vëzhguar veprimet e bashkëmoshatarëve të tyre. Shumë studime tregojnë se fëmijët ndikohen nga bashkëmoshatarët që marrin si shembull. P.sh., gjatë shpërndarjes së disa dhuratave midis shokëve të klasës, disa fëmijë të moshës 4 dhe 5 vjeç, që dukeshin shumë bujarë, kur u erdhi radha e tyre, u treguan shumë bujarë me fëmijët e tjerë, të cilët nuk kishin parë më parë sjellje të tillë bujarie. Vetëm se te fëmijët është më e madhe mundësia të imitohet sjellja e shpërndarjes së dhuratave sesa një sjellje ndëshkimore.<sup>5</sup>

Veçanërisht fëmijët që kanë aftësi në fusha të caktuara, mirëprehen nga shokët në grup. Pranimi në grup u rrit vetëbesimin fëmijëve. Kështu që, fëmija, i shpreh lirshëm ndjenjat dhe mendimet e tij në grup. Disa grupe shoqërore janë të mbyllura nga jashtë, janë grupe që ndërtojnë marrëdhënie mes vetes e janë në konflikt me vlerat shoqërore. Në të tilla grupe, sjelljet e anëtarëve mund të jenë shembull i keq për sjelljet e fëmijëve, kështu që mund t'i shtyjnë ata drejt fajit. Për këto arsye, grupet shoqërore që jetojnë jashtë shoqërisë, shpeshherë mund të ndërtojnë identitete negative e të pamoralshme.<sup>6</sup>

Fëmija para së të hyjë në periudhën e pubertetit ndikohet më shumë nga familja, ndërsa kur hyn në këtë periudhë shtohet ndikimi i mjedisit shoqëror dhe bashkëmoshatarëve. Për sa i përket moshës së adoleshencës, ndikimi që ky mjedis ka tek individit është në plan të parë. Kjo ndodh sepse mjedisi shoqëror e ul tensionin e brendshëm të të riut, atij i jepet më shumë besim për botën e jashtme, i jepet mundësia të njoh vetveten dhe të tjerët, e ndihmon në shoqërizim dhe e përgatit për jetën kolektive. Duke qenë se në mjediset shoqërore sjelljet imitohen në mënyrë të njëjtë, ekziston mundësia që të ndikohen si pozitivisht ashtu edhe negativisht. Nëse ky mjedis tregon sjellje morale të papërshtatshme dhe të prishura, këto sjellje kthehen në zakone edhe për anëtarët e tjerë të grupit. Kjo ndodh sepse të rinjtë i përvetësojnë më shumë udhëzimet e shokëve dhe bashkëmoshatarëve.<sup>7</sup>

Sikurse u theksua më lart, cilësitë morale të grupit shoqëror ndikojnë pozitivisht ose negativisht në formimin moral të fëmijës. Në formë të identifikimit me anëtarët e grupit, fëmija përvetëson sjelljet dhe qëndrimet e tyre. Nëse cilësitë morale të grupit janë të mira, morali i fëmijës zhvillohet pozitivisht. Nëse grupi përmban cilësi të moralit të keq, është e

pashmangshme që fëmija të mos jetë i prirë për të kryer faje, të përdorë drogë, të kryejë vjedhje, etj..<sup>8</sup>

## SHKOLLA

Arsimi ushqehet nga burime të ndryshme. Familja, grupet shoqërore, shkollat dhe mjetet e komunikimit masiv janë disa prej këtyre faktorëve. Ndër to, familja dhe shkolla zënë një vend të veçantë në jetën e fëmijëve. Që nga krijimi i tij, njeriu është një qenie që edukohet. Edukimi është procesi gjatë të cilit sjellja e një individ zhvillohet me anë të eksperiencës dhe me anë të dëshirës së vetë individit. Qëllimi i edukimit: transmetimi i aftësive dhe njohurive të caktuara të individit, zhvillimi i sjelljeve dhe gjykimit të vlerave.

Edukimi është njëri nga faktorët e rëndësishëm që ndikon në zhvillimin moral të individit. Individit fillon jetën e shkollës me karakteristikat dhe ndjenjat e fituara në familje deri në moshën shtatëvjeçare, siç janë: mendimet, gjykimet, njohuritë, aftësitë dhe zakonet. Ndërsa në shkollë, duke u përballur me gjëra të reja dhe të ndryshme, çdo ditë me shokët dhe mësuesit, fiton dhe zhvillon karakteristika të ndryshme. Ndikimi i edukimit në zhvillimin moral nuk shqyrtohet vetëm nga arsimtarët modernë por edhe ato klasikë. Për shembull: një arsimtar islam, Ibën Miskeveyh, shprehet kështu për edukimin dhe lidhjen e tij me moralin: “Njerëzit nga pikëpamja e karakteristikave morale nuk janë në të njëjtin nivel. Disa janë mirë, disa janë keq, disa janë të urtë e disa janë të zemëruar. Në mesin e atyre që kanë këto karakteristika ka shumë njerëz të rregullt. Ato që mbartin nga lindja janë, zemërimi, kënaqësia, nervozizmi, pangopësia e të ngjashme me këto. Duke neglizhuar zakonet e këqija, njeriu i pa trajnuar, rritet në gjendjen aktuale dhe gjatë gjithë jetës e ruan këtë gjendje. Ndërveprimi ndikues i karakteristikave të individëve dhe faktorët e mjedisit, të dyja këto duke i integruar me edukimin dhe përmbledhur në të marrin formën e dëshiruar. Karakteristika të tilla morale si: e mira, e keqja, e drejta, e gabuara, mund të ndryshohen dhe zhvillohen vetëm me edukim, për ndryshe mund të spastrohen ose trashen dalëngadalë.”<sup>9</sup>

Personaliteti i mësuesit e qëndrimet e tij karshi nxënësve pasqyrohen te personaliteti i nxënësve. Nxënësit, duke

Fëmija para së të hyjë në periudhën e pubertetit ndikohet më shumë nga familja, ndërsa kur hyn në këtë periudhë shtohet ndikimi i mjedisit shoqëror dhe bashkëmoshatarëve.



marrë si shembull mësuesin mundohen të identifikohej me të. Për këtë arsye, sjelljet e qëndrueshme dhe të ekuilibruara të mësuesit, me drejtësinë dhe dashurinë e treguar ndaj nxënësve, ndikon tek ata në sjelljen e zellshme e padurimin, por duke u përpjekur të sigurojë disiplinën në klasë mund të lerë ndikim negativ të nxënësit. Një e vërtetë e madhe është se: personi që jep bazat e dashurisë në mjedisin e përbashkët, nuk bën vetë padrejtësi. Duke kritikuar padrejtësitë siguron zhvillimin e një ndërgjegje të ndjeshme të nxënësit, nuk përdor fjalë të këqija, fyese apo poshtëruese. Një mësues në mënyrë të tillë u përçon nxënësve karakteristika pozitive, orienton zhvillimin e personalitetit të tyre në drejtimin pozitiv.<sup>10</sup>

Qëllimi i edukimit moral është arritja e individit të bëjë gjykime mbi moralin. Çdo individ, duhet të jetë në gjendje të japë gjykimin e tij moral në formën e mendimit të lirë.

Fëmijët dhe të rinjtë në shkollë duke përfutur njohuri në fusha të ndryshme në të njëjtën kohë përfitojnë edhe disa përvoja të reja. Ata mësojnë si të kenë marrëdhënie me njerëz të ndryshëm, përshtatjen me grup, sakrificat që kërkon jeta në shoqëri, tregojnë respekt ndaj mendimeve e të drejtave të të tjerëve. Atmosfera sociale në shkollë, niveli i drejtësisë që

zotëron, ndikojnë në zhvillimin moral të fëmijës. Në edukimin familjar e shoqëror përveç sjelljeve të mira mund të fitohen dhe sjellje të padëshiruara. Përkrah edukimit shoqëror, me kalimin e kohës janë ndërtuar institucione të arsimit të planifikuara dhe programuara. Kur fëmija del nga familja, që është i vetmi institucion i socializimit të tij, njihet me një tjetër institucion social, shkollën.<sup>11</sup>

Edukimi i nxënësve me rregullat e sjelljes, vlerat shoqërore dhe kontributet në zhvillimin moral të tyre janë funksionet më të rëndësishme të shkollës. Në shkollë, nxënësi, përveç të mësuarit konjitiv, mëson edhe respektin, mirëkuptimin, solidarizimin, etj. Kerschenstainer, i quan shkollat e sotme “shkolla të librit”, mbron idenë se shkollat kontribuojnë në një masë të caktuar në zhvillimin moral të fëmijëve.

Sipas Halstead dhe Taylor, shkolla u njeh dhe transmeton nxënësve vlerat ekzistuese të moralit, por bën të mundur edhe ndërtimin e vlerave të veta mbi to. Aktori më i rëndësishëm i zhvillimit moral në shkollë është mësuesi. Veçanërisht, ata ndihmojnë fëmijët në zhvillimin e vlerave morale, por njëkohësisht kanë ndikim mbi ta. Nëse mësuesi është i drejtë dhe shfaq cilësi të personalitetit të mirë, kjo pasqyrohet pozitivisht edhe te fëmijët.<sup>12</sup>

Shkolla kërkon nga çdo fëmijë që të zbatojë rregulla të caktuara e të mësojnë. Në këtë aspekt, ajo luan një rol të rëndësishëm në përfitim të sjelljeve pozitive, si: përgjegjshmëria, durimi dhe drejtësia. Në të njëjtën kohë, shkolla u mëson fëmijëve aftësinë e të menduarit rreth vlerave morale e bën që ngjarjet e jetës t'i shohin nga dritarja e respektit, dashurisë dhe mëshirës.

1 K KÖSE, C YAZICI, P DOĞAN, Ö AŞÇIOĞLU - Erciyes Tıp Dergisi, 1997 - app.trdizin.gov.tr Beh&cccedil; et's Disease- Köse, 1997: 141)

2 Po aty, Yörükoğlu, f. 59-60

3 Bey, M. S. (2002). Eğitim ve Toplumsal Sorunlar Üzerine Konferanslar. Ed: Osman Kafadar dhe Faruk Öztürk, Kültür Bakanlığı Yay., Ankara. Tarhan, f. 105

4 Atkinson, L. R. (1995). Psikolojiye Giriş. (Përkth. Kemal Atakay), Sosyal Yay., İstanbul. Elkin, 1995: 88-93

5 Atkinson, R. L., Richard C. Atkinson, Ernest, R. H. (1995). Psikolojiye Giriş. (Përkth. K. Atakay), Sosyal Yay., İstanbul. Atkinson, 1995: 107

6 Yörükoğlu, 1986: 64

7 Avci, H. (2000). Çocuk Eğitimi mi Anne Baba Eğitimi mi Sızıntı Dergisi, sayı: 256. Köylü, 2000: 2

8 Atlı, G. (2002). Aile ve Çocuk Eğitimi Üzerine Sohbetler. Etüt Yayınevi, İstanbul. Tarhan, 2002: 105

9 Aksoy, Ö. A. (1998). Atasözleri ve Deyimler Sözlüğü. C.1, I-II, İnkılap Yay., İstanbul. Bilgin, 1998: 31

10 Baymur, F. (1994). Genel Psikoloji. İnkılap Kitabevi, İstanbul. Peker, 1994: 60-61

11 Althof, W., Graz, D. (2004). Lawrence Kohlberg: Deutsches Institut für Internationale Pädagogische Forschung German Institute for International Educational Research Mitglied der Leibniz-Gemeinschaft Frankfurt. Akbaş, 2004: 27

12 Bandura, A. (2000). Self-Efficacy: The Exercise of Control. W.H. Freeman and Company, New York. Halstead-Taylor, 2000: 169

# Lindja dhe Perëndimi për bashkëjetesën njerëzore

Mr. Besim Mehmeti

Nën patronazhin e shkëlqesisë së tij, mbretit të Mbretërisë së Bahrejnit, Hamad bin Isa al Khalifa, në qytetin Manama, me pjesëmarrjen e një numri figurash të shquara intelektuale dhe përfaqësues të feve nga vende të ndryshme të botës, u zhvilluan aktivitetet për dialogun në Forumin e Bahrejnit me titull “Lindja dhe Perëndimi për bashkëjetesën njerëzore”. Në këtë forum të mbajtur me datë 2-3 nëntor, kisha nderin të marrë pjesë në emër të Myftiut të Kosovës. Ajo që këtë forum e bëri shumë të rëndësishëm ishte edhe vizita historike dhe pjesëmarrja e Papa Françeskut dhe Shejhul Al-Az’harit, Ahmed al-Tajib. Mbyllja e këtij forumi u organizua në pallatin mbretëror me praninë e mbi 500 përfaqësuesve të të gjitha religjioneve nga e mbarë bota. Në mbyllje të Forumit, folën mbreti Hamad bin Isa al Khalifa, Shejhu i Az’harit, Ahmed al-Tajib dhe Papa Françesku.

Në fjalën e tij, mbreti i Mbretërisë së Bahrejnit<sup>1</sup>, Hamad bin Isa al Khalifa, u dëshiroi mirëseardhje pjesëmarrësve të këtij takimi historik të rëndësishëm. Ai theksoi përqendrimin dhe përkushtimin e tij dhe të qeverisë që ai udhëheq për të kontribuar në përhapjen e paqes dhe ruajtjen e saj. Gjithashtu, Mbreti Hamad, shprehu interesin, rëndësinë dhe përkrahjen e ofruar për diskutimet dhe konkluzat e dala nga ky takim duke shtuar: “Të nderuar të pranishëm! Të gjithë kemi ndjekur me shumë interes diskutimet dhe tematikat e shtjelluara në diskutimet e Forumit, dhe ne i shikojmë rezultatet dhe rekomandimet e tij të çmuara me optimizëm e me shumë shpresë, si dëshminë më të mirë për të forcuar marshimin e vëllazërisë njerëzore, që është një nevojë urgjente, për të ringjallur mënyrat e afrimit dhe mirëkuptimit midis të gjithë njerëzve të feve dhe besimeve, si një pikë hyrëse bazë për zëvendësimin e mosmarrëveshjeve me konsensus, dhe vendosjen e unitetit në vend të ndarjes. Në dritën e rezultateve tuaja të rëndësishme, të cilat ne i

mbështesim fuqimisht, ne mund t’ju sigurojmë vetëm se do t’u japim atyre – me lejen e Allahut - kujdesin tonë maksimal.” Në fund, mbreti Hamad, bëri thirrje për ndërprerjen e luftës Rusi - Ukrainë.

## Fjala e shejhut të Az’harit dr. Ahmet Tajib<sup>2</sup>

Pas mbretit Hamad, të pranishmëve me një fjalim iu drejtua shejhu i Az’harit, i cili u fokusi në përcjelljen e mesazheve frymëzuese për të kontribuar në paqen globale.

**Bahrejni, vend i lashtë me trashëgimi të gjatë të bashkëjetesës** – Ai, ndër të tjera tha se ky Forum është takim historik për shkak të figurave të mëdha të studiuesve, njerëzve të mençur, liderëve të mendimit, politikanëve të lartë, profesionistëve të medias dhe të tjerëve nga Lindja dhe Perëndimi. Është një zë që buron nga Bahrejni, ky vend i lashtë, i cili ka një trashëgimi të gjatë të prirjes ndaj paqes dhe tolerancës, bashkëjetesës së qytetërimeve dhe kulturave dhe dialogëve të tyre, dhe transformimit të asaj që është e përshtatshme nga këto vlera në një burim krijues dhe kreativ, energji që dërgon drejt stabilitetit shoqëror dhe zhvillimit social konstruktiv.

**Trazirat dhe konfliktet në botë janë si rezultat i mungesës së ligjit të drejtësisë** – Është e rëndësishme të theksojmë se shkak i këtyre tragjedive është “mungesa” e ligjit të “drejtësisë” ndërkombëtare që ka vendosur Zoti, ligji për stabilitetin e shoqërive dhe arritjen e ekuilibrit njerëzor: të trupit dhe shpirtit në këtë tokë, përndryshe shoqëritë njerëzore do të kthehen në ato që ngjajnë me shoqëritë e xhunglës dhe pyjeve. Harrojmë viktimat e luftërave të bëra nga “ekonomia e tregut” dhe monopolit të pasurisë, lakmia e pronësisë dhe konsumit, tregtia e armëve të rënda të shkatërrimit në masë dhe vdekjeprurëse dhe eksportimi i tyre në vendet e botës së tretë, promovimi dhe eksportimi i



konflikteve sektare, nxitjes së rebelimit, fitnes, konfliktit dhe destabilizimit.

**Qasjet superiore të perëndimit janë të bazuara në teori filozofike** – Politikat që prodhojnë këto tragjedi mbështeten nga teoritë filozofike që kanë zbritur në realitetin e shoqërive perëndimore dhe që kanë udhëhequr perceptimet e vendeve të mëdha në marrëdhëniet e tyre ndërkombëtare me popujt në zhvillim dhe popujt e varfër. Këto teori janë: teoria e përplasjes së qytetërimeve, teoria e përfundimit të historisë dhe teoria e globalizimit. Të gjitha këto janë teori superiore, hapin rrugën për lindjen e një rendi të ri botëror dhe mundësojnë kolonializmin modern, për të cilin nuk i dimë fillimet e tij e nuk i dimë as të fshehurat e sekretet e tij. Vetëm pak ditë më parë dëgjuam deklaratat e një zyrtari të lartë perëndimor që thoshte: “Evropa është një kopsht i harlisur dhe bota përreth saj është xhungël dhe pyje.” Deklarata të tilla të pastudiuara, nëse tregojnë diçka, tregojnë një injorancë të qartë ndaj qytetërimeve të Lindjes dhe të historisë së tyre, e cila i ka rrënjët në më shumë se pesë mijë vjet, e jo vetëm në tre ose katërqind vjet.

**Politikat perëndimore nuk po ofrojnë zgjidhje për krizat globale** – Megjithatë, shumica e kësaj frike, që frikëson shpirtat e lindorëve sot nga qytetërimi perëndimor është – në të njëjtën masë – ajo që frikëson mendjet e një elite të shquar të mendimtarëve perëndimorë dhe të liderëve të saj të lartë. Disa prej tyre me të vërtetë kuptuan se, politika perëndimore nuk është më e dobishme për trajtimin e krizave globale, për shkak të konvulsioneve të saj që bazohen në shfaqjen e forcës. Ata sugjerojnë që “kultura” të zëvendësoj “politikën” në marrëdhëniet ndërkombëtare, për shkak të aftësisë së kulturës për të kuptuar qenien njerëzore dhe për

të asimiluar dimensionet e tij të shumëfishta: trupin, shpirtin, mendjen dhe ndërgjegjen.

**Perëndimi dhe Lindja kanë nevojë për njëri-tjetrin** – Pasi distancat janë afruar dhe kufijtë janë zhdukur, as Perëndimi dhe as Lindja nuk janë më të izoluar nga tjetri, siç ishin në shekullin e kaluar. E vërteta është se Perëndimi ka nevojë për urtësinë e Lindjes, fetë e tij, vlerat morale me të cilat janë rritur njerëzit dhe një pikëpamje të ekuilibruar për njeriun, universin dhe Krijuesin e universit. Ka nevojë për spiritualitetin e Lindjes dhe thellësinë e pikëpamjeve të tij për realitetet e gjërave, ka nevojë të ndalet për një kohë të gjatë në urtësinë e përjetshme që thotë: “Jo çdo gjë që shkëlqen është flori.” Përkundrazi, Perëndimi ka nevojë për tregjet e Lindjes dhe krahët e bijve të tij, për fabrikat e tij në Afrikë, Azi dhe gjetkë, dhe ka nevojë për lëndët e para të depozituara në thellësi të këtyre dy kontinenteve, pa të cilat, fabrikat e Perëndimit nuk do të kishin gjetur asgjë për të prodhuar. Dhe nuk është e aspak e drejtë të jetë shpërblimi i bamirësit më shumë varfëri, injorancë dhe sëmundje. Dhe e njëjta gjë thuhet për Lindjen, ajo ka nevojë të marrë nga shkencat e Perëndimit dhe t’i përdorë ato në rilindjen e tij teknike dhe materiale dhe të importojë produkte industriale nga tregjet perëndimore. Edhe orientalët duhet ta shikojnë Perëndimin në një mënyrë të re, me më shumë vullnet të mirë dhe ndjenjë për fqinjën e afërt, dhe një kuptim tolerant të qytetërimit të Perëndimit dhe zakoneve të perëndimorëve, pasi ato janë rezultat të rrethanave, zhvillimeve dhe ndërveprimeve të tyre, për të cilat ata e paguan shtrenjtë gjatë disa shekujve.

**Dijetarët e Islamit nuk duhet të lodhen duke sqaruar parimet e larta islame** – Dijetarët duhet të sqarojnë çfarë ka në fenë islame nga parimet e larta, vëllazërisë njerëzore, bashkëpunimit njerëzor dhe bazave të tjera të përbashkëta





njohje, bashkëpunim dhe vëllazëri. Ajo theksoi rëndësinë e marrëdhënieve midis Lindjes dhe Perëndimit dhe se si secili mund të përfitojë nga tjetri.

**Sot kemi një teori islame lindore, një alternativë ndaj teorisë së “përplasjes së qytetërimeve”, e quajtur teoria e “njohjes civilizuese”** – Kjo teori bazohet në fjalën “njohje” e përmendur në Kuranin famëlartë, ajo bazohet në kornizën e tij të përgjithshme në tre parime kuranore:

**Parimi i parë:** Është se Zoti i Madhëruar i krijoi robërit e Tij të

mbi të cilat perëndimorët dhe lindorët pajtojnë dhe i mirëpresin. Ata duhet të jenë të etur për t’ua prezantuar Islamit perëndimorëve ashtu si ai është.

**Kulturat dhe qytetërimet duhet të respektohen** – Komunikimi global dhe migrimi në Lindje dhe Perëndim, përzierja e popujve mes veti, detyrimisht na obligojnë të respektojmë njëri-tjetrin. Dr. At-Tajib shtoi: “Duhet të theksohet gjithashtu se shumë myslimanë migruan në Perëndim, u vendosën atje dhe u bënë pjesë përbërëse e strukturës së popujve të saj. Po kështu, stilet e jetesës dhe imazhet perëndimore migruan tek orientalët dhe dominuan traditat, zakonet dhe sjelljet moderne dhe bashkëkohore të tyre, si dhe gjëra të tjera që hapin rrugën për të vendosur një marrëdhënie të re njerëzore, në të cilën do të përfshihet një qytetërim i qetë. Aty ku do të ruhen kulturat e popujve, karakteristikat dhe dallimet e tyre, larg rrugëve të dominimit kulturor dhe qytetërimeve konfliktuale. Këtë e vërteton mendimtari bashkëkohor francez, Todorov Tzvetan, në librin e tij “Frika nga barbarët”, ku thotë: “Vetëm kultura perëndimore nuk mund të konsiderohet e qytetëruar dhe kriter mbi të cilin përcaktohen kulturat e të tjerëve.” Çdo ndërhyrje në kulturat e të tjerëve është shpërdorim i pushtetit. Sepse liria dhe barazia nuk mund të vendosen me detyrim, përndryshe ne nuk do të ndryshonim nga ata që i përshkruajmë si barbarë.

**Dokumenti i vëllazërisë njerëzore, dokument i rëndësishëm për paqen globale** – Kjo u konfirmua shumë qartë nga dokumenti “Vëllazëria Njerëzore”<sup>3</sup>, i cili shkaktoi një lëvizje të prekshme - në Lindje dhe Perëndim - dhe dha një model të dalluar për atë se si duhet të jetë dialogu i feve dhe qytetërimeve për sa i përket respektit të ndërsjellë dhe ndikimit efektiv në marrëdhëniet e popujve të bazuara në

ndryshëm në racë, ngjyrë, gjuhë, fe dhe karakteristika të tjera dhe se ata do të mbeten të ndryshëm në këto karakteristika deri në momentin e fundit të jetës së këtij universi. “*Sikur të dëshironte Zoti yt, do t’i bënte njerëzit të një feje (por nuk dëshiroi, Ai e di pse). Ata vazhdimisht janë në kundërshtime (mes vete).*” (Hud, 118).

**Parimi i dytë:** Është se Ai, i Plotfuqishmi, ashtu siç i krijoi njerëzit, të jenë të ndryshëm; patjetër Ai i krijoi të lirë në atë që besojnë, përndryshe nuk do të arrihej ndryshimi që Ai bëri mënyrën e Tij të krijimit. Dhe për lirin e drejtës se besimit Allahu xh.sh. thotë: “*S’ka shtrëngim-imponim në fe, ngase me të vërtetë është dalluar e drejta nga e shtrembëta...*” (El Bekare, 256).

**Parimi i tretë:** Nëse Kurani famëlartë vërteton dy faktet e mëparshme, përkatësisht dallimet e njerëzve dhe garantimin e lirive të tyre në atë që besojnë, atëherë cili është lloji i marrëdhënies mes tyre në atë që vendos filozofia e Kuranit?! Nuk ka asnjë mënyrë për këtë marrëdhënie përveçse të jetë “njohuri”, të cilën Zoti i Madhëruar e ka nxjerrë si kornizë për transaksionet dhe marrëdhëniet ndërmjet njerëzve. Kjo është ajo që lexojmë shprehimisht në Kuran: “*O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s’ka dyshim se të Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që është më i devotshmi nga ju, e Allahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.*” (El-Huxhurat, 13). Po! Ai është parimi i tretë që nxirret logjikisht nga dy parimet e mëparshme dhe mund të formulohet në një rregull që thotë: Marrëdhënia legjitime mes njerëzve në Kuran është vetëm marrëdhënia e “njohjes dhe paqes”. Kështu, që ligjet kuranore për rregullimin e marrëdhënieve njerëzore në Kuranin e shenjtë ndjekin një

rend logjik, në të cilin nuk ka vend për interpretim apo shtrembërim.

**Islami, fe e paqes dhe lirisë** – Nga këto tekste që vendosin konceptin e Islamit, bëhet e qartë se Islami është feja e paqes, feja e lirisë që njerëzit të ndryshojnë në besim dhe të ndryshojnë në mendime, dhe se nuk është e vërtetë ajo që thuhet dhe ajo që promovohet kohë pas kohe, se arsyeja e ligjshmërisë së luftës në Islam është blasfemia (kufri) e të tjerëve, sepse kjo është shpifje për Islamit dhe historinë e të Dërguarit të Islamit, edhe nëse këtë e bëjnë disa nga ata që janë besimtarë të lidhur me këtë fe, e cila është e bazuar në argument dhe provë, dhe jo në dyshime dhe shpifje.

Në përfundim të fjalimit të tij, shejhu i Az'harit drejtoi dy thirrje të rëndësishme:

- Një thirrje për studiuesit fetarë, mendimtarët dhe profesionistët e medias që të bëjnë më shumë përpjekje për edukimin e të rinjve rreth të përbashkëtave të feve dhe transformimit të tyre në programet bashkëkohore, shkencore e arsimore, të cilat u mësojnë atyre se jeta në filozofinë e feve ndryshon nga njëra-tjetra, dhe se diversiteti i kulturave pasuron qytetërimin njerëzor dhe ndërton paqen e humbur.

- Një apel teologëve islamikë në mbarë botën, pavarësisht nga sektet, medhehebet dhe shkollat e tyre, që të nxisin të zhvillojnë një dialog serioz (islamo-islamk), për të miratuar unitetin, afrimin dhe njohjen, një dialog për hir të vëllazërisë fetare dhe njerëzore, në të cilën refuzohen veçanërisht shkaqet e ndarjes, fitneve dhe konfliktit sektar. Në të cilin përqendrohet në pikat e marrëveshjes dhe konvergencës. Vlen të theksohet se në këtë thirrje, Shejhu i Az'harit, veçoi thirrjen drejtuar myslimanëve shiitë.

Në fund të fjalimit, dr. At Tajjib, bëri thirrje për ndërprerjen e luftës ruso-ukrinase, nga e cila po vuajnë të pafajshmit dhe po sjell shumë viktima dhe dhune në ato vende.

#### **Fjala e Papa Françeskut<sup>4</sup>**

Duke përdorur emrin e Bahrejnit, që në arabisht do të thotë “ndërmjet dy deteve”, njëri me ujë të ëmbël e tjetri të kripur, Papa denoncoi se njerëzimi është i përçarë. Lindja dhe Perëndimi ngajnë me dy dete të kundërta, njëri i ëmbël e i qetë, ai i bashkëjetesës paqësore, e tjetri i hidhur, ai i indiferencës e i luftës. Por ne, jemi këtu për të lundruar në të njëjtin det, për t'u takuar e jo për t'i bërë luftë njëri-tjetrit, duke u interesuar për kulturën e secilit e duke punuar së bashku, sidomos për t'ua ndryshuar fatin të varfërve të kësaj toke. Papa përmendi Dokumentin e Vëllazërimit Njerëzor, nënshkruar më 2019 në Abu Dabi, për t'u kërkuar feve të mos izolohen, por edhe për të përvijuar objektiva konkrete. I pari është që mosmarrëveshjet ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit të zgjidhen për të mirën e të gjithëve, pa e shkëputur

vëmendjen nga një hendek tjetër në thellim të vazhdueshëm e dramatik, ai ndërmjet Veriut dhe Jugut të botës.

**Liria fetare “e domosdoshme”** – Papa i ftoi të gjithë në lutje, për t'u çliruar nga egoizmi, për të fituar paqen e zemrës, në mënyrë që ta dëshmojnë më pas atë në jetën konkrete. Vetëm kështu, të tjerët, që e shohin shembullin e tyre, nuk do të bëhen pengje të një paganizmi, që e redukton njeriun në mallin që shet e blen, ose në mjetet, me të cilat argëtohet.

**Gratë, fëmijët, qytetaria - tri sfidat edukative** – Sfida e dytë, që përmendi Papa, ishte edukimi, pasi aty ku mungon ai, shtohen fundamentalizmat. Arsimi, nënvizoi ai, nuk duhet të jetë tejet i rreptë, i përbërë vetëm nga rregulla e norma të ngurta, por duhet të pasqyrojë ndryshimet e vazhdueshme kulturore, t'u japë të drejta e mundësi të gjithëve e jo vetëm disave. Papa vuri në dukje tri urgjenca edukative: njohja e të drejtave të grave; mbrojtja e fëmijëve, që ata të arsimohen, të mos jetojnë në uri e në dhunë; si edhe edukimi për të qenë qytetarë të mirë, duke respektuar ligjin e bashkëjetesën.

**Të izolohehen të dhunshmit që abuzojnë me emrin e Zotit** – Objektivi i tretë, që përvijoi Papa, ishte dënimi i dhunës dhe i atyre që abuzojnë me emrin e Zotit. Është e nevojshme të ndërpritet përkrahja e lëvizjeve terroriste, përmes furnizimit me para, armë, plane apo justifikime, madje edhe mbulimi i tyre mediatik, duke i konsideruar këto si krime ndërkombëtare, që kërcënojnë sigurinë dhe paqen botërore. Duhet dënua një terrorizëm i tillë në të gjitha format dhe manifestimet e tij.

**T'i kundërvihemi luftës dhe riarmatimit** – “Njeriu i fesë-njeriu i paqes, i kundërvihet edhe garës së riarmatimit, biznesit të luftës, tregut të vdekjes”, pohoi Papa Françesku. Papa i ftoi krerët e feve të mbajnë lidhje më të forta, “pa dyfytërsi dhe pa frikë”, si vëllazër, si motra. Para pushtetarëve të paskrupullt, njerëzit e fesë duhet të dëshmojnë një mënyrë tjetër takimi, pasi forca, armët dhe paratë nuk do ta ngjyrosin kurrë të ardhmen me paqe. Udhëtimi i feve të mëdha qoftë më i frytshëm dhe i vazhdueshëm, qoftë ndërgjegjja e paqes për botën!

1 <https://www.alayam.com/online/local/985809/news.html>

2 <https://www.almasryalyoum.com/news/details/2733016>

3 Dokument i nënshkruar nga shejhu i Az'harit dhe papa në Abu Dhabi, më 04.02.2019. Shih “Edukata Islame”, nr. 124. f. 157.

4 <https://www.vaticannews.va/ar/pope/news/2022-11/viaggio-bahrein-forum-dialogo-orient-occidente.html>

# Vepër me shumë interes për historinë islame në gjuhën shqipe\*

Ramdan Shkodra

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që sot para jush, para këtij auditori të nderuar, në këtë vend të kulturës dhe arsimit islam e kombëtar, në Medresenë e “Gazi Isa Beut”, t’i them disa fjalë për bibliografinë “Botimet islame në gjuhën shqipe deri më 2020”, të autorit Shaban Ramani, të botuar nga RIJASET-i i BFI-së së RMV-së.

Më lejoni që në fillim, që të konstatojë atë që është tashmë është e njohur se, roli i bibliografive të botuara në zhvillimin e dijes është i padiskutueshëm. Duke e ditur se nocioni bibliografi, në kuptimin e realizimit, ka domethënien e “klasifikimit dhe të përshkrimit shkencor e sistematik të botimeve të ndryshme (të librave, të revistave etj.) për t’ua bërë të njohura të tjerëve”, është plotësisht e qartë se njohja më e plotë e përmbajtjeve të ndryshme shkrimore për

disiplina, çështje, aspekte, periudha etj., është e mundur vetëm në saje të një informacioni të përmbledhur, të sistemuar dhe orientues. Megjithëse nuk kanë munguar përpjekjet në dekadat e fundit që të kemi sa më shumë bibliografi, në dijen shqiptare ende ka shumë për të bërë në këtë drejtim, kurse për sa u përket literaturës dhe botimeve islame në gjuhën shqipe në përgjithësi, akoma jemi në fazën fillestare.

Nisma për botimin e bibliografisë “Botimet islame në gjuhën shqipe deri më 2020”, e autorit Shaban Ramani, është një veprim i çmueshëm dhe përmbushje e një boshllëku, të cilin deri tani e kanë ndier të gjithë profesionistët dhe studiuesit që merren me aspekte të islamistikës, të kulturës dhe të trashëgimisë sonë islame.

Objekt i punës bibliografike të autorit Shaban Ramani ka qenë përmbledhja e librave, broshurave dhe çdo lloj shtypi tjetër të literaturës islame në gjuhën shqip të botuar në trojet shqiptare, por edhe të atyre të botuara jashtë këtyre trojeve. Kjo vepër bibliografike demonstroi pasurinë e koleksioneve të librit islam në gjuhën shqipe, pjesë e trashëgimisë historike dhe kulturore të popullit shqiptar. Ajo synon kështu të lidhë informacionin bibliografik të munguar gjerë më sot e të përmbledhur në një monografi të këtij formati dhe në këtë formë të botimi.

Objekt i punës bibliografike të autorit Shaban Raimi ka qenë përmbledhja e librave, broshurave dhe çdo lloj shtypi tjetër të literaturës islame në gjuhën shqip të botuar në trojet shqiptare, por edhe të atyre të botuara jashtë këtyre trojeve.



*Të nderuar të pranishëm,*

Vëllimi i bibliografisë “Botimet islame në gjuhën shqipe deri më 2020”, është një punë me shumë interes për historinë e literaturës shqipe në përgjithësi e asaj islame në gjuhën shqipe në veçanti. Themi kështu, sepse kemi parasysh faktin se autori Ramani, përveçse i ka dhënë vetës si mision e qëllim tubimin e një pjese të kënaqshme të literaturës islame në gjuhën shqipe të botuar gjithandej ku jetojnë shqiptarët dhe e ka bërë pronë të bibliotekës së tij, ai këtë mision të tij e ka ngritur edhe në një nivel tjetër, duke ua bërë atyre edhe përshkrimin bibliografik, i ka klasifikuar me një rend të caktuar metodologjik, bazuar në standardet më të përparuara të hartimit të bibliografive. Kështu, autori Ramani ua ka mundësuar përdoruesve të kontributeve të literaturës islame në gjuhën shqipe një qasje më të lehtë në rezultatet e gjithëmbarshme diturore të studiuesve islamë, rezultatet e të cilëve e panë dritën e botimit në botime të veçanta monografike për më shumë se një shekull.

Punën që ka bërë autori Ramani, qoftë në tubimin e literaturës islame në gjuhën shqipe, po ashtu edhe në hartimin e bibliografisë, është për t’u përshëndetur, mbështetur e përkrahur. Një punë e tillë, meriton një mirënjohje të madhe e të veçantë, meriton një vlerësim të tillë, sepse e gjithë kjo ndërmarrje deri në botim, ka qenë iniciativë individuale e autorit Shaban Ramani, e përcjellë natyrisht me shumë mund e durim dhe e kushtueshme kohërisht e materialisht.

Prandaj, përtej kësaj, themi dhe jemi të bindur se tubimin e literaturës islame në gjuhën shqipe dhe trajtimin e saj meritore, duhet ta bëjnë, në radhë të parë, institucionet tona kompetente, para se gjithash bashkësitë tonë islame, të cilat e kanë mundësinë dhe potencialin e duhur, intelektual profesional e material që të themelojnë në radhë të parë bibliotekat e tyre jo vetëm për nevojat brenda institucionit, por me karakter gjysmë publik dhe publik, ku do të tuboheshin, mbledheshin, ruheshin e sistemoheshin të gjitha botimet islame në gjuhën shqipe dhe jo vetëm ato, por edhe dorëshkrimet dhe dokumentet e tjera të rëndësishmet nga e kalaruar jonë.

Mendoj se kështu do të trajtonim në mënyrë më meritore trashëgiminë tonë që është krijuar ndër breza në kohë e rrethana të vështira, e nëse trashëgiminë tonë e trajtojmë siç duhet e siç e meriton ajo, atë sigurisht që do ta kthenim në një vlerë e thesar për kulturën dhe historinë e popullit tonë në përgjithësi dhe të komuniteteve tona fetare islame në veçanti.

*Të nderuar të pranishëm!*

Literatura islame shqiptare në fillet e saj është projektuar për tërësinë e popullit tonë në të gjitha trojet tona dhe pikërisht ky projekt i ka mbajtur në një linjë e të bashkuar shqiptarët e trojeve të ndara dhe të Diasporës, dhe këtë jo vetëm për shqiptarët e besimit islam, por edhe për besimtarët shqiptarë të feve të tjera, gjë që manifeston më së miri ndenjen e përkatësisë së përbashkët të popullit tonë.



Literatura islame në gjuhën shqipe ka pasur fuqi bashkuese dukshëm më të madhe e më ndikuese se literatura jofetare e ideologjisë moniste. Andaj duke pas parasysh këtë fakt, mund të pohojmë se literatura e përbashkët islame në gjuhën shqipe është thesar i përbashkët i kulturës kombëtare, mbi të cilin mund të studiohet zhvillimi i mendimit kombëtar, përgjithësisht, dhe i mendimit filozofik islam ndër shqiptarët dhe më gjerë, veçanërisht. Kjo literaturë është bazë burimore për studime të zhvillimit të fesë, kulturës, traditës e qytetërimit ndër shqiptarët dhe të lidhjeve e të raporteve kulturore e fetare me popujt e tjerë.

Literatura e botuar islame, sikurse e dini zanafillën saj e ka në Shqipërinë e sotme administrative për të vazhduar më vonë në shoqëritë e shoqatat e shqiptarëve gjithandej nëpër botë, e pas Luftës së Dytë Botërore, për shkak të rrethanave historike, literatura islame, respektivisht libri islam në gjuhën shqipe zë fill e lëshon shtrat në Prishtinë e më vonë edhe në Shkup, po pa harruar këtu edhe kontributin e mërgatës sonë në ShBA, ku janë botuar një sërë veprash, broshurash e revistash për nevojat e komunitetit mysliman shqiptar atje.

Literatura islame në gjuhën shqipe është botuar në vende të ndryshme të botës, si në Turqi, Arabi Saudite, Itali etj., pa harruar këtu edhe faktin se viteve të fundit kemi një mori botimesh të literaturës islame në diasporë, ku qendrat dhe xhamitë shqiptare atje kanë botuar një sërë veprash e broshurash në gjuhën shqipe, si në Zvicër, Austri, Gjermani etj..

*Të nderuar të pranishëm!*

Në formë të përmbledhur përmenda disa nga kushtet, rrethanat dhe gjeografinë ku ka lindur, ku është rritur e zhvilluar literatura islame në gjuhën shqipe, për të kuptuar se literatura islame në gjuhën shqipe tashmë ka një histori të begatë e të shtrirë në të gjithë gjeografinë shqiptare dhe në vendet e tjerat ku jetojnë e veprojnë ata, gjë kjo që tregon në formën më të mirë interesimin, kontributin dhe misionin fisnik të inteligjencës, parisë, ulemasë shqiptare, e besimtarëve tanë që kanë ndaj literaturës islame, rrjedhimisht ndaj mësimëve e parimeve islame.

Literaturë islame në gjuhën shqipe është botuar në vende të ndryshme të botës si në Turqi, Arabi Saudite, Itali etj, pa harruar këtu edhe faktin se viteve të fundit kemi një mori botimesh të literaturës islame në diasporë...

E ritheksojmë edhe një herë se literatura islame në gjuhën shqipe është krijuar në kohën dhe rrethanat nëpër të cilat ka kaluar populli ynë. Ajo është rritur me fatin e popullit tonë, me të mirat dhe të këqijat që e kanë përcjellë atë, e të cilat sigurisht që kanë pasur ndikimin e tyre të pashmangshëm edhe në literaturën islame në gjuhën shqipe.

Prandaj, literatura islame në gjuhën shqipe, është pasuri jo vetëm e një lexuesi të kufizuar e specifik, e as e një komunitetit ta caktuar, por ajo është pasuri e të gjithëve, është pasuri e kulturës sonë kombëtare dhe përtej kësaj edhe pjesë e literaturës së gjithmbarshme botërore.

Për këtë arsye, bibliografia “Botimet islame në gjuhën shqipe deri më 2020” që po promovojmë sot, merr edhe një vlerë edhe më shumë dhe ka edhe një dimension tjetër më shumë se kaq.

Ajo me 3.000 njësitë e saja bibliografike të përfshira në 912 faqe, dëshmon, dhe opinionin shkencor brenda trojeve tona dhe jashtë tyre e informon për punën dhe trashëgiminë tonë shkrimore islame në gjuhën shqipe të krijuar për më shumë se një shekull. Ajo, jam më se i sigurt se do t’ju shërbej dhe do jetë një ndihmesë e madhe për studiuesit e fushave të disiplinave islame te ne, ndihmesë e veçantë për pedagogët e studentët e fakulteteve tonë, si dhe për të gjitha ata studiues e hulumtues që merren me islamistikë dhe me fushat e përafërta me të.

*Të nderuar të pranishëm*

Në fund të kësaj fjale, më lejoni që edhe një herë të përgëzoj autorin për punën e bërë, dhe dhashë Zoti që të kemi edhe kontribute të tjera nga ai edhe në të ardhmen.


Po ashtu përgëzoj edhe RIJASET-in e BFI-së së RMV-së dhe reis ulemanë, hfz. Shaqir Fatahun për botimin kaq prestigjioz të kësaj vepre të rëndësishme.

Duke ju dëshiruar sukses e mbarësi, ju përsëndes me selam dhe ju faleminderit!

*(\*Kumtesë e mbajtur me rastin e promovimit të bibliografisë “Botimet islame në gjuhën shqipe deri më 2020”, të autorit Shaban Ramani, e organizuar nga RIJASE-i i BFI-së, në Shkup, më 24 nëntor 2022)*

# Dita Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut

Mr. Muzaqete Kosumi



Ditët ndërkombëtare shërbejnë si një tregues i interesit që tërheq një temë e caktuar në çdo pjesë të botës. Një rast që vlen të theksohet është edhe Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, e cila shënohet më 10 dhjetor të çdo viti. Kjo ditë manifestohet me aktivitete të ndryshme në të gjithë botën, qofshin ato që variojnë nga oficerët e ushtrisë dhe policisë, të cilët shkëmbejnë armët me këpucë vrapimi në Sudanin e Jugut, pastaj ndonjë konkurs studentor në Rusi ose një ekspozitë në Brazil e të ngjashme. Në përgjithësi, në kremtimin e kësaj dite të veçantë, përfshihen në një mënyrë apo tjetër një mori individësh nga të gjitha sferat e jetës.<sup>1</sup>

Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut festohet çdo vit më 10 dhjetor - ditën kur Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi, në vitin 1948, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDNJ). DUDNJ është një dokument historik, i cili i shpallë të drejtat e patjetërsueshme që çdo njeri i gëzon si qenie njerëzore - pavarësisht nga raca, ngjyra, feja, gjinia, gjuha, opinionet politike ose të tjera, origjina kombëtare ose sociale, pasuria, lindja ose statusi tjetër. Ai është i disponueshëm në çdo gjuhë, dhe si i tillë ndoshta konsiderohet se është dokumenti juridik më i përkthyer në botë.

Kurdoherë dhe kudo që vlerat humane njerëzore braktisen, ne të gjithë jemi në rrezik më të madh dhe pa dilemë se zgjidhjet për krizat më të mëdha të sotme i kanë rrënjët te respektimi i të drejtave e njeriut.

Shkeljet e të drejtave kanë efektin dhe konsekuencën e vet përtej kufijve dhe brezave. Këto mund, dhe duhet të trajtohen kolektivisht. Ne duhet të ngrihemi në këmbë e të ngremë zërin lart për të drejtat tona dhe të drejtat e të tjerëve.

“Është absolutisht e qartë se ne duhet të rifitojmë universalitetin e të drejtave të njeriut, pandashmërinë e të drejtave të njeriut dhe duhet të gjejmë një energji të re që

motivon të rinjtë në mbarë botën.” Volker Türk, komisionar i lartë i OKB-së për të drejtat e njeriut.

Në ditët e sotme, çdo vit, zgjidhet një temë e ndryshme për Ditën e të Drejtave të Njeriut. Në vitin 2014 tema ishte “Çdo ditë është Dita e të Drejtave të Njeriut” dhe në vitin 2016 ishte “Çohu për të drejtat e dikujt sot”. Ndërsa motoja e këtij viti për Ditën e të Drejtave të Njeriut është “Dinjitet, Liri dhe Drejtësi për të Gjithë”<sup>2</sup>

## ISLAMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Gjëja e parë që gjejmë në Islam në lidhje me këtë është se ai përcakton disa të drejta për njeriun si qenie njerëzore. Me fjalë të tjera, do të thotë se çdo njeri qoftë i këtij vendi apo atij vendi, qoftë besimtar apo jobesimtar, qoftë ai jeton në ndonjë pyll apo gjendet në ndonjë shkretëtirë, ai ka disa të drejta themelore humane, thjesht, sepse ai është një qenie njerëzore. Dhe këtë fakt duhet ta njohë çdo mysliman.

E drejta e parë dhe më kryesore-themelore është e drejta për të jetuar dhe respektuar jetën njerëzore. Kurani i shenjtë parashtron: “...kush mbytet një njeri (pa të drejtë), pa pas mbytur ai ndonjë tjetër dhe pa pas bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë (krimi i tij) është si t’i kishte mbytur gjithë njerëzit...” (El Maide, 32).

Po ashtu, kjo përsëritet edhe në sure të tjera të Kuranit, siç është ajeti tjetër: “Dhe mos e mbytni njeriun që Allahu e ka ndaluar (mbytjen e tij), përveç me drejtësi (që e kërkon sheriati). E kush mbytet pa të drejtë (pa faj), kujdestarit të tij Ne i kemi dhënë të drejtë (të kërkojë drejtësinë), e ai të mos e kalojë kufirin në mbytje derisa ai është i ndihmuar (prej Zotit)”. (El Isra, 33).

Kontributi i Islamit për të drejtat e njeriut vlerësohet më së miri kur shihet në sfondin e historisë botërore si dhe në bazë të ndikimit që ai ka sot në epokën moderne.

Kur shqyrtohet çështja e të drejtave të njeriut dhe Islamit, është e rëndësishme të dallohen të drejtat hyjnore që janë përcaktuar nga Islami në njërën anë, dhe në anën tjetër keqinterpretimi dhe keq zbatimi i mundshëm nga qeniet njerëzore të papërsosura, që në këtë rast janë myslimanët. Ashtu siç shoqëritë perëndimore, ende luftojnë kundër racizmit dhe diskriminimit, shumë shoqëri myslimane ende luftojnë për të zbatuar plotësisht të drejtat e përshkruara në Islam.

Nëse ka ndonjë luftë me ndonjë komb apo vend, ajo mund të shpallet vetëm nga një qeveri e krijuar me rrugë legjitime. Sido që të jetë, asnjë qenie njerëzore nuk ka të drejtë të marrë jetën njerëzore në shenjë hakmarrjeje ose për shkak të ndonjë parregullsie në tokë, përveç me aktvendim nga organet kompetente gjyqësore. Prandaj është detyrë e çdo qenieje njerëzore që në asnjë rrethanë të mos bëhet fajtor për marrjen e një jete njerëzore. Nëse dikush ka vrarë një qenie njerëzore, është sikur të ketë vrarë të gjithë racën njerëzore.

Menjëherë pas ajetit të Kuranit famëlartë, i cili është përmendur në lidhje me të drejtën e jetës, Zoti ka thënë: “Dhe kushdo që shpëton një jetë është sikur të kishte shpëtuar jetën e gjithë njerëzimit.” (El Maide, 32).

Mund të ketë disa forma për të shpëtuar njeriun nga vdekja. Një burrë mund të jetë i sëmure ose i plagosur, pavarësisht nga kombësia, raca ose ngjyra e tij. Nëse e dini se ai ka nevojë për ndihmën tuaj, atëherë është detyra juaj që të organizoni trajtimin e sëmundjeve ose plagëve të tij. Nëse ai po vdes nga uria, atëherë është detyra juaj ta ushqeni në mënyrë që të mund të shmangë vdekjen. Nëse ai po mbytet ose jeta e tij është në rrezik, atëherë është detyra juaj ta shpëtoni.

Gjëja e tretë e rëndësishme që gjejmë në Kartën e të Drejtave të Njeriut të dhënë nga Islami është se dëlirësia - fisnikëria e një gruaje duhet të respektohet dhe të mbrohet në të gjitha rrethanat, pavarësisht nëse ajo i përket kombit tonë apo kombit të një armiku, pavarësisht nëse e gjejmë atë në pyllin e egër ose në një qytet të pushtuar, nëse ajo është bashkëfetare jona ose i përket ndonjë feje tjetër, apo nuk ka fe fare. Besimtarit i janë ndaluar të gjitha marrëdhëniet e shthurura jashtëmartesore, pavarësisht nga statusi apo pozita e gruas në shoqëri.

Fjalët e Kuranit të shenjtë në këtë drejtim janë: “Dhe mos iu afroni imoralitetit (zinisë), sepse vërtet ai është vepër e shëmtuar dhe është një rrugë shumë e keqe.” (El Isra, 32).

Ky koncept i shenjtërisë së dëlirësisë dhe mbrojtjes së grave nuk mund të gjendet askund tjetër përveç në Islam. Allahu xh.sh. në këtë ajet i ka barazuar meshkujt dhe femrat në aspektin e përgjegjësisë dhe të drejtave të tyre: “Kush bën ndonjë nga punët e mira, qoftë mashkull ose femër duke qenë besimtarë, të tillët hyjnë në Xhenet dhe nuk u bëhet farë padrejtësie.” (En Nisa, 124).

Ndërsa kur flasim për të drejtat ekonomike, Kurani famëlartë i urdhëron ithtarët e tij: “Dhe në pasurinë e tyre kishin përcaktuar të drejtë për lypësin dhe për të ngratin (që ka nevojë por nuk lyp).” (Edh Dharijat, 19).

Fjalët e këtij urdhri tregojnë se është një urdhër kategorik. Për më tepër, ky urdhër u dha në Mekë, ku nuk ekzistonte asnjë shoqëri myslimane e organizuar mirë në kuptimin shtetëror, siç do të bëhej një e tillë në Medine. Aty, në Mekë pra, përgjithësisht myslimanët duhej të vinin në kontakt me popullsinë e jobesimtarëve. Prandaj kuptimi i qartë i këtij ajeti është se kushdo që kërkon ndihmë dhe kushdo që vuan nga privimi, atij duhet t'i ofrohet ndihma për të realizuar të drejtë në pronën dhe pasurinë e vet; pavarësisht nëse i përket cilit popull, cilës racë apo vend i takon ai. Nëse jeni në gjendje të ndihmoni dhe një person në nevojë të kërkon ndihmë ose nëse e kuptoni se ai është në nevojë, atëherë është detyra juaj ta ndihmoni atë.

Islami e ka ndaluar qartë dhe kategorikisht praktikën primitive të kapjes së një njeriu të lirë, për ta bërë atë skllav ose për ta shitur në skllavëri.

Në këtë pikë, fjalët e qarta të Pejgamberit a.s. janë si vijon: “Janë tre kategori njerëzish kundër të cilëve unë vetë do të jem paditës në Ditën e Gjykimit. ... Nga këta të tre, njëri është ai që shet një njeri të lirë, (si rob) dhe shfrytëzon çmimin e tij...” (Buhariu dhe Ibën Mexhxhe).

Fjalët e kësaj tradite të Pejgamberit a.s. janë gjithashtu të përgjithshme, ato nuk janë cilësuar apo zbatuar për një komb, racë, vend ose pasues të një feje të caktuar. Islami kërkon që myslimanët të kenë karakter të drejtë dhe të sillen me drejtësi me të gjithë racën njerëzore, pavarësisht nga përkatësia etnike, kombësia, besimi dhe nëse janë miq apo armiq.

Zoti në Kuran thotë: “O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të Allahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë. Kini dronë Allahun se Allahu di hollësisht për atë që vepron.” (El Maide, 8).

Nga diskutimi i mësipërm, është e qartë se ligji islam ka të drejta të mandatuar në mënyrë hyjnore për individët në rolet e tyre specifike si bashkëshort, prind, fëmijë, i afërm, fqinj, mik dhe madje edhe armik. Në shpërndarjen e të drejtave dhe përgjegjësisë të tij, Islami ka trajtuar çështjet sociale, racore, gjinore dhe sektare që mendojnë shoqërinë tonë globale. Në të vërtetë, modeli i të drejtave dhe përgjegjësisë të ndërsjella të sanksionuara në Islam ka një potencial të jashtëzakonshëm për reforma individuale dhe sociale në botë.

1 Përkthim nga gjuha angleze: <https://www.un.org/en/observances>

2 Përkthim nga gjuha angleze: <https://www.un.org/en/observances/human-rights-day#>:

# E vërteta e mitit të dekretit të sulltan Abdul Hamidit I (1725-1789) që ndalonte gjuhën shqipe

Arben Llalla

*“Njëra historiografi greke zbulon mitet historike, një tjetër herë pas here pranon zbulimet e të parës, por krijon të reja edhe sot.” Vasilis Kremidhas*

Nuk mund të quhet histori shkencore një filmi artistik, as emisionet dokumentare që pasqyrojnë një gjysmë të vërtete të përzier me një gjysmë gënjeshtre.

Në emisionin “Gjurmë Shqiptare”, me titull: “Plani greko-osman për zhdukjen e shqipes”, që e drejton gazetari, Marin Mema, deklaroi se: “Sulltan Abdyl Hamiti I, nxori një dekret të posaçëm kundër gjuhës shqipe”, por nuk mbaron këtu, sepse interesante është një tjetër detaj. Teksa shqipja dënohej me shfarosje, gjuha dhe kultura greke merrej në mbrojtje.<sup>1</sup>

Këtë deklaratë të Marin Memës, në emisionin e tij, dhënë në Top Channel, më 25 prill 2020, e që nuk solli asnjë dëshmi shkencore, e përforcoi në të njëjtin emision studiuesi, Niko Kotherja, i cila tha: “Duhet pranuar se në atë kohë, Dhaskal Todri, zyrtarisht po shkelte ligjin, pra atë ligj që kishte miratuar sulltani në vitin 1779.” Por që të dy këta nuk ofruan asnjë fakt, dëshmi për dekretin e vitit 1779. Kështu, fjala e Memës dhe Kotherjes mori dhen, duke u përfolur në çdo emision në TV, portale, gazeta, etj.. Flitej se ekzistonte dekreti i sulltanit, i vitit 1779, që ndalonte gjuhën shqipe dhe që mbronte gjuhën greke, por askush nuk solli një faksimile, një citim serioz. Asnjë akademik apo profesor i lëndës së historisë nuk ka folur

Shkrimi për dekretin e ndalimit të gjuhës shqipe ka dalë nga sigurimi i Greqisë në bashkëpunim me sigurimin serb gjatë luftës së Kosovës më 1999.

ende se ekzistonte dekreti i vitit 1779, që ndalonte gjuhën shqipe dhe mbronte gjuhën greke. Po kujt i shërbejnë këto deklarata të tilla joserioze, joshkencore në periudhën e një partneriteti strategjik të Turqisë dhe Shqipërisë? Në kohën kur presidenti Erdogan dhe kryeministri Rama kanë dëshmuar se dy vendet janë të lidhura ngushtë ndërmjet vete.

Ne deklarojmë me përgjegjësinë e plotë si historian, në bazë të dokumenteve shkencore, se deri më sot nuk është zbuluar asnjë dekret i tillë. Nuk ka ekzistuar asnjë dekret i Perandorisë Osmane i sulltan Abdul Hamidi I (1725-1789), në të cilin thuhet se pasi mori një thes me flori nxori një ligj kundër gjuhës dhe kulturës shqipe, dhe se ai ligj u lëshua nga sulltani i Perandorisë Osmane, më 31 maj 1779, Abdul Hamid I (1725-1789). Në ligj përcaktohej saktë marrja në mbrojtje e kulturës dhe gjuhës greke nga ana e turqve, dhe përkundër saj, lufta dhe shfarosja e gjuhës shqipe. Ky dokument është nxjerrë nga arkivat greke dhe është botuar në gazetën “Thessaloniki”, të vitit 1999. Dekretin e pasqyrojnë mediat greke më 1999, bashkë me burimin e marrjes së floririt prej sulltanit Abdul Hamid I.<sup>2</sup>

Kjo është një gënjeshtër. Shkrimi për dekretin e ndalimit të gjuhës shqipe ka dalë nga sigurimi i Greqisë në bashkëpunim me





Revista greke e dhjetorit 1999 ku është botuar shkrimi i Qiriako Velopulos se gjoja ekziston Dekreti.



Faqja e shkrimit e manipuluar me foton e Sulltanit

sigurimin serb gjatë luftës së Kosovës më 1999.<sup>3</sup> Personi që ka botuar shkrimin, sot është deputet i Kuvendit të Greqisë i grupit ekstremist të djathtë i partisë Zgjidhja Greke, dhe quhet Qiriakos Velopulos. Historianët, gazetarët dhe studiuesit shqiptarë ranë në kurthin e një shkrimi të botuar në një revistë greke, të përkthyer nga Arben Llalla dhe interpretuar si falsifikim, por që mediat shqiptare dhe historianët shqiptarë thonë gënjeshtren greke dhe jo si është e vërteta. Përse asnjë historianë apo studiues shqiptarë nuk ka botuar kopje faksimilen e këtij dekreti? Përse studiuesit shqiptarë s’kanë bërë kërkime ku gjendet ky dekret? Përse historiografia shqiptare deri në vitin 2000 nuk e dinte këtë dekret të sulltanit që ndalohej përdorimi i gjuhës shqipe? Përse rilindësit tanë nga vëllezërit Frashëri asnjëherë nuk kanë shkruar se ekzistonte një dekret që ndalonte gjuhën shqipe?

Për kohën që flitet se ka dalë ky dekret i Perandorisë Osmane, shqiptarët ishin shtylla e kësaj Perandorie, duke përmendur Ali Pashë Tepelenën, dinastinë Bushatlinjëve, në Pollog

dinastinë e Koxha Rexhep Pashën, i cili kishte autonomi qeverisëse nga Prizreni, Tetova etj.. Për të vazhduar më tej me Mehmet Ali Pashë Kavallën e Egjiptit. E si sulltani në atë periudhë do të nxirrte një dekret kundër gjuhës shqipe ku shumë institucione ushtarake e qeveritare drejtoheshin nga arnautët?

Pa folur që Janina si qendër e shqiptarëve dhe si kryeqytet i Shqipërisë së Poshtme, e fitoi statusin gjatë periudhës osmane, duke spostuar Artën si qendër Despotiate.<sup>4</sup>

Duhet të jemi të kujdesshëm kur japim deklarata në emër të historisë shkencore, sepse kështu dëmtojmë vetveten dhe historinë tonë. Ftoj çdo historianë dhe studiues të ofrojë të kundërtën e pretendimeve të mia, përndryshe mos ta zënë më në gojë gënjeshtren e madhe se ka ekzistuar një dekret osman që ndalonte gjuhën shqipe.

**KUSH E BOTOI SHKRIMIN DEZINFORMUES**

Shkrimi se gjoja ekziston një dekret i sulltan Abdyl Hamitit të Parë (1725-1789) u botua në fillim më 24 gusht 1999, në gazetën

Shkrimi se gjoja ekziston një dekret i sulltan Abdyl Hamitit të Parë (1725-1789) u botua në fillim më 24 gusht 1999, në gazetën “Thessaloniki”.



Revista ku është botuar Hierodikonit të Veria-Naoussis 1598-1886 (I. Varevellis) botim i vitit 1954

“Thessaloniki” (Θεσσαλονικη) dhe më tej në revistën greke mujore që botohet në Selanik në dhjetor 1999, (ΙΣΤΟΡΙΑ γνωσια). Autori i këtij shkrimi ishte Qiriakos Velopulos, një emër i njohur për ndjenjat e tij raciste. Në shkrimin e tij, Velopulos, sjell shumë të dhëna të manipuluar dhe jo të vërteta. Shkrimin për dekretin e sulltanit të 1779 nuk e shoqëron me asnjë faksimile, por edhe te fotografia, që dëshmohet se gjoja është sulltan Abdyl Hamiti i Parë, ai ka vendosur fotografinë e sulltan Abdyl Hamitit të dytë (1876-1909), pra një gabim i rëndë për një studiues apo historian që pretendon se e thotë dhe e mbron të vërtetën.

Sipas autorit Velopulos, teksti vjen nga arkivi i Hierodikonit të Veria-Naoussis 1598-1886 (I. Varevellis), botim i vitit 1954. Por, Qiriakos Velopulos, nuk na jep se në cilën faqe të këtij libri ndodhet kopja e këtij dekreti pretendues. E si mundet një doktor shkencash në histori dhe autor i dhjetëra librave historik dhe politik, të mos na ofrojë citimin e plotë ku gjendet ky dekret, pra faqen e librit? Përse nuk ka ofruar për lexuesit faksimilen e dekretit të sulltanit të vitit 1779?

Gjatë kërkimeve të mia, duke ndjekur të dhënat që na jep Qiriakos Velopulos, se ku gjendet ky dekret, nuk e gjeta

pretendimet e tij në librin i Hierodikonit të Veria-Naoussis 1598-1886 (I. Varevellis) botim i vitit 1954.

Mendimi im përfundimtar si historian, por edhe duke e njohur nga afër, që nga viti 1991 aktivitetin dhe personalitetin e politikanit dhe historianit grek Qiriakos Velopulos, them që kemi të bëjmë me një mashtrim, një kurth për studiuesit, gazetarët apo edhe historianët shqiptarë, duke pretenduar se ekziston dekretin e sulltanit të vitit 1779, që ndalohej mësimi i gjuhës shqipe dhe mbrohej gjuha greke nga rebelët shqiptarë. Megjithatë përsëri unë ju bëj thirrje studiuesve grekë, shqiptarë, por edhe të tjerëve që le të na ofrojnë një dokument për ekzistimin e dekretit që ndalon mësimin e gjuhës shqipe.

Autori i shkrimit dashakeqës me prapavija politike shpifëse, Qiriakos Velopulos, nuk është thjesht një emër gazetar apo historian, ai që në moshë të re është përfshirë në jetën politike në Greqi, fillimisht te rinia e partisë PASOK, më tej kaloi në partinë ekstremiste të djathtë fetare ortodokse të Jorgo Xhaferit LAOS, ku u zgjidh edhe deputet më 2007. Në vitin 2012, Velopulos, braktisi LAOS për t’iu bashkangjitur partisë Demokracia e Re, ndërsa në vitin 2016, themeloi partinë e tij, Zgjidhja Greke, një parti ekstremiste e djathtë që dëgjohet se financohet nga kisha ortodokse dhe bizneset ruse në Greqinë e Veriut – Selanik. Në vitin 2019, u zgjodh euro-deputet, por dha dorëheqje pasi u zgjodh deputet i Kuvendit të Greqisë. Velopulos jeton në lagjen e të pasurve milionerë të Selanikut, Panorama.

Ekzistenca e jetës shoqërore, profesionale dhe politike e kryetarit të partisë greke, Zgjidhja Greke, Qiriakos Velopulos, është ngritur mbi sëmundjen e urrejtjes psikologjike që ka ai ndaj fqinjëve të Greqisë, si Turqisë, Bullgarisë, Maqedonisë së Veriut, Kosovës dhe Shqipërisë.

Qiriakos Velopulos është një zë i racizmit ndaj atyre që nuk i përkasin besimit ortodoksë, ndaj atyre që mundohen të ndërtojnë paqe midis kombeve dhe besimeve fetare.

- Revista, “NIAOYSTA”, Naoussa, Korrik-Dhjetor 1996.
- Gezeta “Θεσσαλονικη”, 24 Gusht 1999.
- Revista, “ΙΣΤΟΡΙΟ γνωσια”, Θεσσαλονικη, Dhjetor 1999.
- Emisioni, “Gjurmë Shqiptare”, Plani greko-osman për zhdukjen e shqipes, Top Channel, 25 prill 2020.
- [www.telegrami.mk/arben-llalla-e-verteta-e-mitit-te-dekretet-te-sulltan-abdul-hamidi-i-1725-1789-qe-ndalonte-gjuhen-shqipe/www.ina-online.net/e-verteta-e-mitit-te-dekretet-te-sulltan-abdul-hamidi-i-1725-1789-qe-ndalonte-gjuhen-shqipe/](http://www.telegrami.mk/arben-llalla-e-verteta-e-mitit-te-dekretet-te-sulltan-abdul-hamidi-i-1725-1789-qe-ndalonte-gjuhen-shqipe/www.ina-online.net/e-verteta-e-mitit-te-dekretet-te-sulltan-abdul-hamidi-i-1725-1789-qe-ndalonte-gjuhen-shqipe/)
- [www.freeinquiry.gr](http://www.freeinquiry.gr)
- Arben P. Llalla, ARVANITËT-Themeluesit e Greqisë së Re, Shkup, 2021, botim i dytë.

- 1 Emisioni “Gjurmë Shqiptare”, Plani greko-osman për zhdukjen e shqipes, Top Channel, 25 Prill 2020.
- 2 Revista, ΙΣΤΟΡΙΟ γνωσια, Θεσσαλονικη, Dhjetor 1999.
- 3 [www.ina-online.net/e-verteta-e-mitit-te-dekretet-te-sulltan-abdul-hamidi-i-1725-1789-qe-ndalonte-gjuhen-shqipe/](http://www.ina-online.net/e-verteta-e-mitit-te-dekretet-te-sulltan-abdul-hamidi-i-1725-1789-qe-ndalonte-gjuhen-shqipe/)
- 4 Arben P. Llalla, ARVANITËT-Themeluesit e Greqisë së Re, Shkup, 2021, fq.238.

# Kontribute albanologjike në faqet e revistës “Toska” të Egjiptit në fillim të shek. XX

Nuridin Ahmeti

Në shekullin XIX, e veçanërisht në gjysmën e dytë të shek. XIX, shoqëritë shqiptare që vepronin në mërgim, kishim filluar veprimtari të ngjeshur për botimin e librave dhe revistave në gjuhën shqipe. Në mesin e shoqërive shqiptare që vepronin në mërgim dhe që kishin aktivitete të dendura ishin edhe shoqëritë e shqiptarëve të Egjiptit.

Por marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve dhe arabëve, janë më të hershme se periudhat e veprimit të shoqërive në fjalë. Kur shqiptarët dhe arabët u përfshinë nën ombrellën e Perandorinë Osmane, marrëdhëniet ndërmjet tyre u intensifikuan. Shtytëse e fuqishme për vendosjen e marrëdhënieve ndërmjet këtyre dy popujve gjatë periudhës osmane, ishte caktimi i disa vezirëve, administratorëve etj., nga mesi i shqiptarëve për të shërbyer në botën arabe, e rrjedhimisht një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve ishin edhe në poste udhëheqëse edhe në Egjipt.<sup>1</sup>

Periudha e Rilindjes Kombëtare të shqiptarët shquhet për veprimtarinë e disa veprimtarëve shqiptarë në Egjipt. Thimi Mitoko, Spiro Dine, Filip Shiroka, A. Z. Çajupi, Jani Vruho, Aleksandër Xhuvani, janë vetëm disa nga veprimtarët shqiptarë që kishin zhvilluar veprimtarinë edhe te kolonia shqiptare e Egjiptit. Me një fjalë, kolonia shqiptare e Egjiptit ishte një nga kolonitë, ku shqiptarët zhvilluan veprimtari të dendur kulturore, botuan libra e revista,

sensibilizuan opinionin ndërkombëtar për ngjarjet që po ndodhnin te shqiptarët.<sup>2</sup>

Nga fillimi i shekullit XIX, në koloninë shqiptare në Egjipt filluan të botohen një mori revistash e gazetash në gjuhën shqipe, që publikuan artikuj të ndryshëm mbi shqiptarët, kulturën dhe të kaluarën e tyre etj. Këto revista e gazeta ishin: “Toska”, “Besa”, “Shqipëria (Cqipëria)”, “Shkopi (Ckopi)”, “Pellazgu”, “Rrufeja”, “Sëpata”, “Shkrepëtima” etj.<sup>3</sup>

Në morinë e këtyre revistave e gazetave që dolën në Egjipt, në dekadën e parë të shekullit XX ishte edhe revista “Toska”, të cilën e kemi marrë në trajtim.

## REVISTA “TOSKA”

Numri i parë i revistës filloi të dalë më 1 tetor 1901, në Mina të Egjiptit. Revista, ka formatin e një fletoreje shënimesh të sotme 14x20cm. Çdo numër i revistës i ka nga tetë faqe, numërimi i faqeve në numrin e parë, fillon nga numri një dhe përfundon në numrin tetë, ndërsa në numrin e dytë të revistës, faja fillon aty ku ka mbetur nga numri i kaluar, pra faja e parë e numrit të dytë fillon me numri nëntë, ndërsa faja e numrit të tretë fillon me numrin aty ku ka mbetur nga numri paraprak për të vazhduar kështu me radhë edhe në numrat e tjerë. Gjithsej u botuan shtatë numra, numri i fundit u botua në muajin korrik të vitit 1902, që i bie se revista kishte jetë afro një vit. Revista botohej në gjuhën shqipe, me disa

Periudha e Rilindjes Kombëtare të shqiptarët shquhet për veprimtarinë e disa veprimtarëve shqiptarë në Egjipt. Thimi Mitoko, Spiro Dine, Filip Shiroka, A. Z. Çajupi, Jani Vruho, Aleksandër Xhuvani, janë vetëm disa nga veprimtarët shqiptarë që kishin zhvilluar veprimtarinë edhe te kolonia shqiptare e Egjiptit.

artikuj në gjuhën frënge dhe ishte revistë e përnuajshme e apo siç e quanin drejtuesit “Flete e përnuajshme”. Revista drejtohej nga Milo Duçi.<sup>4</sup> Motoja e drejtuesve të revistës ishte “Flete e përnuajshme shcipe Vegle kombetare”, të cilët e kishin vendosur në kopertinën e numrit të parë.

Se cilën rrugë do ta ndjekin drejtuesit e kësaj ndërmarrje, në një farë forme e qartësojnë në numrin e parë, në parathënie, ku ata këtë ndërmarrje e cilësojnë flamur të mendimit kombëtar dhe si të vetmen detyrë në politikën redaktoriale do ta ndjekin “Lulzimin’ e ghues”<sup>5</sup>

Për me tepër, në parathënie e cila e mban inicialet e drejtuesit të kësaj reviste Milo Duçit thuhet:


“Djelli është ne perendim: ne dritë bukur e kuce po e dobet ndrit prej Ti Carkun; dhe n’ate drite bota mer ne bukuri te thelle, bimat marin ne nghyre ce te dale neser m’i ngrote dhe m’i bukur te ndrite se rish e se rish te humbase”<sup>6</sup>

Janë tri fusha, që drejtuesit e kësaj reviste u kanë dhënë hapësirën e duhur dhe lexuesi lehtë mund t’i dallojë ato:

*Fusha e gjuhës* - në numrin e parë, shkrimtari dhe veprimtari ynë i njohur, Asdreni, shkruan për prejardhjen e emrit shqiptar. Autori, shkrimin e fillon duke ju referuar veprës së Sami Frashërit “Shqipëria çka qenë çështë dhe çdo të bëhet”, për të cilën vepër, Asdreni thotë se përhap mendime shumë të mira. Duke u mbështetur edhe në mendime të Sami Frashërit, për emrin shqiptar, Asdreni jep edhe mendimet e veta, por që duket se janë në plotëni me mendimet e Samiut të shprehur në këtë vepër. Por, Asdreni, shkrimin e përfundon me porosinë e ruajtës së këtij emri “duhet te nderojme kete emer, ce te jetoj e te jete sa kohe do te shkelcejne djelli e heneza me ciell”<sup>7</sup>

*Fusha e historisë* - në numrin e parë të kësaj reviste, drejtuesit i kushtojnë një shkrim në formë nekrologu, politikanit të njohur italian me orgjinë arbëreshe, Françesko Krispit,<sup>8</sup> për më tepër, Krispi, sipas drejtuesve të kësaj reviste kishte merita të veçanta në mbrojtjen e interesave të

Në faqet e numrit të parë, ekziston rubrika ku trajtoheshin lajmet nga bota që bënin fjalë për Shqipërinë dhe shqiptarët.



(Ballina e numrit të parë të revistës “Toska”)

arbëreshëve në Itali dhe në avancimin e gjuhës shqipe, duke u zgjedhur si anëtar i një kongresi të Gjuhës Shqipe.

Në faqet e numrit të parë, ekziston rubrika ku trajtoheshin lajmet nga bota që bënin fjalë për Shqipërinë dhe shqiptarët.

Në lajmet nga Korça, drejtuesit e venë në dijeni lexuesin se mësonjëtorja shqipe e Korçës është duke përparuar në frekuentimin e numrit të nxënësve të dy gjinive dhe pa dallime fetare, atë shkollë, po e frekuentojnë nxënës të feve katolike e myslimane.<sup>9</sup> Në numrin dy të kësaj reviste, gjemë shkrime të botuara në revistat botërore në lidhje me Shqipërinë dhe shqiptarët,<sup>10</sup> por edhe shkrimet të udhëpërshkruesve<sup>11</sup> të ndryshëm që i kishin vizituar hapësirat shqiptare. Në numrin tre, drejtuesit e revistës prezantojnë thirrjen drejtuar shqiptarëve për bashkim pa dallim feje e krahine.<sup>12</sup> Pothuajse në të gjitha numrat hasim thirrje të tilla. Ndërsa, Lumo Skendo, bën apel që shqiptarët mos ta lëshojnë vendin e tyre.<sup>13</sup> Në numrin shtatë, e hasim një letër që drejtuesit e revistës i drejtojnë Sulltan Abdyl Hamitit II, ku i kërkojnë më shumë të drejta për shqiptarët që jetojnë në trojet e tyre. Letra i drejtohet me këtë titull: “Lutet lart Madhenis ti Sultan Abdul Hamid Hanit II. Mbret dhe Kalif”<sup>14</sup>, ndërsa përfundon në këtë mënyrë “Por, ne coft, se

guverna, e Madhenis s'Atë, ka me shty sunimin e vet sikur deri m'sot, me te tsilin armict tone ndzjerin dobina t'medha per vetje kunra Shcipnis dhe Mbretnis dhe s'ka per t'i vun vesh brimeve dhe luteve ce jena t'uba, duhet ce t'i diftojme madhenis s'Atë, se Kombi jon nuk munt te nalet ma, po Kombi i Shcipnis asht gatue me i ba ball atij fatit ce t'a neshin; dhe ncoft se pe rezik Madhenia Jote edhe kesaj herët sikur ghith her s'ke per t'ba gha per Shcipart, dasht dhe pa dasht per me e pertri Kombin tone ce eshte ne rezik, me nihm te Prenise, dhe me teh te shpatës ton, do te veshtrrojme punet ce kemi per te ba".<sup>15</sup>

*Fusha e letërsisë* - në faqet e kësaj reviste shohim të publikuara edhe vjersha që bëjnë fjalë për Shqipërinë, njëra nga këto vjersha është edhe ajo e shkruar nga Bib Toska, e titulluar "Shcypni e Re?", ku përshkruhet, vendi ynë i gjakosur, i grisur dhe i helmuar, mirëpo pavarësisht rrethanave në të cilat po kalon vendi, Shqipëria jeton dhe do të jetojë edhe në të ardhmen, sikurse e përshkruan:

*"Koke unur, fytyr ghakosur,  
flok' e kokes prap leshuar,  
petka grisur, cahte ghunosur  
Shciperia, fare helmuar."*<sup>16,17</sup>

*Fusha e folklorit* - këngët popullore të periudhës së Tanzimatit te shqiptarët, zënë vend në faqet e kësaj reviste. Këngët për Ali Pashën dhe figura të kësaj periudhe që u përjetësuan në këngë, u mblodhën prej Tsane Aliut dhe u botuan. Janë botuar këngët e Ali Pashës, Rekip Krekës dhe Xhaferit nga Skrosha.

*Me saba dyke hapur dita  
Po na vin tsa Komita  
Ce ne lumi gher te zalli  
Pusine te zu Shahine."*<sup>18</sup>

## PËRFUNDIM

Revista e përmuajshme "Toska" e cila dilte në fillim të shek. XX, në Egjipt, nën drejtimin e Milo Duçit, ishte revistë e karakterit politik, shoqëror, kulturor e letrar. Të gjitha këto fusha, drejtuesit e kësaj reviste, i mbulonin duke prezantuar materiale e opinione që do t'i shërbenin shoqërisë shqiptare të asaj kohe. Aspekti gjuhësor, zuri vend të posaçëm në faqe kësaj reviste, siç edhe e proklamuan drejtuesit e saj që në daljen e numrit të parë ku shkruanin: "Toska" ky fjamur i méjdimit kombitar per të vétëm keshille mori "Lulzimim' e ghuhes".<sup>19</sup>

Fusha historike e kësaj reviste, fillon të mbulohet me prezantimin e figurës së Françesko Krispit, i cili sipas drejtuesve të kësaj reviste, kishte ndërruar jetë në muajin korrik të vitit 1901, kur e filloi se shtypuri revista. Krispi sipas tyre ishte me origjinë shqiptare nga Sicilia, ishte edhe kryetar nderi i Shoqërisë Kombëtare Shqipe të Italisë, i cili thoshte se Shqipëria duhet t'i bashkohet Greqisë me qëllim që të ulen tensionet midis këtyre dy popujve "Intéresat tona na urdherojne ce Kombét é Ballkanit te kundershtojne hyrjat armicesié po ce munde te bene kete Grécia duhët t'i bashkohét Shcypnia".<sup>20</sup>

Këngët popullore të publikuara në këtë revistë janë të periudhës së Tanzimatit te shqiptar, si këngë të Ali Pashës etj.

Fushën letrare, e mbulonin me vjersha të shkrimtarëve kryesisht nga Bib Toska, Geg Postripa, Naido etj.

Dhe krejt në fund, themi se drejtuesit e kësaj reviste përmes shkrimeve të publikuara bënë përpjekje që themelet e identitetit kombëtar, t'i prezantojnë edhe në Egjipt dhe më gjerë në diasporën shqiptare të kohës, por shikuar nga prizmi i sotëm, kjo revistë na ka ofruar edhe mjaft materiale që na shërbejnë edhe për studime nga fusha e albanologjisë.

1 Muhamed Mufaku, *Shqiptarët në botën arabe*, Rilindja, Prishtinë, 1990, f. 24, 97-108.

2 *Po aty*, f. 93-107.

3 Hamit Boriçi-Mark Marku, *Historia e shtypit shqiptar 1*, Ufo-University press, Tiranë, 2007, f. 192-213.

4 Milo Duçi (1870-1933) - lindi në Egjipt në një familje shqiptare të cilët ishin shpërngulur në Egjipt. U shqua si veprimtar e publicist gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare. Shih: *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, ASHSH, Tiranë, 2008, f. 538-539.

5 *Toska*, nr. 1, 1 Tetuer, Mina (Misir), 1901, f. 1.

6 *Toska*, nr. 1, 1 Tetuer, Mina (Misir), 1901, f. 1.

7 *Toska*, nr. 1, 1 Tetuer, Mina (Misir), 1901, f. 8.

8 Françesko Krispit (1818-1901) - politikan, njëri nga personalitet më të shquara për bashkimin e Italisë dhe bashkëpunëtor i Garibaldit. U lind në Ribëra të Italisë nga një familje arbëreshe. Ishte kryeministër i Italisë, ministër i jashtëm, kryetar parlamenti. Kishte lidhje me De Radën dhe figura të tjera arbëreshe që jetonin dhe vepronin në Itali. Më 1895 në Korelano u zgjodh kryetar nderi i Kongresit Gjuhësor Shqiptar. Pasho Baku, *Fjalori Enciklopedik*, Bacchus, Tiranë, 2002, f. 394.

9 *Toska*, nr. 2, Nanduar, Mina (Misir), 1901, f. 12.

10 "Mendimi i ne diplomati t'Austr' Ungarise Permi Shciperi", *Toska*, nr. 2, Nanduar, Mina (Misir), 1901, f. 13.

11 "Udhetime ne Shcipni e Malzi (me 1858)", *Toska*, nr. 2, Nanduar, Mina (Misir), 1901, f. 14.

12 *Toska*, nr. 3, Mars, Mina (Misir), 1902, f. 18.

13 *Toska*, nr. 3, Mars, Mina (Misir), 1902, f. 19.

14 *Toska*, nr. 7, Korrik, Mina (Misir), 1902, f. 50.

15 *Toska*, nr. 7, Korrik, Mina (Misir), 1902, f. 51.

16 Bib Toska, "Shcypni e Re?", *Toska*, nr. 1, 1 Tetuer, Mina (Misir), 1901, f. 4.

17 Pseudonimi i shkrimtarit Filip Shiroka.

18 *Toska*, nr. 1, 1 Tetuer, Mina (Misir), 1901, f. 4.

19 M. D., "Prethenjë", *Toska*, nr. 1, 1 Tetuer, Mina (Misir), 1901, f. 1.

20 *Toska*, nr. 1, 1 Tetuer, Mina (Misir), 1901, f. 2.

# Salih Maksutaj - Salih Hoxha (1914 - 1946)

Mr. Vehbi Shatri

Në historinë e kulturës islame dhe kombëtare në Istog dhe me gjerë, në shekullin XX, një vend të merituar zë padyshim edhe edukatori Salih Hoxhë Maksutaj. Koha kur jetoi dhe veproi ky personalitet që kohë e kthesave dhe rrethanave jo shumë të favorshme për popullatën e këtyre anëve dhe për Kosovën në përgjithësi. Rrethanat shoqërore-politike, ndërrimi i pushteteve, secili më i ashpër se tjetri, ua vështirësuan shumë jetën shqiptarëve. Për këtë arsye, pothuajse e gjithë barra kishte rënë mbi ulemanë e asaj kohe. Kah do të përcaktoheshin dhe kah do të drejtoheshin ulemaja, atë rrugë do të ndiqte edhe xhemati, populli.

Është fat i mirë që në këto periudha të vështira, jetuan e vepruan një brez i tërë i ulemave atdhetarë, të ditur e të përgatitur si në pikëpamjen fetare, po ashtu edhe në atë kombëtare. Ishin këta burra të mëdhenj që udhëhoqën popullin, e udhëzuan dhe e mësuan atë drejt, saktë e mirë. Ishin këta dijetarë vepërmirë që nuk u luhatën në bindjet dhe pikëpamjet e tyre fetare e kombëtare, pavarësisht dhunës, torturave, provokimeve e nënçmimeve, tradhtive dhe mbytyjeve që u bënë sistemet e ndryshme dhe njerëzit e këtyre sistemeve. Falë këtij brezi të ndritur e merituar, vazhdoi pashkëputshëm kultura dhe tradita islame në vendin tonë. Një nga ato personalitete dhe figura të rëndësishme të kësaj kohe



*Salih Maksutaj rrjedh nga nje familje fetare, atdhetare, humane, patriotike e besnike. I ati i tije ishte Hafiz Emini, i cili kishte kryer mesimet fetare në Medresen e Shkupit, kishte shërbyer si imam ramazani për disa vite në fshatin e tij.*

dhe të këtij brezi, që la gjurmë në kulturën dhe traditën islame të Istogut, është edhe Salih Hoxha-Maksutaj.


## FAMILJA DHE LINDJA E TIJ

Salih Maksutaj rrjedh nga një familje fetare, atdhetare, humane, patriotike e besnike. I ati i tij ishte hafëz Emini, i cili kishte kryer mësimet fetare në Medresenë e Shkupit. Ai kishte shërbyer si imam ramazani për disa vite në fshatin e tij. Në vitin 1919, fshati Orroberdë u dogj nga serbët dhe banorët e këtij fshati kishin gjetur vendstrehim të përkohshëm në bjeshkët mbi fshatin Kaliqan. Më pastaj, banorët e fshatit Studenicë e strehuan hafëz Eminin me familje dhe e emëruan imam të fshatit. Si imam i fshatit Studenicë shërbeu rreth dhjetë vjet. Hafëz Emini shquhej si humanist i madh dhe xhematit iu shërbente krejt vullnetarisht.

Hafëz Emini ishte i martuar me Hyre Muçaj, të cilëve ju fali Zoti pesë fëmijë: Mustafën, Salihun, Aliun, Aijshen dhe Ryven. Sali Maksutaj është i biri i dytë i Hafëz Eminit.

## ARSIMIMI

Salih Maksutaj shkollën fillore e kreu në Vrellë, kurse të mesmen me sukses të shkëlqyeshëm e kreu në medresenë e vjetër katër vjeçare në Pejë prej vitit 1935-1939.



Pasi që kishte përfunduar medresenë në Pejë, ishte regjistruar në Medresenë e Madhe të Fahri efendi Iljazi në Gjakovë. Ai ishte në gjeneratë me hoxhallarët e njohur të kësaj ane: me mulla Zekë Byrdynën e Radacit, mulla Ramush Shatrin e Tomocit, me mulla Isa Haxhiun e Dubovës së Madhe, me mulla Hysen Berishën e Ruhotit dhe shumë të tjerë. Meqë mbeti kujdestar i familjes në rininë e tij, Salihu detyrohet që t'i ndërpresë studimet në Gjakovë. Salih Maksutaj filloi veprimtarinë kundër armiqve sllav, si kryetar i ballit kombëtar në këtë trevë. Ai bashkëpunoi me ilegale kaçake, me burrat e njohur shqiptarë të kësaj çështjeje, që ishin Bajram Gashi i Uçës, Bardh Isufi, Tahir Bajram Maksuti, Ali Shaban Muzlijaj, Hajdin Zekë Muzlijaj etj., të fshatit Orroberdë, me mulla Zekë Byrdynën, Qerim Sadri Sadikaj, Sadik Ramën e Gjurgjevikut, e shumë të tjerë.

## PUNA

Salih Hoxha kishte autoritet të madh në popullin e kësaj treve. Në mënyrën ilegale, nga Konsulli i Ambasadës Shqiptare në Shkup sillte abetare dhe libra të tjerë shqip dhe i fshihte në fshatin Vrellë të Smajl Ali Bicaj e te Avdyl Sylë Mavraj, në kohën kur po t'i gjendej ndokujt një libër në gjuhën shqipe pësonte jo vetëm personi, por e tërë familja. Sahil Hoxha i dinte tri gjuhë të huaja: gjuhën turke, arabe dhe

*Salih Hoxha kishte autoritet të madh në popull të kësaj treve. Në mënyrën ilegale nga Konsulli i ambasadës shqiptare në Shkup sillte abetare dhe libra tjerë shqip dhe i fshihte në fshatin Vrellë.*

italiane. Në italisht komunikonte me ushtrinë italiane, meqë Salih Hoxha në atë kohë (1942-1943) ishte kryetar i Komunës në Vrellë. Në postin e kryetarit të komunës nuk vazhdoi gjatë sepse si i padëshiruar i shtetit, largohet nga puna. Salihu i kthehet detyrës për të cilën dhe kishte ndjekur mësimet dhe kishte dhënë mund e lodhje. Më 12 tetor 1938, mori detyrën e imamit në xhaminë e fshatit Studenicë, pas imamit Hetem Metë Gorçaj.

## INTERNIMI DHE VDEKJA

Në detyrën e imamit të xhamisë nuk e lanë të qetë dhe pas një kohe jo të gjatë e larguan prej kësaj detyre. Ai u angazhua si imam për muajin Ramazan gjatë viteve 1942-1943 në

fshatin Prigodë dhe Kamenicë të komunës së Istogut. Si i padëshiruar dhe i familjes fashiste, në nëntor të vitin 1944, sllavo-komunistët e ftojnë Salih Hoxhën në bisedë kinse për luftë të përbashkët kundër fashizmit gjermano-italian, mirëpo ai i ishte përgjigjur: “Bashkëpunim me serb nuk ka, se ju jeni të pabesë. Ju luftoni në Serbi e Mal të Zi, e ne do të luftojmë në Kosovë.”

Pas mbledhjes së 5 korrikut 1945 në Kuvendin e Prizrenit, nga sistemi i atëhershëm, Salih Hoxha u shpall armik i shtetit dhe i popullit. Atë e internuan me familje, duke ia konfiskuar kështu pasurinë, tokën e bagëtinë. Gjashtë anëtarët e familjes së Salihut u burgosën për disa muaj, të cilët vuajtën dënimin në burgun e Lugut të Istogut. Salih Hoxha u vra tradhtisht. Nga familja e tij, sot jeton vetëm djali i tij Emimi, i cili është veteran i arsimit.

## Referencat:

1. Haki Kasumi, *Gjurmime albanologjike seria e shkencave historike XII-1982*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, fq. 164..
2. Emin Maksuti, Orroberda, kodër e shqiponjave, fshati i rezistencës kundër pushtuesve të huaj, fq. 78.
3. Intervistë me Emin Maksutaj në hotel “Park”, Banjë, më 2 maj 2015.
4. Nga arkivi KBI-së Istog.

# Në Medresenë e Gjakovës ligjëratat zhvilloheshin në gjuhën shqipe

Mulaim Shehu

*Në kohën e Perandorisë Osmane, gjuha osmane ishte gjuhë e administratës, gjuha arabe ishte gjuhë e shkencës, gjuha perse ishte gjuhë e poezisë, kurse gjuha shqipe ishte gjuhë e ligjëratës në “Medresenë e Madhe”, “Medresenë e Vogël”, “Mejtepi Ruzhdije” dhe në shkollat fillore në Gjakovë.*

## GJAKOVA

Gjakova u themelua si qytet në kohën e sundimit osman. Pjesa e vjetër e qytetit u ndërtua në hapësirën në mes të lumit Krena dhe Çabratit.<sup>1</sup> Themelues i këtij qyteti konsiderohet Sulejman Hadum<sup>2</sup> Aga, i cili ka lindur në rrethin e Gjakovës, ndërsa varri i nënës së tij ende gjendet në fshatin Guskë. Më 1594-95, ose me 1003 sipas hixhretit, Sulejman Hadum Aga, ndërtoi xhaminë e parë në Gjakovë, e cila u emërtua sipas themeluesit “Xhamia e Hadumit”.<sup>3</sup> Udhëpërshkruesi, Evlija Çelebiu,<sup>4</sup> i cili e viziton Gjakovën në vitin 1662, shkruan: “Gjakova ka dymijë shtëpi të stolisura, që ndodhen mbi një fushë të gjerë. Ka dy xhami të bukura, mesxhide, hane të mbuluara me plumb. Ka hamam të bukur, që të kënaq zemrën dhe nja treqind dyqane të ndryshme, të mbuluara me mallra. Meqë e ka klimën e këndshme, atëherë banorët janë të bukur dhe të dashur.”<sup>5</sup>

Ndërsa Sami Frashëri, pas dy shekujve shkruan: “Gjakova ka 16 xhami, dy medrese, një shkollë ruzhdie dhe disa mektebe, ka bibliotekë, kishë dhe mekteb të veçantë për katolikë e ortodoksë. Ka afro 1000 dyqane, ka bujtina e banja publike. Popullsia e Gjakovës është e njohur për ruajtjen e traditave dhe kanë prirje për tregti e zejtari. Është popull guximtar dhe i aftë për armë. Nga gjiri i këtij qyteti ka pasur gjithmonë dijetarë të dëgjuar e myderrizë.”

Një karakteristikë e Gjakovës është se lagjet quhet sipas xhamive, kështu xhamia është ajo që e themeloi lagjen, andaj me ndërtimin e xhamisë së parë “Hadum Aga” (1594), është themeluar lagjja e quajtur “Mëhalla e Hadumit”, me ndërtimin e “Xhamisë së Kryepazarit” (1600-1952), është themeluar lagjja e quajtur “Kryepazari”, e kështu me radhë edhe lagjet e tjera. Një statistikë tregon se në vitin 1874, në qytetin e

Gjakovës, përkundër dy medreseve, ka pasur edhe 17 shkolla fillore, kurse në vitin 1893/94, funksiononin 18 shkolla fillore, 14 shkolla fillore të djemve me 1051 nxënës dhe 4 shkolla fillore të vajzave me 358 nxënës, që në total bëjnë 1409 nxënës, si dhe mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe, ku gjitha këto kanë luajtur rol pozitiv në zhdukjen e analfabetizmin në Gjakovë. Andaj, si përfundim, mund të them se atëbotë, në Gjakovë 90% kanë ditur shkrim dhe lexim.

## “MEDRESEJA E MADHE”

Para se të flasim për “Medresenë e Madhe” në Gjakovë, dëshiroj të theksoj gurrën e fjalës medrese dhe domethënien e saj. Kjo fjalë e gurrës arabe, nga tri bashkëtingëllore (de re se) d.m.th., vendi në të cilin nxënësit lexonin, mësonin dhe pajiseshin me dije. Në këtë medrese jepnin mësim myderrizët shumë të arsimit, shumica e të cilëve të shkolluar në qendrat e ndryshme të arsimit dhe kulturës islame. Atëbotë studentët regjistroheshin në medrese pas përfundimit të shkollës fillore (mejtepit), ose në periudha të mëvonshme, pas shkollës së mesme (mejtepi Ruzhdije).

Mirëpo, pak janë të tillë që dinë së nga themelimi i saj, para dy shekujve e gjysmë, Gjakova kishte medrese, ku ligjëratat zhvilloheshin në gjuhën shqipe, e cila ishte e rangut të fakultetit të sotshëm, natyrisht sipas plan programit të fakultetit “Fatih” të Stambollit. Bamirësi dhe donatori për ndërtimin e kompleksit të “Medresesë së Madhe” ishte nga dera fisnike e Kurtpashëve – Kryezive të Gjakovës, Murat Begu, i biri i Adem Pashës, në vitin 1707.

## VEJSEL EFENDIU, I BIRI I JAHJA EFENDIUT

Vejsel Efendiu, i birit i Jahja Efendiut nga Shkodra, apo siç e quanin ndonjëherë Yveys Efendija ishte drejtori dhe



muderrisi i parë i “Medresesë së Madhe” të Gjakovës. Kështu një nga dëshmitë për atë se ligjëratat e tij, që nga fillimi e deri në fund, në “Medresenë e Madhe” ishin në gjuhën shqipe, është edhe kjo poezi e tij, me alfabet arab, e shkruar në vitin 1699, të cilën e kishte translituar Islaim Haxhi Tahirit, rahmet pastë!

### POEZIA E PARË NË GJUHËN SHQIPE NË GJAKOVË

*Do t'i lutem unë Allahun,  
Adem Kurtpashës t'i falë shëndet,  
E t'ia ruajë Murat begun,  
Që ta pshtojë kët milet!*

*Do t'i lutem që Adem pashës,  
T'i falë Allahu aq vjet e jetë,  
Gjithë sa ka yje qielli,  
Gjithë sa ka n'botë dushk e fletë!*

*Allah, t'lus unë xhunahqari,  
Falna m'katet për jetë e mot,  
Gjithë ku shkel këmbë shqiptari,  
Ti bekoje, i Madhi Zot!*

*Adem pashë po t'kënoj uratën,  
Oxhak i parë n'kët Shqipni,  
Nuk u lodhe për arkëthatën,  
Veç ky popull t'marrë dijeni!*

*Murat beg, Uvill Sabahi,  
Si fener ti dritë na jep  
Me emër t'vet t'ruejt Allahu,  
Që nxore popllin nselamet!*

Por për fat të mirë, hafëz Selim Yveysi (1913-2001), e kishte transliteruar me alfabet tonë dhe ruajtur në bibliotekën e tij, përndryshe do të zhdukej, pikërisht sikur zhdukja e sixhilit,<sup>6</sup> e qindra libra të tjerë, që u zhdukën nga xhandarmëria serbe në mars 1913, si dhe nga demolimi i xhamisë “Hadum Aga” me bibliotekën e saj në vitin 1999. Kështu, është një humbje e madhe shkatërrimi bibliotekës dhe zhdukja e sixhilit, që paraqiste kronikën katër shekullore të Gjakovës. Yveys Efendija është shkolluar në Medresenë e njohur “Fatih” në Stamboll. Pastaj, pas hafëz Yveys Efendisë, udhëheqjen e “Medresesë së Madhe” e vazhduan dy djemtë e tij, Ismaili Efendiu dhe Muhamedi Efendiu, që të dy hafëzë dhe myderrizë, të cilët ligjëruan në gjuhën shqipe.

### MYDERRIZ, HAFËZ FAHRI EF. ILJAZI, MYDERRIZI I FUNDIT I “MEDRESESE SË MADHE”

Lindi në vitin 1903 në Gjakovë, është djali i myderrizit, hafëz Iljaz Efendiut (1857-1920). Fahri efendiu mësimet fillestare i kreu në gjuhën shqipe. Te babai mësoi përmendsh Kuranin, atëherë kur i kishte 11 pranvera dhe fitoi titullin hafëz. Hafëz Fahriu vazhdoi mësimet në “Medresenë e Madhe” në Gjakovë pranë babai, deri në vitin 1920, vit kur ndërroi jetë babai i tij. Pastaj hafëz Fahriu, i vazhdoi dhe i përfundoi studimet në medresenë “Mehmed Pasha” në Prizren, ku fitoi titullin myderriz. Që nga janari i vitit 1930 e deri në vitin 1948, kur e mbyllën komunistët, hafëz Fahri ef. Iljazi, ka qenë myderriz, udhëheqës kryesor në “Medresenë e Madhe”, ku kanë studiuar mbi 100 studentë. Mësimi aty zhvillohej në gjuhën shqipe. Ai ndërroi jetë më 19.11.1985.

Lëndët që mësoheshin në “Medresenë e Madhe” në Gjakovë;

1. Leximi i Kuranit, sipas rregullave të texhvidit;
2. Komentimi i Kuranit (‘Ilmu tefsir’); 3. Hifzi, memorizimi i Kuranit, mësohej vullnetarisht;
4. Shkenca e traditës (‘Ilmu-l-Hadith’);
5. Jurisprudenca islame (‘Ilmu-l-Fikh’);
6. Burimet e jurisprudencës islame (Usul-l-fikh);
7. Dokrina islame (Akaidi);
8. Apologjetikë (Ilmu-l-kelam);
9. Logjika (‘Ilmu-l-mentik’);
10. Tarihul am (Historia e përgjithshme);
11. Gjuha arabe; 23. Misticism islam;
12. Gjuha perse; 24. Fizika.
13. Gjuha osmane;
14. E drejta trashëgimore (‘Ilmi feraid’);
15. Matematika (Hisab);
16. Gjeografia;
17. Retorika (Belaga);
18. Linguistika (‘Ilmi luga’);
19. Gramatika (‘Ilmi sarf’);
20. Sintaksa (‘Ilmi nahv’);
21. Kaligrafia (Husni hatt’);
22. Filozofia islame;

Kështu, në këtë Medrese, siç lexuam, nëpërmjet gjuhës shqipe, përpos lëndëve islame, po ashtu mësoheshin edhe lëndët natyrore, shoqërore dhe gjuhësore. Gjithashtu, këtu dua të shtoj se shumë nga këto lëndë, ne atëbotë nuk i kishim në plan program në MM “Alauddin” në Prishtinë.



Këtu duhet thënë se në kohën e Perandorisë Osmane, gjuha osmane ishte gjuhë e administratës, gjuha arabe ishte gjuhë e shkencës, gjuha perse ishte gjuhë e poezisë, kurse gjuha shqipe ishte gjuhë e ligjëratis në “Medresenë e Madhe”, “Medresenë e Vogël”, “Mejtepi Ruzhdije” dhe në shkollat fillore në Gjakovë.

Në “Medresenë e Madhe”, fillimisht studimet kryheshin për një periudhë 12 vjeçare, veçmas para hapjes së “Mejtepit Ruzhdije”, kurse më pas, studimet zgjatnin vetëm 8 vjet. Prandaj të diplomuarit nga kjo Medrese fitonin titullin myderriz.<sup>7</sup>

Vlen të theksojmë se “Medreseja e Madhe” në Gjakovë është ndërtuar nga shqiptarët bamirësë në kohën e Perandorisë Osmane, pastaj është shkatërruar dhe demoluar nga serbët pas LDB-së, respektivisht në vitin 1948, dhe së fundi është rindërtuar nga donatorët nga republika e Turqisë.

### ROLI KOMBËTAR I KËSAJ MEDRESEJE

Mbështetur në plan programet mësimore të kësaj Medreseje në Gjakovë, si dhe në nivelin mjaft të lartë profesional dhe intelektual të myderrizëve të saj, siç është poezia modeste, por e rëndësishme për nga konteksti i kohës, e myderriz, hafëz Yvejs Efendisë, lirisht mund të arrihet në përfundimin se kjo Medrese ka formuar një shtresë intelektuale fetare e akademike të admirueshme. Në këtë Medrese janë shkruar, kopjuar, komentuar e krijuar vepra të shumta, nga fusha e disiplina të ndryshme fetare, shkencore, e letrare, përfshirë edhe letërsinë shqipe me alfabet arab, e cila ka prodhuar efekte shumë pozitive në zhvillimin kulturor të masave popullore shqiptare edhe jashtë objekteve të medresesë. Prandaj, atëbotë, poetët kanë shkruara në gjuhën shqipe me alfabet arab, në radhë të parë për nevoja të nxënësve dhe të studentëve, e pastaj edhe të masës së gjerë. Shumë nga myderrizët dhe studentët e kësaj medreseje kanë marrë pjesë dhe kanë luajtur rol konstruktiv në të gjitha lëvizjet atdhetare shqiptare, si në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, në Lidhjen e Pejës “Besa-Besë” dhe kryengritjet e

ndryshme. Veprimtarët atdhetarë më të dalluar të medreseve të Gjakovës nga radhët e myderrizëve janë:

- Myderriz Ismail ef. Yvejsi ();
- Myderriz Haxhi Zeka (1830-1902);
- Myderriz Hasan ef. Shllaku (1835-1916);
- Myderriz Tahir efendi Lluka (1840-1908);
- Myderriz Ahmed efendi Korenica ();
- Myderriz Malush Tullumi – Shllaku (1852-1945);
- Myderriz, hafëz Ymer Guta (1860-1963);
- Myderriz, hafëz Idriz Hoxha (1874-1946);
- Myderriz, hafëz Ibrahim Pallaska (1875-1935);
- Myderriz Abdullal Efendi Hadri (1887- );
- Myderriz, hafëz Ibrahim Fehmiu (1892-1951);
- Myderriz Beqir Efendi Maloku (1894-1985);
- Myderriz Bajram Agani (1897-1961);
- Myderriz Mustafa Canhasi (1888-1970);
- Myderriz Hasan efendi Dashi (1892-1963);
- Myderriz Asim ef. Luzha (1889-1945).

Këta ishin një plejadë e myderrizëve të Gjakovës, dhe shumë e shumë të tjerë, të cilët aktivitetin e tyre atdhetar e paguan me internime, burgosje dhe likuidime fizike.

### PËRFUNDIM

Me një fjalë, si përfundim i këtij artikulli modest, “Medreseja e Madhe” në Gjakovë ishte një pjesë e pandarë e jetës publike, dhe të gjithë myderrizët, të cilët, përveç që ishin besimtarë të denjë, bamirës dhe filantropikë, ata po ashtu ishin edhe atdhetarë, prandaj përherë iu kanë drejtuar popullit që të mos e braktisin Gjakovën dhe atdheun, andaj të gjithë ata kanë qëndruar stoikisht në Gjakovë.

1 Dr. Ali Hadri, *Gjakova gjatë LNÇ*.

2 Fjala HADUM është fjalë e gurrës arabe خدوم, që do të thotë shërbëtor i madh, që shërben shumë, tejet i zellshëm në shërbim, dhe sinonim i saj është edhe fjala خدام. Prandaj ky ishte epiteti i bamirësit, donatorit dhe ndërtuesit të xhamisë Sulejman Hadum Aga, e kurrsesi siç mendon ndokush se kjo fjalë ka vetëm kuptimin eunuk.

3 Dr. Ali Hadri, *Gjakova me rrethinë prej themelimit deri më 1941*.

4 Evlija Çelebiu, udhëpërshkrues i njohur turk nga shekulli XVII, sa i përket të dhënave të ndryshme të kësaj periudhe. Në të ka shumë të dhëna edhe për tokat shqiptare. Sa për ilustrim, do ta them vetëm këtë se Evlija Çelebiu pohon se lumi Vardar buron nga toka shqiptare...

5 Mexhid Yvejsi, *Ylematë e Gjakovës – mburojë e Kosovës*, Gjakovë, 2003.

6 SIXHIL ar. sixhxhil سجلات = regjistër, që paraqiste kronikën katër shekullore të Gjakovës.

7 Myderriz është fjalë e gurrës arabe, مدرس, siç kemi thënë edhe më parë, d.m.th. arsimtar, mësimdhënës, profesor, pedagog. Ndërsa te ne ka kuptimin: Profesor në medrese.

## MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM, DR. MUHAMED BESHARIN



Më 2 dhjetor 2022, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim dr. Muhamed Besharin, sekretar i përgjithshëm i Organizatës Ndërkombëtare të Këshillit Botëror të Shoqërive Islame, me seli në Abu Dhabi

të EBA-së. Myftiu Tërnavë fillimisht u uroi mirëseardhje dhe i falënderoi për vizitën, e më pas i njohu ata me organizimin e jetës fetare në vendin tonë, si dhe me organizimin dhe funksionimin e institucionit të BIK-ut. Në këtë takim u diskutua edhe për

thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, sidomos në fushën e arsimit, kulturës dhe aktiviteteve të tjera, gjithnjë në shërbim të harmonisë e paqes mes popujve. Dr. Muhamed Beshari, falënderoi Myftiun Tërnavë për mikpritjen e ngrohtë

## MYFTIU TËRNAVA DHE KRYETARI RAMA PANË NGA AFËR PUNIMET NË XHAMINË QENDRORE



Më 6 dhjetor 2022, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, së bashku me kryetarin e Prishtinës, z. Përparim Ramën, panë nga afër punën që është realizuar deri më tani në ndërtimin në Xhamisë Qendrore në Prishtinë. Myftiu Tërnavë u shpreh i kënaqur me ecurinë e punimeve në ndërtimin e kësaj

xhamie, duke potencuar se punimet janë duke shkuar sipas planit dhe se ndërtimi sa më i shpejtë i kësaj xhamie do të ishte i mirëseardhur për Bashkësinë Islame të Kosovës, por mbi të gjitha për besimtarët myslimanë. Veç të tjerash, Myftiu Tërnavë falënderoi kryetarin e Prishtinës, i cili ka shprehur interesimin e tij për të përcjellë ecurinë

e punimeve të ndërtimit të kësaj xhamie. Në anën tjetër edhe kryetari i kryeqytetit, Përparim Rama, u shpreh i kënaqur me ecurinë e punimeve të Xhamisë Qendrore në Prishtinë, teksa i ofroi mbështetjen e plotë Myftiut Tërnavë në çështjet që ndërlidhen me Xhaminë Qendrore në kryeqytet.

## MYFTIU TËRNAVA U PRIT NË TAKIM NGA KRYETARI I ISTOGUT, Z. ILIR FERATI



Më 6 dhjetor 2022, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, u prit në takim nga kryetari i Komunës së Istogut, z. Ilir Ferati. Myftiu Tërnavë, fillimisht e uroi kryetarin për detyrën e re, duke thënë se kjo është një përgjegjësi shumë e madhe, por edhe privilegj të

jesh në shërbim të qytetarëve. “Më vjen shumë mirë për gatishmërinë që e keni për bashkëpunim të Komunës me BIK-un, ne po angazhohemi që Kosova të jetë një vend i qetë e i sigurt, ku qytetarët pa dallim do të jetojnë në paqe, harmoni e respekt të ndërsjellë”, tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë. Kryetari Ferati,

me këtë rast ka thënë se bashkëpunimi me Bashkësinë Islame, me imamët dhe me xhematin në Istog është shumë i mirë. Gjithashtu gjatë këtij takimi u bisedua edhe për bashkërendimin e punëve në shërbim të qytetarëve dhe zhvillimit të Komunës e vendit në përgjithësi.

## MYFTIU TËRNAVA TAKOI MUALIMET E DEPARTAMENTIT TË GRUAS



Më 7 dhjetor 2022, Drejtoria fetare-arsimore e drejtuar nga kryeimami Vedat Sahiti dhe Departamenti i Gruas pranë Kryesisë së BIK-ut kanë organizuar takimin përmblylës me mualimet nga e gjithë Kosova. Ky takim kishte për qëllim shpалosjen e punës një vjeçare të mualimeve, si dhe diskutimi për planet dhe programet që do

realizohen në vitin e ardhshëm. Kryeimami Sahiti falënderoi Departamentin e Gruas dhe të gjitha mualimet për angazhimet e sukseset që kanë arritur përgjatë këtij viti. Ai ritheksoi mbështetjen e Kryesisë së BIK-ut për avancimin e grave në fusha të ndryshme. Kurse udhëheqësja e Departamentit të Gruas, Vaxhide Bunjaku, prezantoi punën

një vjeçare, duke përmendur një sërë aktivitete. Në këtë takim prezent ishte edhe Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili foli për pozitën e lartë që feja islame i dha femrës. Mes të tjerash Myftiu falënderoi mualimet për angazhimin e tyre, duke i inkurajuar që të punojnë edhe në të ardhmen. Ai iu ofroi mbështetje të vazhdueshme në punën që bëjnë.

## MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM ZËVENDËSKRYETARIN E DIJANETIT, Z. SELIM ARGUN

Më 13 dhjetor 2022, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim zëvendëskryetarin e Dijanetit të Turqisë, prof. Selim Argun. Myftiu Tërnavë e njohu mysafirin me historikun dhe organizimin e institucionit të BIK-ut, si dhe me sfidat me të cilat po ballafaqohet BIK-u. Myftiu falënderoi zv.kryetarin e Dijanetit, prof. Selim Argun për vizitën dhe për të gjithë atë që ka bërë Dijaneti për Kosovën. “Kemi një bashkëpunim shumë të mirë me shoqatat turke që veprojnë në Kosovë, me zyrtarin për Çështje Fetare në ambasadën turke, z. Bunyamin Albayrak, ambasadorin, andaj shprehim një falënderim të veçantë për qeverinë dhe popullin turk, të cilët vazhdimisht kanë mbështetur Kosovën në situatat më të vështira, e po ashtu vazhdojnë edhe më tej ta ndihmojnë për integritet në mekanizmat rajonale dhe



ndërkombëtarë. Një falënderim të veçantë ia dedikojmë Dijanetit, i cili po mundëson ndërtimin e Xhamisë Qendrore në Prishtinë” – u shpreh Myftiu Tërnavë. Nga ana e tij, zv. kryetari i Dijanetit, prof. Selim Argun, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen

dhe përgëzoi atë dhe institucionin e BIK-ut për arritjet e deritanishme. Ai premtoi se bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve do të thellohet edhe më në të mirë të qytetarëve të Kosovës.

## ZËVENDËSKRYETARI ARGUN MBAJTI NJË LIGJËRATË NË FSI



Më 13 dhjetor 2022, zëvendëskryetari i Dijanetit të Turqisë, dr. Selim Argun, vizitoi Fakultetin e Studimeve Islame, ku u prit nga dekani i këtij Fakulteti, dr. Islam Hasani, i cili i dëshiroi

mirëseardhje dhe e falënderoi për vizitën. Me këtë rast, dr. Selim Argun mbajti një ligjëratë para studentëve të FSI-së me temë: “Vakëfet në qytetërimin islam nga e kaluara në të ardhmen”. Në

fund të kësaj ligjërate, zyra e Dijanetit shpërndau bursa për studentët e vitit të parë të FSI-së, si dhe për nxënësit e klasave të dhjeta të Medresesë “Alaudin”.

## VIZITA NË PUNISHTEN E XHAMISË QENDRORE

Më 13 dhjetor 2022, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë së bashku me zëvendëskryetarin e Dijanetit të Turqisë, Selim Argun, panë nga afër punishten e Xhamisë Qendrore në Prishtinë. Myftiu i Kosovës e njohu për së afërmi zv/kryetarin e Dijanetit për punimet në ndërtimin e xhamisë, për pamjen që do të marrë kjo xhami, si dhe për rëndësinë e veçantë që do të ketë për kryeqytetin, duke veçuar nevojën e madhe të besimtarëve për një xhami të tillë. Zv/kryetari i Dijanetit, Selim Argun, u shpreh i kënaqur me punimet në ndërtimin e kësaj xhamie. Ai tha se ndjehet i lumtur që qytetarët e Prishtinës do të kenë një xhami të tillë ku do t'i kryejnë obligimet fetare dhe se për këtë gjë ka arritur të kontribuojë edhe Dijaneti i Turqisë.

Kurse më 14 dhjetor, delegacion i lartë i Dijanetit të Turqisë, i udhëhequr nga zv/kryetari Selim Argun, nën




shoqërimin e kryeimamit të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, vizitoi Medresenë e Mesme “Alauddin”, ku u pritën nga drejtori i kësaj shkolle, Fadil Hasani dhe stafi akademik i saj. Ata u njohën për së afërmi me punën, angazhimin, sukseset dhe kushtet që ofron kjo shkollë. Më pas, ata vizituan disa prej hapësirave të kësaj shkolle, si dhe u njohën me sukseset e dëshmuara të medresistëve,

për të cilat u nda jashtëzakonisht i kënaqur. Gjatë kësaj vizite, Selim Argun, bashkëbisedoi edhe me nxënësit e kësaj shkolle për tema të cilat u interesuan nxënësve. Më pas, delegacioni i Dijanetit, nën shoqërimin e kryeimamit Sahiti, vizitoi KBI-në e Prizrenit, ku u mirëprit nga kryetari i këtij Këshilli, Besim ef. Berisha. (R.S.)

## MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM MYFTIUN E MYFTINISË SË BAJRAMPASHËS, Z. RECEP EREN

Më 15 dhjetor 2022, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur sot në takim myftiun e Myftinisë së Bajram Pashës, z. Recep Eren, si dhe imamin me prejardhje shqiptare në Bajram Pasha të Turqisë, z. Haki Vatansever. Myftiu Tërnavë i njohu mysafirët me organizimin e jetës fetare në Kosovë, me zhvillimin e institucioneve fetaro-arsimore të Bashkësisë Islame, si dhe me sfidat e shoqërisë kosovare në përgjithësi. Ai falënderoi Myftinën e Bajram Pashës dhe popullin turk për ndërtimin e xhamisë “Bajram Pasha Isa Beg” në Mitrovicë, si dhe për ndihmat e tjera që i ofrojnë Kosovës. Nga ana e tij, Myftiu i Myftinisë së Bajram Pashës, z. Recep Eren, falënderoi Myftiun Tërnavë për mikpritjen e ngrohtë dhe



vëllazërore, duke shtuar se ndjehet i gëzuar me progresin dhe arritjet që ka shënuar Kosova në fushën e edukimit fetar, si dhe shkallën e tolerancës

harmonisë dhe respektit të ndërsjellë të të gjitha komuniteteve. Bajram Pasha është njëra nga nënkomunat e Stambollit ku ka më së shumti shqiptarë.

## MYFTIU TËRNAVA PA NGA AFËR PUNIMET NË NDËRTIMIN E XHAMISË SË FSHATRAVE DOBËRDOL-ZAKUT

Më 23 dhjetor 2022, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, pa nga afër punimet në ndërtimin e xhamisë së fshatrave Dobërdol-Zakut, themelet e së cilës janë vënë në shtator të këtij viti. Myftiu Tërnavë u shpreh tejet i kënaqur me ecurinë e punëve në ndërtimin e kësaj xhamie. Ai tha se BIK-u ka qenë dhe mbetet e përkushtuar për krijimin e kushteve sa më të mira në mënyrë që besimtarët tanë ta kenë sa më të lehtë kryerjen e ibadeteve fetare. Xhamia e fshatrave Dobërdol-Zakut është duke u ndërtuar falë bamirësisë së familjes Sejdiu nga fshati Zakut.



## NË REVUQ TË PODUJEVËS U PËRURUA XHAMIA E RE

Më 23 dhjetor 2022, fshati Revuq i Podujevës u bë me xhami të re, kjo falë bamirësisë së banorëve të fshatit. Në hapje të kësaj xhamie, përveç banorëve të shumtë dhe përfaqësuesve të Këshillit të BI-së së Podujevës, i pranishëm qe edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar edhe nga bashkëpunëtorët e tij. Ceremonia e hapjes së xhamisë filloi ashtu siç e do rendi, me leximin e pjesëve nga Kurani fisnik dhe me këndimin e tekbiereve dhe salavateve. Në emër të Këshillit të BI-së së Podujevës, një fjalë përshëndetëse dhe mirëseardhje e mbajti kryetari i këtij Këshilli, Mensur ef. Hoti, i cili fillimisht uroi banorët e Revuqës për hapjen e kësaj xhamie, duke lutur të Madhin Zot që t'i shpërblejë me të mirat e Tij të gjithë ata që kanë kontribuar që të ndërtohet kjo xhami. Ai tha se tanimë, falë angazhimit të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe falë bamirësve vullnetmirë, pothuajse të gjitha fshatrat e Podujevës janë të pajisura me xhami, fakt ky që e lehtëson kryerjen e ibadeteve nga xhemati. Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, në fjalën e tij përshëndetëse, uroi dhe përgëzoi banorët e fshatit Revuq për ndërtimin e kësaj xhamie, duke shprehur kështu angazhimin dhe përkushtimin e institucionit të Bashkësisë Islame të



Kosovës për përmirësimin e kushteve dhe infrastrukturës fetare për xhematin e këtij vendi. “Më lejoni që t’ju uroj dhe t’ju përgëzoj për ndërtimin e kësaj xhamie, për të cilën, lusim Zotin e Madhëruar, që t’i shpërblejë të gjithë ata, të cilët në çfarëdo mënyre kanë kontribuar, qoftë edhe vetëm duke u gëzuar për ndërtimin e saj. Ta dini se, qysh se prej që është hapur themeli për ndërtimin e kësaj xhamie, ata që kanë kontribuar për këtë, kanë ndërtuar edhe shtëpitë e tyre në Xhenet, ngase Pejgamberi a.s. ka thënë se kush ndërton një shtëpi të Zotit në këtë dynja, Zoti do t’ia ndërtojë atij një shtëpi në Xhenet” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë. Imer Rrahimi,

përfaqësues i fshatit Revuq, falënderoi Myftiun Tërnavë dhe kryetarin Hoti për prezencën dhe për angazhimin e tyre dhe të institucionit të BIK-ut për ndërtimin dhe përrurimin e kësaj xhamie, duke uruar dhe përgëzuar banorët për këtë xhami. Po ashtu, Myftiu Tërnavë, mbajti edhe hytben e xhumasë, ku u fokusua në vlerën dhe rëndësinë që ka ndërtimi i xhamive në Islam. Ai përmendi ajetin kuranor, ku Zoti i Madhëruar thotë se e drejta e veçantë për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e xhamive ju takon besimtarëve, atyre që besojnë Zotin, falim namazin e japin zeqatin.

## FAKULTETI I STUDIMEVE ISLAME SHËNOI 30-VJETORIN E THEMELIT

Më 27 dhjetor 2022, kryetari i Bashkësisë islame të Kosovës, Myftiu Naim Tërnavë me stafin e tij, mori pjesë në shënimin e 30-vjetorit të themelimit të Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë. Në këtë eveniment që u mbajt në sallën e konferencave të Fakultetit të Studimeve Islame, përveç dekanatit, stafit akademik dhe studentëve të FSI-së, të pranishëm qenë edhe ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, dekani i Fakultetit të Shkencave Islame në Shkup, prof. dr. Shaban Sylejmani, përfaqësues nga ambasada turke, drejtori i Institutit Albanologjik dhe shumë personalitete të tjera të jetës fetare, akademike dhe shkencore të trevave shqiptare.

Në fjalën e tij, dekani i FSI-së, dr. Islam Hasani, theksoi se FSI është institucioni më i vjetër i arsimit të lartë në të gjitha trojet shqiptare, në të cilin mësimi organizohet në gjuhën shqipe. Ai më pas prezantoi një historik të shkurtër në lidhje me rrjedhat, zhvillimin, ngritjen dhe sfidat e FSI-së përgjatë këtyre tri dekadave, duke shprehur falënderimin e veçantë për të gjithë ata pedagogë që dhanë kontribute në këtë institucion të lartë arsimor. “Të diplomuarit tanë janë bartës të jetës fetare e arsimore në forume të ndryshme brenda dhe jashtë BIK-ut. Në këtë përvjetor tashmë kemi 560 studentë të diplomuar në nivelin bachelor, kurse një arritje tjetër e FSI-së është organizimi i programit master, ku janë shënuar arritje të lakmueshme dhe kemi mbi 32 studentë të diplomuar në këtë nivel” - tha dekani Hasani.

Myftiu i Kosovës, Naim Tërnavë, në fjalën e tij, ndër të tjera tha: “Në këtë përvjetor që po shënojmë sot, e gjej të udhës që në emër të institucioneve të BIK-ut, t’u shpreh mirënjohje të pafund gjithë atyre brezave para nesh që dhanë



kontributin e tyre në fushën e gjatë të arsimit tonë islam e kombëtar dhe atyre që e bënë të mundur që të kemi Fakultetin e Studimeve Islame. Natyrisht bukuria e një fakulteti janë studentët e tij, ata janë që i japin vlerë e kuptim atij. Misioni i FSI-së është të ofrojë studime të cilësisë së lartë, të përgatisë teologë të aftë për t’u ballafaquar me probleme dhe sfida të përditshme me të cilat ballafaqohet populli ynë. Dhe sigurisht meritë të veçantë për këtë kanë veteranë të arsimit tonë, profesor Qazim Qazimi, profesor Resul Rexhepi, profesor Ismail Ahmedi etj” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Në fjalën e saj para të pranishmëve, ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, znj. Arbërie Nagavci, theksoi mes tjerash se FSI ofron mundësi të reja për avancimin akademik e shkencor në arsimin e lartë. Që nga themelimi i saj më 1992 nga BIK-u, kjo qendër ka dhënë kontribut të rëndësishëm jo vetëm në aspektin e arsimit publik, por edhe në aspektin fetar e atdhetar. Akreditimet e fundit tregojnë se FSI është në rrugë të mbarë,

dhe janë për t’u përgëzuar edhe aktivitetet shkencore që janë duke u mbajtur nga FSI, qofshin sesionet shkencore, konferencat, ligjëratat, vizitat e profesorëve euro-perëndimorë etj., të cilët promovojnë vlerat e tolerancës, paqes dhe bashkëjetesës fetar.

Këtë takim e përshëndeti edhe dekani i FSHI-së, prof. dr. Shaban Sylejmani, i cili theksoi se FSI është një vlerë e madhe në shoqërinë e Kosovës dhe se bashkëpunimi mes nesh do të thellohet edhe më shumë në të mirë të fakulteteve tona. Një fjalë përshëndetëse mbajti edhe kryetari i Kuvendit të Malit të Zi, njëherësh student i gjeneratës së parë së të diplomuarve nga FSI, Mujadin ef. Milaimi, i cili tha se jemi krenar me këtë vatër të arsimit të lartë. Ai përmendi se vetëm në Mal të Zi janë mbi 20 studentë që kanë përfunduar FSI-në.

Në fund, studentët e FSI-së paraqitën një program kulturo-artistik, dhe u shpërndanë diplomat për të diplomuarit nga FSI, si dhe u hap ekspozita me fotografi nga përvoja 30 vjeçare e Fakultetit të Studimeve Islame.



## PROMOVHET LIBRI “NGA MINBERI I XHUMASË - HYTBE” I AUTORIT ISA EF. TËRSHANI

Më 15 dhjetor, organizuar nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, në sallën e konferencave u mbajt promovimi i librit “Nga minberi i xhumasë - hytbe” i autorit, Isa ef. Tërshani. Mysafirëve në emër të Kryesisë së BIK-ut iu dëshiroi mirëseardhje drejtori për Kulturë dhe Botime, Ramadan Shkodra, i cili tha se kjo vepër është libri i fundit që ka nxjerrë Kryesia e BIK-ut dhe ky libër paraqet përkushtimin e imamit në kryerjen e përgjegjësisë që ka. Shtëpia botuese “Dituria Islame”, respektivisht BIK-u e ka vlerësuar si të nevojshme që ta botojë këtë vepër të imamit tonë të nderuar, e që do të jetë në funksion të imamit për ligjërimin e tyre në xhemat.

Me fjalë rasti u paraqit edhe Myftiu Tërnavë, i cili pasi përshëndeti të pranishmit, vlerësoi lart punën e autorit, duke thënë se kjo vepër është me rëndësi dhe vlerë të lartë fetare, etike, kulturore. Myftiu më tej tha: “Vepra të cilën po e promovojmë sot, ka një rëndësi të veçantë, ngase në zanafillë, ligjëratat – hytbet, janë përgatitur nga imami i nderuar, për t’i kumtuar ato në minberin e xhamisë para xhematit të respektuar”. Më tej, ai tha se krahas kontributit të pamohueshëm në detyrën e imamit, Isa efendiu, është shquar edhe si udhëheqës e drejtues në institucionet e Bashkësisë Islame, por jo vetëm kaq, Isa efendiu, ka dhënë një kontribut të veçantë edhe në periodikun e BIK-ut, ku ka botuar një sërë trajtesash, kryesisht nga fusha e ahlakut. Libri që po e promovojmë sot, është një tjetër segment i suksesshëm i imamit tonë të nderuar, në të cilin, autori me kujdes e elokuencë të veçantë ka trajtuar trajtesa që janë për të gjitha shtresat e shoqërisë.

Përfaqësuesi i BFI-së nga Maqedonia e Veriut, prof. Jusuf Zimeri, mes tjerash përgëzoi autorin dhe Kryesinë e BIK-ut



për këtë botim kaq me rëndësi dhe pikë referimi për gjeneratat e reja.

Për librin “Nga minberi i xhumasë - hytbe”, referuan kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti, i cili veç tjerash tha se këtu jemi sot për të promovuar librin e sapo botuar të imamit, Isa ef. Tërshani. “Ky është një kontribut jetësor i autorit. Është bërë një përpjekje dhe mund ku janë trajtuar dhe analizuar sfida të fenomeneve të ndryshme. Të qenët hatib, ligjërues në një shtëpi të Zotit, e cila na tubon për ta përmendur falënderuar dhe njohur Atë, është privilegj dhe nder e amanet yni, mision i cili duhet të përmbushet me shumë përkushtim e me e devotshmëri dhe dashuri. Stili i ligjërimin dhe artikulumit të mendimit të imamit, hatibit dhe hoxhës sonë të nderuar, Isa ef. Tërshanit, që tani mund ta gjejmë të shkruar në libër, ka arritur që në shkallë të gjerë të arrij në këtë mes të artë.

Edhe referuesi tjetër, dr. Ejup Haziri, vlerësoi lart librin e autorit, duke theksuar dhe vlerësuar këtë libër tha se libri i hytbeve është një projekt që autori ka punuar me vite, dhe është i nevojshëm në rend të parë për imamët që janë ligjërues dhe të cilëve u ndihmon shumë, ngase brendësia e tij është ajka e shpjegimeve që imamët ligjërojnë para të tjerëve, dhe ngase janë

ato tema që s’mund t’i anashkalosh, e pastaj edhe për shkak të rëndësisë së trajtimit të këtyre temave nga ana e atyre që kanë përvojë. Prandaj, ky libër në rend të parë do të jetë një ndihmë e madhe për imamët, e pastaj edhe për çdo lexues tjetër. Gjithashtu duhet sinjalizuar këtu se brenda këtij punimi ka tema që janë mbajtur para një dekade e më tepër, prandaj lexuesit duhet ta ketë të qartë se disa tema janë enkas për një kohë të caktuar.

Krejt në fund, autori i librit, Isa ef. Tërshani, falënderoi Kryesinë e BIK-ut në krye me Myftiun Naim ef. Tërnavë për botimin e librit, duke i premtuar lexuesit se nuk do të ndalet dhe do të sjell edhe libra të tjerë. Duhet theksuar se hytbet që shtjellohen në këtë libër janë të marra nëpër libra të hytbeve, literaturë tjetër dhe webfaqe islame. Autori është munduar që temat t’i bëjë të larmishme, duke pretenduar që çdoherë të jenë aktuale për kohën dhe vendin ku ka ligjërues. Ai ka përzgjedhur tema që trajtojnë probleme të caktuara. Zakonisht temat e trajtuara kanë të bëjnë me besimin, edukatën, moralin, mirësjelljen ndaj prindërve, edukimin e fëmijëve, dukuritë negative të pranishtme në shoqëri etj.

## NJË DELEGACION I LARTË I KRYESISË SË BI-SË QËNDROI PËR VIZITË ZYRTARE NË TURQI

Nga data 18 deri më 24 dhjetor 2022, një delegacion i lartë i Kryesisë së BI-së së Kosovës, i kryesuar nga kryeimami, Vedat ef. Sahiti, dhe i shoqëruar nga dekani i FSI-së Islam Hasani, drejtori për Kulturë e Veprimtari Botuese, Ramadan Shkodra, zyrtari për botime, Nuhi Simnica dhe Besir Neziri nga kabineti i Myftiut, qëndroi për vizitë pune në Konja të Turqisë, ku realizuan një sërë takimesh me institucionet udhëheqëse, akademike e arsimore të Konjës.

Delegacioni është pritur nga kryetari i Konjës, Ugur Ibrahim Altay. Kryetari Altay, pasi i shprehu mirëseardhje, e njohu kryeimamin Sahiti me një sërë projektsh kulturore të realizuara në vendet ballkanike dhe tregoi gatishmërinë të bashkëpunojnë në ta ardhmen me BI të Kosovës në kulturë arsim dhe projekte për rini. Ndërsa kryeimami Sahiti, i shprehu falënderimet e BI-së së Kosovës për mbështetjen që japin universitetet dhe shkollat e mesme të Konjës për studentët dhe nxënësit nga Kosova.

Po ashtu gjatë qëndrimin në Konja, delegacioni është pritur edhe nga myftiu i Konjës, Ali ef. Öge. Myftiu i Konjës Öge, gjatë takimit tha se kontakte dhe vizitat e ndërsjella janë në funksion të bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndërmjet dy institucioneve.

Në Konja, u pritën edhe nga rektori i universitetit “Nexhmedin Erbakan”, Cem Zorlu, dekani i fakultetit të Studimeve Islame në këtë universitet prof. dr. Fikret Karapinar, rektori i universitetit “KTO Karatay”, prof. dr. Fevzi Rifat Ortaç, rektori i Universitetit “Selxhuk”, prof. dr. Metin Aksoy, si dhe dekani i Fakultetit të Studimeve Islame të këtij universiteti, prof. dr. Ramazan Altıntaş.

Në Konja, delegacioni vizitoi edhe qendrën e studimeve të specializuara fetare të Konjes, ku u prit nga drejtori Huseyin Akinci, më pas shkollën e



mesme internacionale “Mevlana”, si dhe shkollën e hifizit “Mustafa Büyükkaplan”.

Delegacioni i BI-së së Kosovës vizitoi edhe muzeun e qytetit të Konjas, dhe takoi disa nga studentët kosovarë që studiojnë në Konja.

Të premtën me 23 dhjetor 2022, delegacioni, në Ankara u prit në takime të veçanta nga dy nënkryetarët të DIJANET-it, dr. Burhan Isleyen dhe dr. Selim Argun.

Më pas, delegacioni u prit në takim të veçantë nga drejtori për botime e media në DIJANET, dr. Fatih Kurt, me të cilin biseduan për thellimin e bashkëpunimit në fushën e botimeve.

Në takim me drejtorin për Botime e Media të DIJANET-it, një vëmendje e posaçme iu kushtua ndihmës që DIJANET TV do t'i japë produksionit të BIK-u.

Delegacioni i Kryesisë së BI-së vizitoi ambientet e radios dhe DIJANET TV, ku panë nga afër punën

që bëhet në këto dy shtëpi informative të DIJANET-it.

Po në Ankara, ditën e enjte, më 22 dhjetor 2022, u pritën nga zv. drejtori gjeneral i TRT-së, Omer Faruk Tanriverdi, i cili shprehu gatishmërinë e tij të plotë që të ndihmojë, përkrah e prezantojë si gjithnjë Kosovën përmes programeve të TRT-së. Zv.drejtori i TRT-së, Tanriverdi u shpreh i gatshëm që të ndihmojë me materiale e përkrahje profesionale edhe produksionin e BIK-ut.

Gjatë qëndrimin në TRT, delegacione i BI-së u prit edhe nga koordinatori i TRT Avaz, z. Sedat Sagirkaya, i cili theksoi gatishmërinë e tij që të ndihmojë produksionin e BIK-ut.

Në Ankara, delegacioni i BI-së pati edhe një sërë takimesh në institucionet e DIJANET-it, ku në të gjitha takimet u bisedua për shtimin dhe rritjen e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve.

## MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM REKTORIN E UNIVERSITETIT DUMLUPINAR – KÛTAHYA



Më 27 dhjetor 2022, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim një delegacion nga Universiteti Dumlupinar – Kütahya, i kryesuar nga rektori Kazim Uysal. Myftiu Tërnavë falënderoi

mysafirët për vizitën dhe i njohu ata me historikun dhe avancimin e BIK-ut, si dhe me sisteminin e Fakultetit të Studimeve Islame dhe aktivitetin e tij. Nga ana e tij, rektori Kazim Uysal falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen

dhe shprehu gatishmërinë që të thellohet bashkë-punimi ndërmjet institucioneve të larta të arsimit, gjegjësisht Fakultetit të Studimeve Islame dhe Universitetit Dumlupinar – Kütahya. (R.S).

## KËSHILLI DREJTUES I IHSI-SË MBAJTI MBLEDHJEN E RADHËS



Më 26 dhjetor 2022, Këshilli Drejtues i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame mbajti mbledhjen e radhës, të cilën e hapi dhe e kryesoi drejtori i këtij Instituti, Sabri ef. Bajgora. Në këtë mbledhje mori pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili uroi dhe përgëzoi drejtorin

Bajgora dhe anëtarët e Këshillit Drejtues për punën dhe angazhimin e tyre përgjatë këtij viti. Ai edhe njëherë premtoi përkrahjen e vazhdueshme të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës për projektet e ardhshme të këtij Instituti. Në këtë mbledhje, KDI diskutoi për punën dhe veprimtarinë e këtij Instituti përgjatë vitit 2022, si

dhe për projektet të cilat e presin Institutin gjatë vitit 2023, me theks të veçantë organizimin e Konferencës Ndërko-mbëtare. Në fund të kësaj mbledhje, anëtarëve të Këshillit Drejtues iu dhurua nga një lloptop, donacion nga shoqata “Ihjaulet-Turath”.

## DREJTORI SIMNICA VIZITOI XHAMITË DHE QENDRAT SHQIPTARE NË DIASPORË

Më 3 dhjetor 2022, drejtori i Diasporës së BIK-ut, Ekrem ef. Simnica, vizitoi xhematin e xhamisë shqiptare “Bashkimi” në Kehl-Strasbourg të Gjermanisë, ku u prit nga kryetari, z. Murat Uka, anëtarët e kryesisë dhe nga xhemati i kësaj xhamie. Pas ligjëratës që mbajti aty, drejtori Simnica, në shenjë respekti dhe nderi, i ndau mirënjohje kryetarit të xhamisë.

Kurse më 4 dhjetor 2022, drejtori Simnica, vizitoi Qendrën Islame Shqiptare në Karlsruhe. Ai pa nga afër punimet që janë zhvilluar në këtë objekt madhështor. Aty u organizua edhe një tribunë me një numër të madh të xhematit, në të cilën morën pjesë edhe imamët dhe kryesitë e qendrave të tjera në Gjermani. Z. Simnica u njoh nga imami, njëherësh kryetari i Qendrës, Muhamed ef. Havolli, si dhe nga imami, Gazmend ef. Bajraktari, mbi ecurinë dhe mbarëvajtjen e punimeve gjatë ndërtimit të objektit.

Ndërsa më 5 dhjetor, drejtori Simnica vizitoi Qendrën Islame Shqiptare të Kosovës në Stuttgart, ku u prit nga kryetari i Qendrës, Baki Mustafi, së bashku me imamin, Hasbi ef. Sylejmani.

Kryetari e njohu drejtorin për punën dhe aktivitetet e Qendrës, si dhe për blerjen e objektit për xhami. Që të dy ranë dakord për bashkëpunim të



ndërsjellët ndërmjet institucionit të BIK-ut dhe Qendrës.

Kurse më 6 dhjetor 2022, drejtori Simnica, i shoqëruar nga kryetari i QISHK-ut, z. Baki Mustafi, vizituan Konsullatën e Republikës së Kosovës në Stuttgart, në të cilën u pritën nga udhëheqësja e Konsullatës së Përgjithshme, znj. Lumturie Lipoveci dhe nga konsulli Besnik Miftaraj. Z. Simnica përgëzoi atë për punën dhe koordinimin që bën me Qendrat Shqiptare Islame në Gjermani. Z. Simnica më 17 dhjetor 2022, mori pjesë në shënimin e 20-vjetorit të veprimtarisë së Qendrës Shqiptare për Integrim, Kulturë dhe Religjion në Llozanë.

Më 18 dhjetor, drejtori Simnica vizitoi xhaminë shqiptare “Ardhmëria” në Helsingborg të Suedisë, ku mori pjesë në tribunën që u organizua nga xhamia. Më pas zhvilloi takim me imamin, Burim ef. Dalipin, kryetarin z. Arian Dushku, anëtarët e Kryesisë dhe xhematin e kësaj xhamie. Në vazhden e vizitave në Suedi, drejtori Simnica, për namaz të jacisë më 19 dhjetor, u prit në xhaminë “Dituria” në Lankskrone, nga imami i nderuar, Burhan ef. Mustafa, kryetari Ismet Hasani, dhe anëtarët e Kryesisë.

Më 20 dhjetor, drejtori Simnica, vizitoi xhaminë shqiptare “Drita” në Mallmo, ku u prit nga kryetari Erblin Zhubi, anëtarët e Kryesisë dhe nga xhemati i kësaj xhamie. Drejtori Simnica e njohu nikoqirin për angazhimet e BIK-ut, në veçanti për angazhimet e tij në diasporë dhe njëherësh shprehu gatishmërinë për bashkëpunim të mëtutjeshëm. Në shenjë mirënjohje, drejtori Simnica ia dorëzoi mirënjohjet për ndihmën e ofruar nga qendra për vitra dhe kurbane.



## DREJTORI SIMNICA VIZITOI QENDRËN ISLAME SHQIPTARE NË KOPENHAGË

Me 22 dhjetor, drejtori Simnica, ka vizituar Qendrën Islame Shqiptare në Kopenhagë, ku u prit nga imam Basri ef. Kurtishi, kryetari Besim Ramadani dhe sekretari, Ilir Beqiri.

Ku u njoh për organizimin dhe mirëvajtjen e jetës fetare e shoqërore në Kopenhagë dhe në Danimarkë në përgjithësi, e në veçanti ecuritë dhe rrjedhat e Qendres Drejtori Simnica i shoqëruar nga Kryesia e qendrës vizituan objektin e blerë, që ishte madhështor, me mijëra metra katrorë dhe në vend shumë të përshtatëm. dhe u shpreh i lumtur për këtë, duke u lutur dhe uruar në emër të BIK-ut, organeve udhëheqëse të saj, në emër të Myftiut Naim ef. Ternava.



## SHOQATA “BEREQETI” SHPËRNDAU 1500 PAKO USHQIMORE



Më 22 dhjetor 2022, shoqata “Bereqeti” ka shpërndarë më shumë se 1500 pako ushqimore për familjet nevojtare në tridhjetë komuna. Këto pako u shpërndanë për herë të parë nga selia dhe depoja e re e shoqatës “Bereqeti”. 30 koordinatore nga e gjithë Kosova, shpërndanë këto pako ushqimore në të gjithë vendin. Drejtori i “Bereqetit” tha se synohet të jenë pranë këtyre familjeve në këtë stinë të dimrit, që sado pak t’ua lehtësoje jetën. “Bereqeti” përgjatë gjithë kohës në veçanti gjatë kësaj të dimrit ka qenë pranë këtyre familjeve, me pako ushqimore, stufa dhe dru



për ngrohje. Veç tjerash ka rinovuar dhe ndërtuar shtëpi për familjet nevojtare. (R.S.)

## KUVENDI I BIK-UT MIRATOI PROJEKTBUXHETIN E KRYESISË PËR VITIN 2023



Prishtinë, më 29 dhjetor 2022

Kuvendi i Bashkësisë Islame të Kosovës, mbajti mbledhjen e rregullt, të cilën e kryesoi kryetari i Kuvendit të BIK-ut, dr. Ajni Sinani. Mbledhja filloi me leximin e një pjese nga Kurani, të cilën e lexoi anëtari, Shaban ef. Haxhiu. Më pas, kryetari i Kuvendit, dr. Ajni Sinani, iu shprehu mirëseardhje anëtarëve të Kuvendit, duke i falënderuar ata për punën dhe angazhimin e tyre.

Kuvendarëve, në këtë mbledhje, me një fjalë përshëndetëse iu drejtua edhe kryetari i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili falënderoi të gjithë nëpunësit e BIK-ut, të cilët janë duke dhënë kontribut në mbarëvajtjen e jetës fetaro-arsimore. Ai kërkoi edhe njëherë unitet dhe bashkëpunim ndërmjet këshillave të BI-së dhe imamëve. “Gjendja është shumë më e mirë se ç’ka qenë dhe kjo na gëzon të gjithëve, por kemi shumë detyra dhe punë para vetës. Një punë të shkëlqyer janë duke zhvilluar edhe mualimet anakënd Kosovës, të cilat po bëjnë një aktivitet të mrekullueshëm në terren” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Ai duke folur për aktivitetet e BIK-ut, tha se BIK-u është lider në organizimin e konferencave dhe sesioneve shkencore, por edhe në botë po përfaqësohemi mirë dhe vazhdojmë edhe më tej të

kemi raporte shumë të mira me faktorin ndërkombëtar. “Ne do të vazhdojmë të luftojmë ekstremizmin, fundamentalizmin, indoktrinimin dhe dukuritë e tjera negative për shoqërinë. Këto mesazhe ju duhet t’i përcillni nëpër këshillat tuaj në komuna, sepse është obligim fetar që të luftohet e keqja.” Ai nuk la pa përmendur edhe xhematin, i cili vazhdimisht ka përkrahur dhe mbështetur BIK-un dhe është shumë dorëdhënë.

Një falënderim të veçantë Myftiu Tërnavë ka bërë për kuvendet komunale, qeverinë qendrore dhe institucionet e tjera, duke e cilësuar si shumë të veçantë bashkëpunimin dhe respektin që kanë me to, kjo ngase ne jemi institucion i besueshëm dhe nga ne kërkohet që t’i zhvillojmë edhe më shumë këto marrëdhënie bashkëpunimi mes organeve komunale dhe qeverisë sonë për të mirën e qytetarëve dhe xhematit tonë.

Myftiu Tërnavë njoftoi kuvendarët që kanë përfunduar shumë projekte infrastrukturore, e disa të tjera janë ende në fazën finale të realizimit, e me këto lehtësohet edhe më shumë jeta dhe aktivitetet fetare. “Falënderojmë Zotin që punët janë duke ecur mbarë e mirë. Ne shprehim falënderime edhe për donatorët, të cilët vazhdimisht nuk

ngurrojnë që të na ndihmojnë me projekte në të mirë të qytetarëve tanë. BIK-u do të vazhdojë në ngritjen infrastrukturore të këshillave të BIK-ut edhe në të ardhmen. Punët janë duke shkuar jashtëzakonisht mirë në procesin arsimor, si në Medrese, FSI, dhe institutet e hivzit.” – u shpreh Myftiu Tërnavë.

Theks të veçantë në këtë fjalim, Myftiu Tërnavë, i kushtoi edhe aktivitetit të Shoqatës Humanitare “Bereqeti”, e cila tanimë është numër një në Kosovë për aktivitetet e saj humanitare në vend, rajon, por edhe në kontinentet e tjera. Ai falënderoi donatorët, të cilët ofrojnë nga pasuria e tyre dhe ia besojnë shoqatës “Bereqeti” që kjo ndihmë të shkojë drejt e në dorën e sigurt te nevojtarët. “Vetëm këtë vit janë ndihmuar mbi 50 mijë familje dhe së shpejti do të vihet në përdorim edhe depoja e Bereqetit dhe zyrat e saj.”

Mbledhja më pas vazhdoi me pikat e rendit të ditës, e që ndër to ishte edhe shqyrtimi dhe miratimi i projekt-buxhetit të Kryesisë së BI-së të Kosovës për vitin 2023, ku para kuvendarëve raportin financiar e paraqiti drejtori për Buxhet dhe Financa, Tanseli Rogova, shqyrtimin e lëndëve dhe marrjen e vendimeve nga kompetenca e Kuvendit, si dhe të ndryshme etj.

# TOPLICA

*Tokat shqiptare padrejtësisht u copëtuan,  
Hordhitë e Karpateve ato i aneksuan,  
I aneksuan perlat tona kombëtare,  
Dhe shkatërruan çdo gjë shqiptare.*

*Kongrese të shumta, padrejtësitë shumë herë i panë,  
Vendime të padrejta kundër nesh kur dhanë,  
I copëtuan tokat tona stërgjyshore,  
Që ta dobësonin ndjenjën arbërore.*

*Vëllezër e motra shumë torturuan,  
I vranë pa mëshirë, i masakruan,  
Shumë të tjerë me dhunë i tjetërsuan,  
Nga vatrat e tyre në Toplicë, i dëbuan.*

*Sikur po e dëgjoj babanë tim, kur isha fëmijë,  
Shpeshherë më tregonte për këtë tragjedi,  
Për këtë dhembje të madhe, që ende lëngon,  
E bota hesht, vetëm hesht dhe bëhet se s'kupton.*

*Toplica dikur ishte e jona, shqiptare,  
Me xhami, medrese dhe me shumë minare,  
Me traditë, burrëri me plot shqiptari,  
Me toka të pëlleshme dhe flamur kombëtar  
në çdo shtëpi.*

*Dhunë të paparë mbi civilët ushtruan,  
Një mijë fshatra serbët me dhunë i shkretuan,  
Pa mëshirë i vranë pleq, gra e fëmijë,  
Vetëm mos të mbetj aty shqiptari.*

*Drejt Kosovës u nisën, me shpresë për të shpëtuar,  
Po serbë e rusë bashkë, sikur të harbuar,  
I dhunonin shqiptaret, pa mëshirë e frikë,  
Si në garë se kush do të vriste më shumë me thikë.*

*Dimër, borë e furtunë nga çdo anë,  
Mbi ta ushtrohej dhunë e tmerr i paparë,  
Shpejtonin për Kosovë, të ruhej nderi e lavdia,  
Për krimet ndaj tyre pak shkruan historia.*


*“Ah Toplicë, vatani ynë,  
edhe një herë dua me e pa”,  
Si sot e kujtoj, kur më the, o baba.  
Si më kërkove të shkonim,  
dhe pranë një varri më çove,  
“Është varr shqiptari, i stërgjyshit tënd”,  
me lot në sy më tregove.*

*“Ky, o bir, është varri i Ahmet Spahisë,  
I cili në zemër e kishte flamurin e Shqipërisë,  
Nga Toplica, si shumë të tjerë, edhe ai u dëbua,  
Në Kosovë e Turqi shqiptari u strehua.”*

*Toplicën tonë nuk duhet harruar,  
Aty kemi rrënjët, varret e historinë,  
Kosovë e Shqipëri, forcat duhet bashkuar,  
Nëse do shqiptari ta ketë të plotë lirinë.*

*Naim Tërnavë  
Korrik, 2015*





"O ju që keni besuar, ruajeni veten dhe familjen tuaj nga një zjarr, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët!"

(Et Tahrim, 6)